



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR**

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tëll +355 224 7273 keshilli.bashkiake@yahoo.it

V E N D I M

Nr. 168, datë 28.12.2012

“Miratimi i Buxhetit të vitit 2013”

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të dt. 28.12.2012, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19 pika 1-8, neni 32 gërma dh, neni 33 pika 2, Ligjit nr. 9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, Udhëzimit nr.2 dt. 6.02.2012 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 96, si dhe transfertës së pakushtëzuar në Buxhetin e vitit 2013, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë dhe pas diskutimit të anëtarëve:

V E N D O S I

1. Të miratojë abalizën e Buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2012 sipa relacionit përshkrues.
2. Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2013 si më poshtë:

- Burimet e financimit të Bashkisë Shkodër për vitin 2013, janë në shumën 754728 mijë lekë, të detajuara si më poshtë:

❖ Tranferta e pakushtëzuar,	shuma 373 044 mijë lekë
❖ Të ardhura nga taksat vendore	shuma 230 737 mijë lekë
❖ Të ardhurat nga tarifat vendore	shuma 109 407 mijë lekë
❖ Të ardhura jotatimore	shuma 18 512 mijë lekë
❖ Donatorë	shuma 23 028 mijë lekë

- Plani i shpenzimeve i Bashkisë Shkodër për vitin 2013, është në shumën 754 728 mijë lekë, detajuar si më poshtë:

❖ Shpenzime personeli	shuma 238 673 mijë lekë
❖ Shpenzime të tjera korente	shuma 405 794 mijë lekë
❖ Shpenzime për investime	shuma 110 261 mijë lekë



3. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2013 si më poshtë:

- Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Shkodër sipas tabelës nr. 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Buxhetit të vitit 2013 sipas programeve, sipas pasqyrave nr. 2, nr. 3, nr. 4, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Buxhetit të vitit 2013 analitik, sipas pasqyrave nr. 5, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Rishpërndarjet brenda programeve është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë Shkodër.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.

KRYETARI
Bardhyl LOHJA



168/1
11/01/2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Nr.32/1 Prot

Shkodër me, 11 .01.2013

LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 168 datë 28.12.2012 të këshillit të Bashkisë Shkodër.

DREJTUAR: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Prefekti i qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", neni 14, paragrafi 2, ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, neni 32, gërma dh, neni 33/3, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjit nr.10487 dt.5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", neni 15, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2 dt.6.02.2012, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2/1 dt.15.02.2012, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012", analizoi vendimin nr.168 dt.28.12.2012 të këshillit të Bashkisë Shkodër. " Mbi miratimin e buxhetit vendor për vitin 2013 të Bashkisë Shkodër, me transfertë të pakushtëzuar 373.044 (mijë lekë), pa përfshirë fondet e papërdorura të vitit 2012 dhe që trashëgohen në vitin 2013'.

Prefekti ju autorizon të procedoni duke bërë reflektimet e mëposhtme:

- Ndryshimet e transfertës së pakushtëzuar në mbështetje të ligjit nr.119/2012, dt.17.12.2012, "Për buxhetin e vitit 2013", nga shuma 373.044 (mijë lekë) në shumën 409.901(mijë lekë).
- Detajimin sipas shtojcës 1 "Formatimi i detajimit të fondeve buxhetore", kjo në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2/1 dt.15.02.2012, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012", si dhe shtojcës 11, "Raporti i projekteve me financim të brendshëm".
- Evidentimin në tabelat bashkëlidhur vendimit tuaj të fondit rezervë/kontigjencë në masën 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara sipas Klasifikimit Ekonomik Buxhetor pjesë e programit 04980, duke bërë ndarjen e masës së fondit rezervë dhe masën e fondit kontigjencë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI


Voltana ADEMI



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SHKODËR**

Bulevardi "13 Dhjetori" Shkoder, Albania Tel 355-224 37-20

Nr. 364/Prot
6

Shkoder, me 17.12 2012

DREJTUAR : Keshillit Bashkiak Shkoder

Te nderuar Keshilltar,

bashkangjitur po ju dergojme per miratim projekt vendimet e meposhtme :

- Projekt vendimin " Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2013 " me numer prot. 360/b date 17.12.2012 .
- Projekt vendimin per "Miratimin e buxhetit te vitit 2013 " me numer prot. 361/b date 17.12.2012.
- Projekt vendimin per " Miratimin e struktures organizative te Administrates se Bashkise Shkoder per vitin 2013" me numer prot. 362/b date 17.12.2012.
- Projekt vendimin per : Miratimin e struktures organizative te institucioneve ne varesi te Bashkise Shkoder per vitin 2013 "me numer prot. 363/b date 17.12.2012.

Faleminderit

KRYETARI

Lorenc LUKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE SHKODËR

Bashkia Shkoder, Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1, Shkoder; Tel +355-224 72-73 Keshilli, Bashkiak@yahoo.it

P/VENDIM

Nr 36/datë 17.12 2012
6

"Miratim i Buxhetit te vitit 2013"

Në mbështetje të nenit 19, pika 1-8 dhe nenit 32, gërma "dh" te ligjit nr. 8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit Nr. 9936 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", neni 44, udhezimi nr. 2 date 6.2.2012 "Mbi procedurat standarte te zbatimit te buxhetit" pika 96, dhe transfertes se pakushtezuar ne Buxhetin e vitit 2013, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Administra e Bashkise me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkoder, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e analizes se buxhetit te Bashkise Shkoder per vitin 2012 sipas relacionit pershkrues.
2. Të miratojë Buxhetin e Bashkisë së Shkodres për vitin 2013 si më poshtë vijon.
 - Burimet e Financimit të Bashkisë së Shkoder për vitin 2013, jane në shumën, 754 728 mije leke, te detajuar si më poshtë:
 - ❖ Transferta e pakushtezuar, shuma 373 044 mije leke
 - ❖ Te ardhurat nga taksa vendore, shuma 230 737 mije leke
 - ❖ Te ardhurat nga tarifat vendore, shuma 109 407 mije leke
 - ❖ Te Ardhurat jotatimore, shuma 18 512 mije leke
 - ❖ Donatore, shuma 23 028 mije
 - Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Shkodres për vitin 2013, është në shumën 754 728 mije lekë, detajuar si më poshtë:
 - ❖ Shpenzime personeli shuma 238 673 mije leke
 - ❖ Shpenzime te tjera korente shuma 405 794 mije leke
 - ❖ Shpenzime per investime shuma 110 261 mije leke
3. Te miratoje detajimin e buxhetit te Bashkise se Shkodres per vitin 2013 si me poshte:
 - Te miratoje planin e te ardhurave te Bashkise se Shkodres sipas tabelës Nr. 1 pjese perberese e ketij vendimi.

- Te miratoje detajimin e shpenzimeve te Buxhetit te vitit 2013 sipas programeve sipas pasqyrave Nr. 2, Nr.3, Nr.4 si pjese perberese te ketij vendimi.
 - Te miratoje detajimin e shpenzimeve te Buxhetit te vitit 2013 analitik sipas pasqyrave Nr.5 si pjese perberese e ketij vendimi.
3. Rishperndarjet brenda programeve eshte kompetence Kryetarit te Bashkise Shkoder.
 4. Ngarkohet Kryetari i Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.
 5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas miratimit.

Konceptuan:

Zv/Kryetari

Ahmet Dini

Drejtoria e Sherbimeve Publike

Drejtoria e Sherbimeve te Brendshme

Drejtoria e Kultures, Sporteve

Drejtoria Juridike

Kryetari

Lorenc LUKA

Zv/Kryetari

Ridvan Troshani

Drejtoria e Urbanistikes

Drejtoria Ekonomike

Drejtoria e te Ardhurave

TABELA 1

KATEGORITE E TAKSAVE DHE TARIFAVE		Plani 2013
I	TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ	381,684
A	TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE	230,738
A1	Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel	71,140
A2	Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertese)	33,440
A2a	nga biznesi	20,600
A2b	nga familje	12,840
A3	Taksa fjetjes ne hotel	1,250
A4	Taksa nd kimit ne infrastrukture	50,000
A5	Taksa kalimit drejtes pronesise	6,550
A6	Taksa e regj.s pervitshem mjete transp	58,000
A7	Takse zenie hapesia publike	3,700
A8	Takse tabele	355
A9	Taksa reklame	8,303
B	TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	109,407
B1	Tarife vjetore per pastrimin, heqje mbeturina	58,607
B1a	nga biznesi	28,307
B1b	nga familje	30,300
B2	Tarife ndricimi	15,722
B2a	nga biznesi	3,602
B2b	nga familje	12,120
B3	Tarife gjelberimi	10,388
B3a	nga biznesi	4,328
B3b	nga familje	6,060
B4	Tarife per leje sherbimi veterinar	1,500
B5	Tarife sherbimi parkim automjete	5,100
B5a	nga mjetet per biznes	1,600
B5b	nga mjetet personals	2,000
B5c	parking i rezervuar	1,500
B6	Tarife licensa transporti	505
B7	Tarife per licensa karburanti	1,100
B8	Tarife sherbimi per Urbanistikan	300
B9	Tarife per Legalizim, Urbanizim (ALUJZNI)	13,000
B10	Tarife sherbimi dublikate arkivi	85
B11	Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	3,100
B11a	Muzeu Historik	1,500
B11b	Teatri Migjeni	1,400
B11c	Qendra Kulturore Famijeve	100
B11d	Pallati Sportit	100
C	TE ARDHURA JOTATIMORE	18,512
C1	Te ardhura nga qora	720
C2	Te ardhura nga gjendja civile	200
C3	Te ardhura nga bursa (shkollet)	250
C4	Te ardhura nga kopshtet	8,438
C5	Te ardhura nga cerdhet	4,004
C6	Te ardhura nga kundrvajtje administrative	6,900
C6a	gjobe per mosnlyerje detyrimi ne afate ligjore	3,500
C6b	gjobe nga kontrole dhe inspektime	300
C6c	gjobe Policia bashkiake	1,700
C6d	gjoba nga Inspektorati Nderimit Vendor	1,400
D	TE ARDHURA NGA KONTRIBUTE	23,028
D1	Donacione	23,028
D1a	projekte	23,028
D1b	te tjera	0

KRYETARI
Lorenc LUKA

DETAJIMI I BUXHETIT TE VITIT 2013

Tabela 2

000/leke

Nr		TE HYRAT DHE FINANCIMET	SHUMA	Nr	FUNKSIONET	SHPENZIMET DHE TE DALAT						
						TOTALI	Paga	Sig. Shq.	Shp. Oper.	Transf. brend.	Transf. Indiv.	Investime
I	TE ARDHURAT		381,684	1	Sherbime Publike	221,757	6,553	1,061	174,767	-	24	39,252
1	Te ardhurat nga Taksat Vendore		230,737	2	Transporti Publik	747	-	-	-	747	-	-
2	Te ardhurat nga Tarifat Vendore		109,407	3	Infrastruktura rrugore	45,662	-	-	7,500	-	-	38,162
3	Te Ardhurat jo Tatimore		18,512	4	Ujshelles Kanalizime	22,915	3,989	635	3,000	-	30	15,261
4	Kontribute dhe Sponsorizime		23,028	5	Kultura	67,771	31,399	5,113	17,722	4,900	12	8,625
5	Te tjera		-	6	Sporti	56,202	8,889	1,448	24,066	20,000	30	1,769
			-	7	Arsimi	79,136	33,354	5,314	33,326	2,520	100	4,522
II	TRANSFERTAT		373,044	8	Kujdesi Social	36,763	16,583	2,642	7,064	9,306	78	1,090
1	Te Pakushitezuara		373,044	9	Administ. e Bashkise	186,048	104,698	16,895	53,566	8,631	678	1,580
			-	10	Shpenz. te tjera	37,727	-	-	-	37,727	-	-
	TOTALI		754,728		TOTALI	754,728	205,565	33,108	321,011	83,831	952	110,261

KRYETARI
Lorenc LUKA

BURIMI I FINANCIMI - FONDET E VETA

000/leke

NR	EMERTIMI	PLANI 2013	PAGA	SIGURIME SHOQERORE	SHENZIME OPERATIVE	TRANSFERIME BRENDSHME	TRANSFERIME INDIVIDUAL	PROJEKTE	INVESTIME
I	Programi 6260-Sherbime Publike	221,757	6,653	-	1,061	174,767	-	2,060	37,192
II	Programi 4570-Transporti Publik	747	-	-	-	-	747	-	-
III	Programi 4530-Infrastruktura rrugore	45,662	-	-	-	7,500	-	2,860	35,302
IV	Programi 6330-Ujshjelljes Kanalizime	22,915	3,989	-	635	3,000	30	-	15,261
V	Programi 8250-Kultura	67,771	31,399	5,113	17,722	4,900	12	-	8,625
VI	Programi 8140-Sporti	56,202	8,889	1,448	24,066	20,000	30	-	1,769
VII	Programi 9240-Arsimi	79,136	33,354	5,314	33,326	2,520	100	480	4,042
VIII	Programi 10140-Kujdesi Social	36,763	16,583	2,642	7,064	9,306	78	-	1,090
IX	Programi 1110 - Administrat e Bashkise	186,048	104,698	16,895	53,566	8,631	678	-	1,580
X	Programi 4980- Shpenz. te tjera	37,727	0	0	0	37,727	0	0	0
TOTALI (I-X)		754,728	205,565	33,108	321,013	83,831	952	5,460	104,860

BURIMI I FINANCIMI - FONDET E VETA

000/leke

NR	EMERTIMI	PLANI 2013	Shpenzime personeli	Shpenzime tjera	Shpenzime Investime	Ne 20
I	Programi 6260-Sherbime Publike	221,757	7,714	174,791	39,252	29.4%
II	Programi 4570-Transporti Publik	747	-	747	-	0.1%
III	Programi 4530-Infrastruktura rrugore	45,662	-	7,500	38,162	6.1%
IV	Programi 6330-Ujshjelljes Kanalizime	22,915	4,624	3,030	15,261	3.0%
V	Programi 8250-Kultura	67,771	36,512	22,634	8,625	9.0%
VI	Programi 8140-Sporti	56,202	10,337	44,096	1,769	7.4%
VII	Programi 9240-Arsimi	79,136	38,668	35,946	4,522	10.5%
VIII	Programi 10140-Kujdesi Social	36,763	19,225	16,448	1,090	4.9%
IX	Programi 1110 - Administrat e Bashkise	186,048	121,592	62,875	1,580	24.7%
X	Programi 4980- Shpenz. te tjera	37,727	-	37,727	-	5.0%
TOTALI (I-X)		754,728	248,673	405,794	170,262	100.0%

Kryetari
Lorenc LLUKA

NR	EMERTIME	PLANI 2013	PAGA	SIGURIMET SHQERORE	SHPENZIME OPERATIVE	TRANSFERTIME BRENDSHME	TRANSFERTIME INDIVIDUALE	PROJEKTE	INVESTIME
I	Pastrim	98,055	1,197	191	96,667				
2	Gjelberim	28,434	624	100	27,710				
3	Mirembajtje varreza	4,551	130	21	4,409				
4	Mirembajtje Sinjalistika - Dekori	3,730	750	120	2,860				
5	Ndricim rrugor	47,735	3,952	629	43,130		24		37,192
6	Investime Publike	37,192						2,060	
7	Projekte	2,060							
I	Programi 6240-Sherbime Publike	231,757	6,653	1,061	174,767		24	2,060	37,192
1	PTU	747				747			
II	Programi 4570-Transport Publik	747				747			
1	Mirembajtje rruge	7,500			7,500				
2	Investime Publike	35,302						2,860	
3	Projekte	2,860							
III	Programi 4530-Infrastruktura rrugore	45,662			7,500			2,860	35,302
1	Sherbimi I KUB-NLU, jeshelles	7,654	3,989	635	3,000		30		
2	Investime Publike	15,261							15,261
3	Projekte								
IV	Programi 6330-Ujshelles Kanalizime	22,975	3,989	635	3,000		30		15,261
SHERBIME PUBLIKE QALIS		291,081	10,642	1,696	185,267	747	54	4,920	87,755
1	Tearri	28,855	16,718	2,659	2,478	2,500			4,500
2	Dega Pk, Kulture/Aktivitet Kulturor	32,116	14,681	2,454	10,814		12		4,125
3	Aktivite Kulturore	6,800			4,400	2,400			
V	Programi 8250-Kultura	65,771	31,399	5,113	17,732	4,900	12		8,625
1	Sporklub Vilaznia	36,056	8,889	1,448	24,066		30		1,623
2	Sh.a Futbolit	20,000				20,000			
3	Investime sporti	146							146
VI	Programi 8140-Sporti	56,203	8,889	1,448	24,066	20,000	30		1,769
1	Arsiani	78,064	33,354	5,314	33,326	2,520	100	480	3,450
2	Investime/Projekte	1,072							592
VII	Programi 9240-Teatri	79,136	33,354	5,314	33,326	2,520	100	480	4,042
1	Cerdhe	27,003	16,583	2,642	6,610		78		1,090
2	Sherbime Sociale	1,760			454	1,306			
3	Projekti Shpresa	8,000				8,000			
VIII	Programi 10440-Kajdesi Social	36,763	16,583	2,642	7,064	9,306	78		1,090
1	Administrata e Bashkise	178,548	101,698	16,895	53,566	1,131	678		1,580
2	Detyrimi I Keshillit te Qarkut	7,500				7,500			
IX	Programi 3110-Administrata e Bashkise	186,048	104,698	16,895	53,566	8,631	678		1,580
1	Fondi I Santigjences	14,699				14,699			
2	Spensione te tjera -Donator	23,028				23,028			
X	Programi 4980-Siperc te tjera	37,727				37,727			
TOTAL (I-X)		754,728	205,565	33,108	321,011	83,831	952	5,400	101,861

Kryetari
Lorenc JUKA



BASHKIA SHKODER



BUXHETI 2013

QYTET I TRADITES
DREJT SE ARDHMES EUROPIANE

Te Nderuar Anetare te Keshillit te Bashkise Shkoder !

Te Nderuar Qytetare te Shkodres !

Te nderuar te ftuar!

Zonja e zoterinj!

Prezantojme sot perpara Jush dhe gjithë Qytetareve te Shkodres rezultatet ekonomiko-financiare dhe te gjithë punen e bere gjate vitit 2012 dhe dokumentin e plan buxhetit per vitin 2013 së bashku me elementet perberes te tij.

Ju kemi prezantuar per shqyrtim Projekt-Vendimet e mëposhtme:

- Projekt vendimin per "Miratimin e buxhetit te vitit 2013 "
- Projekt vendimin "Per miratimin e paketes fiskale per vitin 2013 "
- Projekt vendimin per " Miratimin e struktures organizative te Administrates se Bashkise Shkoder per vitin 2013"
- Projekt vendimin per "Miratimin e struktures organizative te institucioneve ne varesi te Bashkise Shkoder per vitin 2013 "

Buxheti i vitit 2013 mbështetet ne legjislacionin perkates, ne planet e dokumentet strategjike dhe programet e zhvillimit te qytetit, ne programin politik te prezantuar qytetareve per periudhen 2011-2015.

Qellimi kryesor i ketij plan buxheti, si dokumenti me i rendesishëm vjetor ne punen e administrates se bashkise, vazhdon te jete rritja e cilesise se jetes se banoreve nepermjet permiresimit te infrastruktures, permiresimit te sherbimeve publike, zhvillimit ekonomik, social kulturor e mjedisor.

Të aspirosh një qytet bashkëkohor për ne do të thotë, sëpari të pretendosh për **modele dhe standarte europiane të qeverisjes** dhe në të njëjtën kohë të punosh dhe të ofrosh rezultate te prekshme dhe të dobishme për të gjithë.

Ky është një model që Shkodra e meriton, një qeverisje e sukseshme, e aftë të arrijë tek cdo banorë e biznes, një qeverisje jo nga zyrat por me JU dhe per te gjithë JU, për një të ardhme të qytetit të mbështetur në balancimin dhe integrimin në harmoni me vlerat qytetare të Shkodrës.

Padyshim sfida jonë si qeverisje është të punojmë me vizion dhe profesionalizëm për të krijuar të gjitha mundësitë dhe hapsirat për t'i bërë të gjithë pjesë të këtij zhvillimi intensiv, për një jete të shëndetshme, ku qytetarët, vlerat trashëgimore, shërbimet dhe mjedisi janë prioritetet e veprimtarisë sonë.

Le të hedhim një vështrim se si Shkodra ka qenë vite me parë. Në përgjithësi situata e infrastrukurës urbane, e rrjetit të rrugëve urbane dhe lidhjet e tyre me rrjetin kombëtar e me gjere, infrastruktura nëntokesore (rrjeti i kanalizimeve të furnizimit me ujë, rrjeti i KUZ-ve dhe KUB-ve) kanë qenë në një gjendje mjaft kritike. Gjatë këtyre viteve, kemi projektuar, realizuar dhe janë në proces zbatimi një sërë projektesh strategjike, disa nga të cilat në bashkëpunim të ngushtë me shumë partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë janë:

- Ruajtja dhe rehabilitimi i zonës historike.
- Ndërtimi i korridoreve rrugore rreth qytetit - ByPass-i perëndimor dhe unaza lindore të qytetit
- Rehabilitimi i sistemit të ujrave të qytetit në bashkëpunim me qeverinë gjermane, austriake dhe zvicerane
- Ndërtimi i rrugës me korsë të dedikuara për këmbësorët, bicikletat dhe automjetet në zonën turistike Ura e Bunës – Shirokë.

Si asetë jetike të qytetit rezultojnë 300 mijë m² rrugë të rikonstruara ose të ndërtuara rishtazi me një gjatësi prej 50 km, 44 mijë m² trotuare dhe 47 mijë m² sipërfaqe të gjelbra të rikonstruara, 181 rrugë urbane të ndriçuara.

Një tjetër arritje e rëndësishme ka qenë reformimi i shërbimit të transportit urban qytetas, duke përmirësuar në mënyrë të dukshme cilësinë e këtij shërbimi për qytetarët duke mbuluar shërbimin jo vetëm në linjat tradicionale, por edhe të linjave të reja si përgjigje e kërkesës së qytetarëve për zgjerimin e këtij shërbimi.

Në kemi orientimin tonë për të ardhmen e Shkodrës si një qytet me një mobilitet urban aktiv, të pastër dhe efikas.

Në e kuptojmë se sot në jemi duke u ndeshur me fenomenin e rritjes së trafikut të automjeteve sic ka ndodhur në të gjitha vendet e tjera perëndimore në Europë.

Në jemi të vendosur dhe të angazhuar për të zbatuar koncepte të reja bashkohore në mobilitetin urban të qëndrueshëm, i cili përfaqëson një koncept të ri për ne dhe për shumë qytete në Shqipëri.

Një aktivitet shumë i rëndësishëm për këtë vit mbi Levizshmerinë Urbane ishte zhvillimi i Konferencës së parë Ndërkombëtare të organizuar mbi këtë temë, si përpyetje e vazhdueshme e Bashkisë Shkoder për ruajtjen e traditave të levizshmerisë urbane si element kyç të përmirësimit të cilësisë së jetesës së komunitetit.

Vizioni që në kemi për zhvillimin e qytetit na ka dhënë hapësirë të qartë në orientimet e zhvillimit urban të qytetit dhe përcaktimin e prioriteteve të investimeve publike.

Zhvillimi urban i qytetit fokusohet kryesisht në këto drejtime: qendër e rëndësishme ekonomike, qendër e rëndësishme universitare dhe zhvillimin turistik nepermjet zhvillimit të zonave bregliqenore , lumore dhe zhvillimit te qendres historike.

Nisur nga ky vizion drejtimi i investimeve tona eshte perqendruar ne rikualifikimin e territorit nëpërmjet arkitekturës dhe dekorit urban, shtimit te hapësirave të reja publike për qytetarin, nderhyrjeve ne rehabilitimin e rrugeve dytesore, blloqeve te pallateve, krijimit te siperfaqeve te gjelbra, sistemimit te shesheve, etj. Jane ne proces disa projekte te rendesishme si nderhyrja per rehabilitimin e fasadave te rruges “28 nentori dhe 13 dhjetori” si pjese e projektit tone per rikualifikimin e qendres historike te qytetit, hartimi i projektit per ndertimin e nenkalimit te Sheshit “Nënë Tereza”, hartimi i studimit per “Kompleksin Sportiv“, hartimi i projektit per tregjet etj., te cilet jane pjese e politikës sone per krijimin e hapësirave te reja ne sherbim te qytetareve.

Zhvillimi multifunksional dhe i integruar i brigjeve të liqenit Shkodrës po mbeshetet nepermjet zbatimit te projektit per zgjerimin e Rruges Shkoder- Shiroke si edhe krijimin e rreth 10.000 m2 siperfaqe te gjelber ne kete zone. Vazhdimi i punes per ndertimin e By-Pass-it pjesa perballë liqenit do te jete panoramike dhe me nderhyrje ne mbrojtje te mjedisit e ne funksion te zhvillimit te zonave bregliqenore.

Dhenia perparësi e Zhvillimit te Zones Industriale ka bere qe nje pjese e investimeve te drejtohen ne kete zone dhe pas perfundimit te infrastruktures nentokesore eshte mundesuar investimi per rikonstruksionin e rruges Industriale I.

Prioritare ne investime do te jene investimet ne infrastrukture per sa i perket rrugeve dytesore, investime per sistemimin e hapësirave ndermjet blloqeve te banimit, per permiresimin e mjedisit, per kthimin ne identitet te objekteve te trashegimise kulturore nepermjet restaurimit te fasadave, investime permiresuese per varrezat e deshmoreve, etj.

Detyrimi yne ligjor ne fushen e planifikimit te territorit dhe ne funksion te politikës se Bashkise Shkoder, i eshte kushtuar nje rendesi e vecante administrimit ne menyre korrekte te situates ndertimore ne qytet. Gjate vitit 2012 jane futur ne tregun e pasurive te patundshme rreth 232 njesi / apartamente si edhe rreth 174 njesi tregtare me nje vlere rreth 6.3 milion euro.

Ne drejtim te zhvillimit ekonomik, nje iniciative e partneritetit publik privat, u realizua nga Bashkia Shkoder dhe Fondacioni per Zhvillim Shqiptaro – Amerikan ne bashkepunim te ngushte me komunitetin e biznesit dhe pronaret e rrugeve “13 Dhjetori” dhe “28 Nentori”. Krijimi nga keto biznese i shoqates “Rruga “28 Nentori” mundesoi krijimin e marredhenieve te reja ndermjet biznesit dhe bashkise me nje perfshirje aktive ne te gjithe procesin e krijimit te zones per permiresimin e biznesit dhe ritjen e mundesive investuese ne kete zone.

Ne kuader te ketij bashkepunimi eshte duke u zbatuar nje nga projektet infrastrukturore me te rendesishem te qytetit, shetitorja e rruges "13 Dhjetori dhe 28 Nentori", me nje prespektive zhvillimi shume vjeçare te zones, kthimin ne nje nga zone te rendesishme te levishmerise kembesore per qytetaret dhe vizitoret. Projekti ne fjale ka nje lidhje harmonike me elementet arkitekturor te ndertesave te rrugëve si dhe me asetet e tjera publike. Pjese e rendesishme e ketij projekti edhe rikonstruksioni pjesor i Qendres Kulturore per Femije duke rritur hapesirat funksionale ne sherbim te femijeve.

Zhvillimi i turizmit si nje katalizator i fuqishem i rritjes ekonomike perben gjithnje nje nder prioritetet me te rendesishme te administrates se Bashkise. Rritja e vazhdueshme e interesit per te vizituar rajonin tone dhe numri gjithnje ne rritje i turistëve qe vijne ne qytetin tone e vene Bashkine e Shkodres para pergjegjesish dhe sfidash te reja per të menaxhuar ne menyren me te mire te mundshme keto zhvillime pozitive.

Vizioni yne eshte qe Shkodra te shnderrohet brenda nje kohe te shkurter ne nje nder destinacionet elitare te rajonit dhe te konkurroje me sukses destinacionet rajonale. Potencialet e konsiderueshme qe zoteron qyteti dhe zonat perreth na japin nje mundesi te arte ne zhvillimin e turizmit kulturor, ekologjik dhe familjar. Investimet e kryera ne ruget kombetare dhe te qytetit kane ndikuar ne shkurtimin e distancave dhe te kohes gje qe e ka bere qytetin me te arritshem dhe me te vizitueshem.

Rendesi te vecante kane pasur nderhyrjet e rendesishme rikualifikuese te objekteve monument kulture me qellim evidentimin dhe promovimin e vlerave te rralla qe ata perfaqesojne. Nder keto nderhyrje mund te permendim rikonstruksionin e rruges "Gjuhadol", "28 Nentori" e "13 Dhjetori", ndricimin e Kalase "Rozafa", rikonstruksionin e kules se Gjon Marka Gjoni, shtepise se Pashko Vases, ndertimin e Muzeut te Genocidit Komunist, etj.

Gjallerimi i metejshe i jetes kulturore te qytetit favorizon terheqjen e vizitoreve jo vetem nga jashte Shqiperise por edhe atyre vendas qe jane nje element shume i rendesishem i tregut turistik.

Te nderuar keshilltare,

Nje nga angazhimet tona te hershme ka qene krijimi i nje sistemi menaxhimi efektiv, transparent , nepermjet perdorimit te teknologjise se informacionit .

Ky sistem do te krijojë kushte te favorshme per administraten qe te sherbeje ne menyre efektive dhe eficient nepermjet krijimit dhe menaxhimit te nje rrjeti elektronik te brendshem me qellim menaxhimin me efikas te sherbimeve ndaj qytetareve dhe biznesit.

Ngritja e zyrës me një ndalesë në Bashkinë Shkoder është një ndër projektet e rëndësishme për institucionin tonë, projekt që perkon me prioritetet e qeverisë shqiptare për futjen e teknologjive të reja të informacionit me qëllim përmirësimin rrethësor të shërbimeve ndaj qytetarit dhe aplikimin e qeverisjes elektronike në të gjitha nivelet e saj.

Me ngritjen e kësaj zyre, qytetarët do të kenë mundësi të marrin nga një zyrë e vetme, brenda një kohe minimalisht të mundshme, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kërkesave të tyre.

Bashkia Shkodër është aktive në programet e integruara rajonale të bashkëpunimit konkretisht IPA Shqipëri-Mali i Zi, IPA / Adriatik dhe programeve të tjera të vendeve të Komunitetit Europian për Shqipërinë të cilat synojnë forcimin e bashkëpunimit ekonomik, social, kulturor, mjedisor dhe të fqinjësisë së mirë. Këto programe do të fuqizojnë dhe mbështesin kryesisht biznesin e vogël, të artizanit dhe turizmit, shtresat në nevojë nëpërmjet aplikimit të praktikave me të mira në shërbim të tyre, ngritjes së kapaciteteve të administratës publike për t'ju përgjigjur proceseve integruese të vendit për të cilën po aspirojmë për të qenë pjesë e familjes së madhe Europiane.

Vetëm gjatë vitit 2012, si rezultat i një bashkëpunimi intensiv dhe të suksesshem kemi aplikuar në 7 projekte IPA Shqipëri – Mali i Zi në tre akse kryesore, Promovimi dhe mbrojtja e mjedisit, Zhvillimi ekonomik me theks në promovimin e turizmit dhe Përmirësimi i kohezionit social. Vlera totale e aplikimeve kap shifrën rreth 1 milion euro mbështetje për bashkinë Shkoder. Disa nga partnerët kryesorë në këto projekte janë qytetet e Tivarit, Cetines, Ulqinit, si dhe diskutere dhe institucione qendrore të palës Malazeze dhe organizatave të shoqërisë civile.

Politikat fiskale dhe strategjia e rritjes së të ardhurave bashkiake, bazohen në rritjen e bazës së taksapaguesve, në rritjen e konkurrencës së ndershme, në goditjen e evazionit fiskal, në uljen e numrit të subjekteve debitore, në ndërtimin e marrëdhënieve korrekte dhe transparente me taksapaguesit.

Kemi dhe synojmë të zhvillojmë një bashkërendim shumë të mirë të punës me institucionet të tjera si Drejtoria Rajonale Tatim-Taksave, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Zyra Regjistrimit të Pasurive Paluajtshme, Komisariati i Policisë, Drejtoria e krimit ekonomik, etj.

Në kuadrin e përmirësimit të klimës së biznesit në Shkoder, prane sporteleve të bashkisë ofrohet një shërbim cilësor ndaj tatimpaguesit. Ky shërbim që nxit frymën e hapur dhe bashkëpunuese ndaj tatimpaguesve, i ofrohet si bizneseve ashtu edhe familjareve prane sporteleve të shërbimit në mënyrë të përgjegjshme, profesionale .

Per rritjen e te ardhurave dhe trajtimin ne menyre te barabarte te te gjitha bizneseve, jane ndjekur masa shtrenguese edhe per subjektet debitorc.

Arketimet per taksa dhe tarifa familjare kane ardhur çdo vit ne rritje, kjo kryesisht nepermjet sensibilizimit te taksapaguesve familjare, dhe ndjekjen e masave shtrenguese per kete qellim. Mbledhja e tarifave familjare nepermjet ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve do te vazhdoje edhe ne vitin 2013 si agjent tatimor per te cilen do te jete e nevojshme forcimin e mekanizmave per zgjerimin e bazes se taksapaguesve familjare.

Ne paketen fiskale te viti 2013 nuk ka rritje te taksave dhe tarifave, por vetem disa perrimesime te procedurave funksionale ndermjet drejtorive dhe institucioneve qe krijojne te ardhura per bashkine.

Gjate ketij viti jane ofruar nje sere sherbimesh publike cilesore te shoqeruara me investime perkatese. Jane rikonstruktuar rruget "30 Korriku", "At Shtjefen Gjeçovi", rruga pas Stacionit te trenit, rruga Musa Luli, rruga "At Donat Kurti", rruga "Beslidhja", rruge dytesore, etj

Viti 2012, si viti i 100 vjetorit te pavaresise u shoqerua me nje numer te madh aktivitetesh festive nga te gjitha institucionet kulturore dhe sportive te bashkise. Duke lilluar nga festat dhe festivalet tashme tradicionale te pervitshme si Karnevalet, Dita e luleve, Dita e Liqenit të Shkodrës, Mini koncertet e veres, Dita e lumturimit te Nane Terezes, si dhe festivalet Anifest Rozafa, Giffoni Festival, Festivali Kombetar i Femijeve duke kulmuar me organizmet per festat e Nentorit.

Me nje vemendje maksimale per sportin u mbeshtet edhe per vitin 2012 KF Vllaznia sha per te cilen theksojme se synojme perfshirjen aktive te biznesit ne menaxhim dhe financim. Po keshtu vazhdon mbeshtetja ne buxhet per klubin shumesportesh me synim shnderrimin gradual te ketyre sporteve sipas percaktimeve ligjore. Mbeshtetja e partneritetit pulik privat edhe ne sport e mendojme si te domosdoshme dhe te frytshme per prosperitetin e sporteve dhe te sportistev.

Sherbimi social, per vitin 2012, duke u mbeshtetur tek Planit Social Zonal ofroj sherbimet e saj sipas target-grupeve te parashikuara per femije, gra dhe te moshuar me prioritet sherbime sociale alternative per keto kategori sipas problematikave qe secili grup paraqet. Kjo mbeshtetje do te vazhdoje edhe ne 2013 dhe ne vecanti do te aplikojme mbeshtetjen per personat me aftesi ndryshe nepermjet projektit "Shpresa" ne perputhje me aneksin 5 te ligjit per buxhetin kombetar te vitit 2013 dhe standarteve te sherbimit social.

Te Nderuar Keshilltare,

Gjate ketij viti, propozimet dhe vendimet tuaja kane sherbyer per te percjelle edhe kendveshtrimin e njerezve me te cilet jeni ne kontakte te vazhdueshme. Bashkepunimi i ndertuar me administraten e bashkise ka sherbyer per te pershtatur pritshmerite e qytetareve me burimet dhe mundesite.

Ne kemi bere perpjekje maksimale per te siguruar burime financiare dhe ekspertize teknike per te ruajtur dhe rritur ritmet e zhvillimit te parashikuara ne strategjite tona te zhvillimit lokal dhe rajonal. per kete deshirojme te shprehim falenderime te vecanta dhe mirenjohje te gjithe donatoreve per asistencen financiare dhe teknike, per frymen e besimit dhe te bashkepunimit me administraten e bashkise Shkoder.

Mediat edhe gjate ketij viti, ne funksion te misionit te tyre, kane qene nje partner i rendesishem sidomos per te percjelle nga qytetaret problematikat e tyre. Per te gjithe kete fryme konstruktiviteti deshirojme t'i percjellim falenderime te vecanta.

Falenderim i vecante i takon Qytetareve te Shkodres, te cilet me mbeshtetjen, bashkepunimin, verezjtet dhe vleresimet na kane ndihmuar dhe orientuar ne permiresimin e vazhdueshem te punes sone.

Se fundmi, deshiroj te ritheksoj bindjen qe ne kete projekt buxhet jemi perpjekur te paraqesim arrijtet, sugjerimet dhe synimet per realizimin e angazhimeve te perbashketa ne fushen e investimeve, sherbimeve publike, politikave urbane, kulturore, sociale, sportive, mjedisore, dhe per kete kam kenaqesine t'Ju ftoj ne nje vendimarrje aprovuese sa me konsensuale.

Ju faleminderit.

Lorenc LUKA



BASHKIA SHKODER

Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar te Vitit 2012 dhe Plan Buxheti i Vitit 2013

Propozuar Keshillit Bashkiak me 28 Dhjetor 2012

PERMBAJTJA

Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar

	<i>faqe</i>
1. PAMJE E PERGJITHSIEME	3
2. TE ARDIURAT	5
2. SHERBIMET PUBLIKE	12
3. PLANIFIKIMI URBAN	24
4. DREJTORIA KULTURES RINISE DHE SPORTEVE	27
5. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT	38
6. DREJTORIA JURIDIKE	40
7. ADMINISTRATA	43

Plan Buxheti i Vitit 2013

	<i>faqe</i>
1. BURIMET E FINANCIMIT	49
2. TE ARDHURAT	50
3. TE ARDHURAT NGA BURIMET KOMBETARE	55
4. KAPITULLI I SHPENZIMEVE	57
8. SHERBIMET PUBLIKE	62
9. PLANIFIKIMI URBAN	82
10. DREJTORIA KULTURES RINISE DHE SPORTEVE	84
11. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT	101
12. DREJTORIA JURIDIKE	104
13. ADMINISTRATA	106

PAMJE E PERGJITHSHME

Bashkia Shkoder per miratimin e buxhetit te vitit 2012 eshte mbeshtetur ne referencen ligjore te meposhtme:

I. Ligji Nr.8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore",

- Neni 15: Percakton parimet mbi te cilat do te behen financimet e njesive te qeverisjes vendore; "ato garantojne autonome dhe funksionimin e qeverisjes vendore nepermjet njohjes se te drejtes se llojshmerise se burimeve ne formen e tatimeve, taksave, tarifave e te ardhurave te tjera, te transferuara nga pushteti qendror; dhenies se autoritetit per krijimin e te ardhurave per krijimin e te ardhurave ne menyre te pavaruar; dhienien e fondeve te kushtezuara nga qeverisja qendrore ne funksion te kompetencave te deleguara dhe nepermjet dhenies se te drejtes per hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit te vet vjetor"
- Neni 16: Te ardhurat e veta te Bashkise ku percaktohen llojet e te ardhurave, baza, kufijte e nivelit te tyre; percaktohen te drejtat e perdorimit te pronave publike, te dhenies se lejeve, autorizimeve, certifikatave si dhe sherbime te tjera ekskluzive lokale.
- Neni 17: Percaktohet pjesemarrja lokale ne tatimet kombetare, duke perfshire transfertat te kushtezuara dhe te pakushtezuara
- Neni 19: Percakton parimet kryesore per hartimin e buxhetit lokal si: "buxheti te jete gjithmone i balancuar; te perfshije elementet e shpenzimeve dhe te ardhurave; transfertat e kushtezuara te perdoren vetem per qellimin e dhene dhe qe nuk trashegohen ne vitin pasardhes; te ardhurat vendore qe nuk jane te kushtezuara te perdoren per qellime qe percaktohen nga organi vendimmarres dhe trashegohen ne rast se nuk harxhohen; krijimi i fondit rezerv ne masen deri ne 3% te shpenzimeve te planifikuara";
- Neni 32: "detyra me e rendesishme e Keshillit eshte miratimi i buxhetit vjetor si dhe i ndryshimeve dhe amendamenteve gjate vitit mbi buxhetin. Me fuqizimin e autonomies vendore dhe thellimin e metejshem te decentralizimit fiskal, buxheti behet nje instrument i rendesishem qeverises. Keshilli ndjek nga afer gjithnje proceduren e pergatitjes, miraton dhe ndjek miratimin e buxhetit nepermjet komisionit te finances".

II. Ligji nr.9936 Date 26.6.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise"

- Neni 6 : ku thuhet “ Buxheti vendor perfshin te gjitha te ardhurat,shpenzimet dhe financimet e njesise se qeverisjes vendore.....Buxheti vendor eshte i balancuar pervec rasteve kur merrret hua per financimin e projekteve te investimeve .Buxheti vendor eshte i balancuar ne termat e arketimeve dhe te pagesave.Te gjitha te ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit vendor jane ne terma bruto”.
- Neni 16: ku thuhet “Keshilli i njesise se qeverisjes vendore,me vendim te vecante,miraton te ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore per njesite e qeverisjes vendore dhe fondet speciale te tyre,me qellim kryerjen e shpenzimeve per ushtrimin e funksioneve qe kane ,si dhe huamarrjen ,per financimin e projekteve te investimeve.”
- Neni 17: ku thuhet “Kryetari i njesise se qeverisjes vendore propozon drejtimet kryesore te politikës se njesise se qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin ne keshillin perkates te njesise se qeverisjes vendore.”
- Neni 32 : ku thuhet “ Keshilli i qeverisjes vendore brenda dates 31 dhjetor ,miraton buxhetin vendor ne baze te vlersimit te te ardhurave dhe te transfertave te pakushtezuara, te percaktuara ne ligjin e buxhetit vjetor.”
- Neni 44 : ku thuhet : “Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi;
 - ❖ rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore, nga e cila varët njësia shpenzuese.”

III. Ligji 10296 date 26 Korrik 2010 “ Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”

- Kreu II: Përgjegjësmeria menaxheriale
- Kreu III : Harmonizimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit



TE ARDHURAT

Te ardhurat e Bashkise Shkoder perbehen nga:

I.1 TE ARDHURAT E VETA

Ndarja e te ardhurave sipas kategorive:

1. Te ardhura nga taksa vendore:

Taksat ndahen si me poshte:

Taksa vendore e biznesit te vogel

Zbatohet nga çdo subjekt, kur e ardhura bruto vjetore gjate vitit fiskal eshte me e vogel ose e barabarte me 8.000.000 Leke. Kategorite e bizneseve sipas llojit jane: shitje (shumice dhe pakice), prodhim, sherbim dhe profesione te lira.

Nivelet treguese te taksës orientohen sipas aneksit 5 te Ligji 9632 „Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me te drejten per ndryshim -30/+10% nga organi legjislativ i bashkise.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Taksës mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithë personat fizike ose juridike, biznese dhe familjare, pronare te pasurive ndertesa dhe toke bujqesore. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nivelet treguese te taksës orientohen sipas aneksit 1 dhe 2 te Ligji 9632 „Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me te drejten per ndryshim +/-30% nga organi legjislativ i bashkise.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja

Baza e taksës eshte vlere ne Leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet, ndersa niveli shprehet si perqindje e vleres se investimit dhe shlyhet nga investitori. E ardhura nga kjo takse mblidhet nga organi qe leshon lejen e ndertimit.

Taksa vjetore e mjeteve te perdorura te transportit rrugor

Detyrimi per kete takse llogaritet sipas pikes 3, te nenit 4 te Ligjit Nr. 9975, dt. 28.07.2008 “per Taksat Kombetare” i ndryshuar. Detyrimi per taksën i takon pronarit te mjetit sipas vendbanimit ose selise se tij. E ardhura nga taksa mblidhet nga strukturat e Drejtorise Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor.

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise bazuar ne siperfaqen e ndertimit te prones qe transferohet nga personi qe kalon te drejten e pronesise, dhe llogaritet nga zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rolin e agjentit tatimor.

Taksa e fjetjes ne hotel

Baza e takses eshte çmimi i fjetjes, sipas rastit, per dhome ose per person, per nje natë. Niveli i takses eshte 5% e çmimit te fjetjes. Detyrimi per taksen i takon klientit qe strehohet ne hotel dhe mbahet nga hoteli per llogari te bashkise.

Taksa te tjera:

Taksa per zenien e hapësirës publike per qellime biznesi llogaritet si detyrim mujor dhe shprehet ne meter katror siperfaqe publike te zene.

Taksa e tabelës ndahet sipas qellimit te tabelës ne:

-tabela per bizneset per qellime identifikimi, te trupezuar ne siperfaqen e ndertesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin, dhe kur nuk perdoret per te reklamuar aktivitetin e te treteve.

-tabela per qellime reklamimi, te thjeshta dhe elektronike.

2. Te ardhura jo tatimore

Te ardhura nga tarifat vendore, siç jane tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit vilen ne baze te ligjit 8652, dt. 31.07.2000 „Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“, dhe paguhen nga bizneset, institucionet e familjaret. Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per sherbimet publike qe ofron, si pastrim, gjelberim, ndriçim, duke u orientuar ne pergjithesi ne perafimin e koston se tyre.

Te ardhura te tjera jotatimore, siç jane te ardhura nga veprimtarite ekonomike, te ardhura nga shitja e pasurive kapitale te njesise vendore te lejuara me ligj, te ardhura nga qerate mbi trojet, ndertesat dhe objektet e tjera vendore, te ardhura nga kontribute dhe sponsorizime te ndryshme, si ndihma, dhurime, sponsorizime, te ardhurat nga gjobat dhe kundravajtjet administrative“, si dhe nga te ardhura te tjera.

Te ardhura nga institucione varesie te njesive te qeverisjes vendore, ku bejne pjese pagesat per çerdhet, pagesat per kopshtet, pagesat e nxenesve te shkollave te mesme, pagesat nga konviktore me burse, gjysme-burse si dhe te ardhura te tjera nga institucione vendore.

ANALIZA E TE ARDHURAVE PER VITIN 2012

Burimet e financimit te qeverisjes vendore perbehen nga:

1. Te ardhurat e veta

- Taksat vendore, Tarifat, Te ardhura jo tatimore (te tjera, institucione ne varesi te Bashkise), Huatë.

2. Te ardhurat nga burime kombetare, qe ndahen ne:

- Transferta te pakushtezura
- Transferta te kushtezuara

TE ARDHURAT E BASHKISE DHE ELEMENTET NDIKUES

Te ardhurat e parashikuara nga biznesi, duke perfshire edhe taksen e ndikimit ne infrastrukture, zene 55% te te ardhurave te veta, ndersa se bashku me taksat dhe tarifat familjare, duke perfshire edhe parkingun per mjetet personale, zene rreth 70% te te ardhurave te Bashkise Shkoder. Per kete arsye eshte e rendesishme per vijueshmerine e mbare te buxhetit te Bashkise Shkoder dhenia e rendesise se duhur dhe trajtimit ne menyre te vecante te ketyre te ardhurave dhe kushteve per mbarevajtjen dhe vjeljen e tyre.

Te dhenat per biznesin perpunohen, ruhen dhe administrohen nepermjet sistemit te kompjuterizuar fiskal, qe ofron shpejtesi ndaj tatimpaguesit, siguri ne ruajtjen e te dhenave

Te dhenat per taksapaguesit familjare perpunohen dhe administrohen nepermjet sistemit te kompjuterizuar te Ujesjelles Kanalizime Sh.A., qe ne rolin e agjentit tatimor bashke me tarifat per sherbimin e ujit vjel edhe taksat dhe tarifat familjare. Taksat dhe tarifat vilen ne baze mujore, dhe paguhen ne cdo arke te Ujesjelles Kanalizime Sh.A te shperndare ne qytetin e Shkodres.

Per familjet me kryefamiljare pensioniste, status invaliditeti ose me ndihme ekonomike qe dorezojne dokumentacionin dhe plotesojne kushtet sipas paketes fiskale te vitit 2012 eshte aplikuar lehtesia sociale. Kjo lehtesi e aplikuar per vitin 2012 ka pasur nje efekt 5.880.000 Leke ne te ardhurat e Bashkise.

Ne kuadrin e permiqesimit te klimes se biznesit ne Shkoder, prane sporteleve te Drejtorise se te Ardhurave kryhet sherbimi ndaj tatimpaguesit, ku kryet informimi dhe rifreskimi me kuadrin ligjor dhe fiskal ne fuqi per tatimpaguesit qe kerkojne informacion mbi legjislacionin dhe procedurat. Ky sherbim qe nxit frymen e hapur dhe bashkepunuese ndaj tatimpaguesve, i ofrohet si bizneseve ashtu edhe familjareve prane sporteleve te sherbimit ne menyre te pergjegjshme, profesionale dhe pa pagese.

Ne mbështetje te programit te Bankes Boterore /IFC jane thjeshtuar dhe lehtësuar paketat e procedurave, duke ndjekur legjislacionin dhe duke i bere me te kuptueshme dhe me transparente. Gjate vitit 2012, ne zbatim te ligjit Nr.10/354, datë 18.11.2010, eshte bere kompensimi i biznesit te vogel per shumen e rimbursueshme per taksen vendore per vleren e kasave fiskale me vlere 27.208.034 Leke.

Ne zbatimin e kuadrit ligjor fiskal, per uljen e evazionit fiskal me ndikim te drejtperdrejte ne rritjen e te ardhurave te bashkise jane ndermarre nje sere aksionesh te Drejtorise se te Ardhurave ne bashkëpunim me Policine Bashkiake per goditjen e bizneseve te paliqensuara.

Gjithashtu nga Drejtoria e te Ardhurave eshte marre inisiativa e krijimeve te grupeve te perbashketa Task-Force, me perfshirjen e Inspektoreve te Drejtorise Ardhurave, Policise Bashkiake, Tatim – Taksave, Hetimit Tatimor dhe Policise se Shtetit. Keto aksione u perqendruan kryesisht ne periudhen Qershor – Korrik dhe Shtator – Tetor 2012, ku si rezultat i masave shtrenguese te ndermarra u realizuan 260 liqensime te reja.

Per rritjen e te ardhurave dhe trajtimin ne menyre te barabarte te te gjithë bizneseve, jane ndjekur masa shtrenguese edhe per subjektet debitore. Pas perfundimit te afateve ligjore per njoftim, Drejtoria e te Ardhurave, ne bashkepunim me Policine Bashkiake, ka ndjekur masat shtrenguese bllokim te aktivitetit dhe sekuestrim te mallit ndaj bizneseve debitore per taksen biznesit te vogel dhe per detyrimet e tjera si reklama, hapesira pubike e parkingje te rezervuara.

Gjate vitit 2012 jane ushtruar 350 kontrole prane bizneseve kryesisht ne lidhje me dokumentacionin e mbajtur ligjor dhe xhiron vjetore. Si rezultat i ketyre aksioneve jane bere rreth 200 rivleresime xhiroje dhe gjoba per mangesi ne dokumentacion.

Strategjia e rritjes se te ardhurave si nga biznesi ashtu dhe nga familjaret shihet ne shtrirjen e bazes se taksapaguesve dhe ne sakesimin e te dhenave te subjekteve, gje qe realizohet nga Drejtoria e te Ardhurave dhe nepermjet bashkerendimit te punes me drejtorite paralele te bashkise dhe institucionet e pushtetit qendror si Drejtoria Rajonale Tatim-Taksave, Zyra Regjistrimit Pasurive Paluajtshme, QKR etj..



Arketimet per taksa dhe tarifa familjare kane ardhur çdo vit ne rritje, kjo kryesisht nepermjet sensibilizimit te taksapaguesve familjare, kontaktet nga afer me institucionet shtetore per shlyerjen nga punonjësit buxhetore te ketij detyrimi, ne ndjekjen e masave shtrenguese si bllokimi i sherbimeve neper njesite administrative te bashkise si dhe deri ne bllokimin e llogarive bankare per tatimpaguesit debitore.

STRUKTURA E BIZNESIT

Struktura e bizneseve qe ushtrojne aktivitetet ne Bashkine Shkoder eshte aktive dhe dinamike, fale politikave dhe strategjive lchtesuesc dhe pershpjtuuese, qe orientojne tregun e lire ne gjithë shtrirjen e tij.

Shperndarja sipas llojit te aktivitetit

33 % ushtrojne tregtim artikuj industriale



21 % bar – kafe dhe restaurante, hoteleri
 19 % tregti konfeksione
 12 % ushqimore
 5 % subjekte ndertimi
 10 % sherbime te tjera









Te ardhurat e veta luajne nje rol te madh per sigurimin e burimeve financiare ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj. Burimet kryesore jane taksat dhe tarifat e bizneseve dhe familjeve.

Synimet kryesore jane fokusuar ne rritjen e bazes taksapaguese, rritjen e konkurrences se ndershme, goditjen e evazionit fiskal, uljen e numrit te subjekteve debitore, implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe ndertimin e marrëdhënieve te mira me taksapaguesit.


Ne te ardhurat e vitit 2012 kane pasur ndikim faktore te ndryshem, ku mund te permendet rritja e sensibilitetit te biznesit per perfshirjen ne skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritja e ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, përqendrimi i administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe bashkepunimi i mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.

Faktore ne tejkalimin e planit ne disa rubrika jane: ulja e disa tarifave vendore, shtimi i numrit te bizneseve qe shfrytetojne hapësirat publike per reklama, parkingje ose vendosje tavolinash, fluksi i veprimeve ne ZRPP-ne Shkoder me ndikimin e ligjit per rivlersimin e pasurive qe rezultoi me tejkalimin e planit per taksen e kalimit te te drejtes se pasurise, fluksi ne ZRRrMTRr Shkoder etj.


Efekt ne te ardhurat totale te Bashkise Shkoder ne lidhje me planin kane pasur taksa e ndikimit ne infstrukture nga procedura perkatese rregullatore ne proces dhe numri i vogel i kerkesave per leje ndertimi, tarifa per legalizim dhe urbanizim, si rrjedhoje e moslikuidimit te numrit te pritur te aplikuesve, tarifa e parkingut per mjetet personale si pasoje e numrit te vogel te pronareve te mjeteve te paraqitur ne sportelin e bashkise ne mjediset e ZRRrMTRr Shkoder si dhe te ardhurat e parashikuara nga donacionet dhe sponsorizimet. Keto zera qe ndikohen nga faktore jashte institucionit te Bashkise Shkoder perbejne ndikimin kryesor prej 96% ne mosrealizimin e te ardhurave ne lidhje me planin per vitin 2012 .




Tarife vjetore per pastrimin




Tarife vjetore per ndricimin




Tarife vjetore per gjelberimi




Te ardhura te veta gjithsej




Taksa e ndikimit ne Infrastrukture




Taksa e zenies hapësirave publike




Tarife per leje sherbimi veterinar




Tarifa per Legalizim, Urbanizim (ALIKZNI)




Tarife license transporti




Gjoha per mosshlyerje detyrimi biznesi




Tarifa shërbimi nga Institucione Kulturore dhe Sportive




Gjoha Policia Bashkiake



Gjoha Inspektoriat Ndertimor



Tarife ardhura nga qerate



REALIZIMI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2012

LLOJET E TE ARDHURAVE	Viti 2012			%
	Plan	Realizim 10. Mujorit 2012	I prishmit 2012	
TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ	419.305	256.424	294.670	70%
TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE	197.535	131.740	151.596	77%
Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel	52.278	38.653	46.653	88%
Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertesa)	33.488	28.154	30.044	90%
nga biznesi	20.600	19.624	19.714	96%
nga familje	12.888	8.530	10.330	80%
Taksa gjetjes ne hotel	1.250	728	1.251	100%
Taksa ndikimit ne infrastrukture	60.000	6.843	11.643	18%
Taksa kalimit drejtes pmeretise	6.832	7.907	8.907	134%
Taksa e regjistrimit per vlerat e mjeteve transp	35.381	37.576	40.576	115%
Takse zenie hapësirë publike	653	4.030	4.070	625%
Taksa tabele	375	352	355	95%
Taksa reklame	7.500	7.698	8.098	108%
TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	178.457	91.558	103.438	58%
Tarife e regjistrimit biznesit	0	0	0	-
Tarife vjetore per pashimin, heqje mbeturina	60.623	48.227	51.817	82%
nga biznesi	31.010	27.395	27.485	88%
nga familje	29.613	20.833	24.333	82%
Tarife ndricimi	15.543	11.864	13.644	90%
nga biznesi	3.698	3.630	3.610	98%
nga familje	11.845	8.333	10.333	87%
Tarife gjetbarimi	10.351	8.311	9.391	91%
nga biznesi	4.428	4.145	4.225	92%
nga familje	5.923	4.167	5.167	87%
Tarife per leje sherbimi veterinar	1.500	1.163	1.463	98%
Tarife sherbimi gjueti-peshkim	0	0	0	-
Tarife sherbimi parkim automjete	18.300	5.899	6.489	35%
nga mjeteve per biznes	1.600	789	859	54%
nga mjeteve personele	15.200	3.960	4.110	27%
parking i rezervuar	1.500	1.149	1.519	101%
Tarife licensa transporti	2.300	1.629	1.779	77%
Tarife sherbimi per certifikate transporti	0	2	2	-
Tarife per license karburanti	1.000	150	200	20%
Tarife sherbimi per Urbanizim	300	1.044	1.074	358%
Tarife per Legalizim, Urbanizim (ALUZNII)	65.000	11.142	15.142	23%
Tarife sherbimi per rajonet	0	75	75	-
Tarife sherbimi dublikate arkivi	140	75	85	61%
Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	3.400	1.977	1.977	58%
Libroteka	300	0	0	0%
Muzeu Historik	1.500	1.020	1.220	81%
Taqori Migjeni	1.400	957	1.157	83%
Qendra Kulture Femijore	100	0	0	0%
Stadiumi	0	0	0	-
Parku Sportit	100	0	0	0%
Tarife te tjera	0	1	1	-
TE ARDHURA JOTATIMORE	21.974	17.889	24.399	111%
Te ardhura nga privatizimi	0	32	32	-
Te ardhura nga qera	800	415	715	89%
qera lokale	650	415	715	110%
qera truall	150	0	0	0%
qera gjore	0	0	0	-
Te ardhura nga shiteje truall (mjete)	0	0	0	-
Te ardhura nga tendera	0	2	2	-
Te ardhura nga gjendja civile	200	150	150	75%
Te ardhura nga shiteje pula (pjesmarja %)	150	0	0	0%
Te ardhura nga bursa (shkollet)	888	232	0	0%
Te ardhura nga bursat me jashte	110	32	32	29%
Te ardhura nga kopshet	7.066	4.419	6.419	91%
Te ardhura nga cerdhet	3.900	2.726	3.526	93%
Te ardhura nga kundrvajtje administrative	8.960	9.862	13.262	148%
globe per mosshlyrje detyrimi ne afate ligjore	3.500	2.934	3.634	104%
globe nga kontrole dhe inspektime	300	60	60	20%
globe te vendosura nga org te tjera (role agent)	160	0	0	0%
globe Policia bashkiske	3.600	1.378	1.678	47%
globe nga inspektorat Nderbrend Vendor	1.400	5.480	7.890	564%
Te ardhura nga rrejet (kopshite + cerdhe)	0	2	2	-
Dokumenta strehimi	0	16	26	-
Te ardhura ngab Institucionet (Komunalja)	0	0	0	-
TE ARDHURA NGA KONTRIBUTE	21.339	15.237	15.237	71%
Donacione	21.339	15.237	15.237	71%
projekte	21.339	15.237	15.237	71%
te tjera	0	0	0	-
Sponsorizime	0	0	0	-



SHERBIMET PUBLIKE

Ne mbështetje të buxhetit të vitit 2012 dhe ndryshimeve të bera gjatë këtij viti sipas vendimeve të Keshillit të Bashkisë Shkoder, shërbimet janë kryer si vijon:

1. Shërbimi i Pastrimit të Qytetit

Pasqyra e shpenzimeve për Shërbimin e Pastrimit të Qytetit në mijë lekë

Nr.	Emertimi i Shërbimit	Plani 2012	Realizimi i Pritshëm 2012
1	Paga	1158	1158
2	Sigurime shoqërore	185	185
3	Shpenzime operative	106139	96558
	Totali	107482	97901

- Grumbullimi e transporti i mbeturinave urbane është kryer në mënyrë të vazhdueshme si në Zonën A (pjesën jugore) dhe në atë B (pjesën veriore). Çdo ditë nga Ndermarrja e Pastrimit tërhiqen mesatarisht 550 cope kazane duke i dërguar në vend-depozitim sipas planit të kontratës.
- Fshirja e rrugëve në mënyrë manuale si dhe fshirja mekanike është kryer rregullisht në rrugë, sipas grafikut të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike çdo ditë në rrugët kryesore dhe 3 herë në javë për rrugët dytesore.
Jane zbritur në proces-verbale volumet e punës që nuk janë kryer në rrugët që janë në rikonstrukcion e sipër.
- Gjatë vitit 2012 me gjithë përpjekjet e Bashkisë dhe të njesive Administrative (Rajoneve) për të eliminuar hedhjet e mbeturinave inerte pranë kazaneve, perseri kemi hequr me mjetet e operatorëve sipërmarrës sasine prej 2000 m³ inerte, duke mos lënë që pikat e kazaneve të krijojnë lloje të ndryshme mbetjesh.
- Depozitimi i mbetjeve është kryer në piken e depozitimit ekzistues.

2. Shërbimi i Mirembajtjes së Siperfaqeve të Gjëlberta

Pasqyra e shpenzimeve për Mirembajtjen e siperfaqeve të gjëlberta në mijë lekë

Nr	Emertimi i Shërbimit	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshëm 2012
1	Paga	601	601
2	Sigurime shoqërore	96	96
3	Shpenzime operative	22596	18912
	Totali	23293	19609

Sherbimi i mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta per vitin 2012 eshte kryer sipas zerave te parashikuara ne kontratat e hartuara gjate ketij viti.

Gjate vitit 2012 eshte kryer sherbimi i mirembajtjes te lulishteve sipas preventivave ne te gjithë elementet e saj si: mirembajtje bari, lule, shkurre, drure dekorativ, siperfaqe ujore, stola, etj.

Megjithe veren e nxehte dhe te tejzgjatur nuk kemi patur demtime ne tharjen e drureve dekorativ, shkurreve dhe barit te kultivuar.

- Eshte bere ujitja ne kohe te duhur, mbasi edhe nga Bashkia gjate ketij viti jane ndertuar sisteme ujtese ne lulishtet kryesore te qytetit.
- Eshte bere zevendesimi i plote i drureve dekorativ ne bulevardin "Zogu i Pare" dhe ne qender duke mbjellur drure te rinj dekorativ me rreth 140 cope.
- Gjate ketij viti me ndertimin e rrethrotullimit tek Hotel "Argenti" menjchere eshte plotesuar me bimesine e nevojshme.
- Tek shatervani paralel sistemit qarkullimit eshte harmonizuar me breza te gjelber.

3. Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike dhe Deshmoreve

Pasqyra e shpenzimeve te varrezave ne mije leke

Nr	Emertim	Plani i vitit 2012	Realizimi i Pritshem 2012
1	Paga	130	130
2	Sigurime shoqerore	21	21
3	Shpenzime operative	4400	4400
	Totali	4551	4551

Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave publike dhe te Deshmoreve qe nga viti 2008 kryhet me supermarrje me kontrate 5-vjecare me te drejte rinovimi cdo vit.

Edhe gjate vitit 2012 jane kryer sherbimet e mirembajtjes se varrezave publike e te Deshmoreve ne nje siperfaqe prej rreth 12 ha dhe sipas kontratave te hartuara gjate vitit. Fondi i planifikuar eshte 4400 mije lke.

Ky fond eshte planifikuar ne baze te preventivave te hartuara per cdo ze pune.

Gjate viti 2012 jane kryer te gjitha sherbimet e planifikuara ne siperfaqen e Varrezave: si pastrimin e parcelave nga barerat e keqija, pastrimin nga mbeturinat qe mbeten pas cdo ceremonie, eshte bere dhenia e formave te bordurave te gjelberta (rozmarine dhe levantine). Mbjellje te reja (pisha) ne parcelat e reja si dhe lyerja me gelqere e gjitha bordurave 2 here ne vit per te krijuar nje ambjent sa me te pastër.

Krahas mirembajtjes se varrezave publike nga Bashkia Shkoder eshte akorduar edhe fondi per ndertim parcelash te reja dhe asfaltim rrugor ne mes parcelave. Kjo nderhyrje eshte ne vazhdim.

4. Mirembajtje rruge e trotuare ne qytet*Pasqyra e shpenzimeve ne mirembajtje rruge e trotuare ne mije leke*

Nr.	Emertimi i sherbimeve	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshem 2012
1	Shpenzime operative	8380	8380

Sherbimi i mirembajtjes rruge e trotuare ne qytet kryhet me sipermarrje me kontrate 3 vjecare dhe me rinovim te saj cdo vit.

Fondi I preventivuar dhe I miratuar nga keshilli I bashkise prej 8380 mije leke perfshin gjithë mirembajtjen e rrugëve dhe trotuareve ne qytet.

Nga firma sipermarrëse sipas planit te percaktuar me pare ka nderhyre ne riparimin e disa rrugëve te qytetit per mbyllje gropa si dhe riveshje me asfaltobeton, konkretisht ne rrugen e Tepes, Ludovik Saraci, asfaltimin e rruges pas pallatit Rinia si dhe trotuarin perbri rruges. Po ashtu jane kryer punime asfaltimi edhe ne rrugen Danjel Matlia, dhe ne rrugen Bujar Bishanaku. Gjithashtu eshte kryer riparimi i trotuareve ku kryesisht eshte nderhyre ne trotualet e rruges Zogu I-re deri te rreth rrotullimi i Rusit, duke krijuar dhe partere te gjelberta me bordure.

Ne fund te vitit 2012 mbaron edhe kontrata themelore 3 vjecare per kete sherhim.

Me VKB eshte miratuar fillimi i procedurave per tenderin e ri, pasi eshte domosdoshmeri sherbimi i mirembajtjes se rrugëve nga amortizimi i tyre e duhet te pregatiten dokumentacionet per tenderimin e ketij objekti ne mbeshtetje te sipërfaqeve ekzistuese te rrugëve te asfaltuara dhe trotuareve te reja duke llogaritur me perqindjen e amortizimit.

5. Mirembajtje KUB*Pasqyra e shpenzimeve ne mirembajtje KUB ne mije leke*

Nr	Emertimi i sherbimit	Plan 2012	Realizimi i pritshem 2012
1	Paga	7608	7154
2	Sigurime Shoqerore	1210	1142
3	Mallra e Sherbime te tjera	6362	6362
4	Trans. Buxh. Familjare & Individ	120	33
5	SHUMA	15300	14691

Realizimi i sherbimit te mirembajtjes KUB per vitin 2012

Sic shihet nga tabela e mesiperme fonde te paperdorura mbetet vlere prej 609.783 lek nga te cilat 454.301 lek nga londi I pagave te planifikuara per oret jashte orari dhe 68.482 lek sigurime shoqerore te llogaritura mbi kete fond si dhe 87.000 lek transferte buxhetet familjare e individuale per arsye te ndryshimit faktik te kerkeses nga k/familjalet.

Zeri mallra e sherbime te tjera eshte realizuar pjeserisht ne fund te muajit tetor por qe faturat do te paguhen nga Dega e Thesarit ne muajin Nentor dhe pjesa tjeter do te realizohet ne Nentor-Dhjetor.

Per vitin 2012 eshte zbatuar struktura e miratuar per 25 punonjesit dhe 1 personel administrative inxhinier.

Me fondin e planifikuar jane kryer punimet per pastrimin e pusetave dhe kapseve prej gize si dhe zevendesimi i atyre te demtuara.

Eshte kryer pastrimi, mirembajtja dhe zevendesimi i pusetave dhe kapakeve prej betoni si dhe tubacione te dimensioneve te ndyshme. Eshte kryer pastrimi i grykederdhjeve te kolektoreve kryesore si dhe transporti i materialeve te dala nga to.

6. Ndricimi rrugor

Pasqyra e shpenzimeve per ndricimin rrugor ne mije leke

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshem 2012
600	Paga	1886	1886
601	Sigurime shoqerore	300	300
602	Shpenzime operative	37200	37200
606	Kompens.punonjesish		
	Totali	39386	39386

1. Zërat Paga dhe Sigurime Shoqërore kanë qënë planifikuar **1 886 mijë** dhe **300 mijë** lek. Realizimi i këtyre dy zërave per periudhen 01.01.2012 – 30.10.2012 ka qënë 1572 mijë dhe 250 mijë lekë.

2.Zëri Shpenzime Operative përbëhej nga dy pjesë:

a.Materiale e shërbime speciale, kanë qënë planifikuar për t'u shpenzuar 2 200 000 lekë.

Ky shpenzim ishte parashikuar për blerjen e materialeve elektrike për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ndricimit ekzistues të qytetit që kishte një gjatësi prej 487 017 meter linje ndricimi dhe një sipërfaqe prej 464 943 m² rrugë e 22 074 m² lulishte.

Gjithsejt për zerin materiale e shërbime speciale realizimi i pritshem per vitin 2012 eshte 2200 mije leke. Jane kryer procedurat e prokurimit dhe me keto tani sigurohet baza materiale e nevojshme per mirembajtjen e rrjetit elektrik.

b.Shërbime, në të cilat ishin parashikuar shpenzimet për energjinë elektrike **35 000 mije** lekë mund të themi se:

Për periudhen 1 Janar- 30 Shtator kemi paguar **22 429 852** lekë Energji Elektrike.

Gjate kesaj peruidhe ka dhe mos pagesa qe kane ardhur si rezultat i laturimit joligjor dhe pa matje por me një numër të madh gjobash të pajustificueshme ne masen 8 008 530 lekësh të quajtura Energji e Pamatur si dhe me faturime të tjera të papranueshme. Për keto jemi ankuar zyrtarisht fature per faturë, por asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nga ana e C.F.Z.- Shpërndarjes. Jemi detyruar të përgatisim dokumentacionin për zgjidhjen e këtij problemi nëpërmjet gjyqit, per te cilat vijojne seancat.

Një situatë të tillë e ilustronë tabela dhe grafiku i mëposhtëm:

Viti 2012	Fature	Likuidim	Mbetje
10-mujori	33092410	22429852	8008530

Pasqyra e borxheve per energjine elektrike

Nr	Emertimi	Vlera ne leke
1	Fatura energjie te papagura 2012	12 570 148
2	Fatura energji elektrike te papaguara ne proces gjyqesor 2010-2011	18 483 588
	Shuma borxhe	31 053 736

7. Sinjalistike – Dekor

Pasqyra e shpenzimeve per sinjalistike - dekor ne mije leke

Nr.	Emertimi i shpenzimit	Plani i vitit 2012	Realizimi i Pritshem 2012
600	Paga	750	750
601	Sigurime Shoqërore	120	120
602	Shpenzime operative	2934	2934
	Shuma	3804	3804

1. Për vitin 2012, zërat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore** kanë qënë planifikuar respektivisht **750 mijë** dhe **120 mijë lekë**. Realizimi i këtyre dy zërave per periudhen 01.01.2012-30.10.2012 ka qënë 625 mijë dhe 100 mijë lekë.

2. Zëri Shpenzime Operative, jane parashikuar **2934 mijë lekë** e ndare ne :

- Sinjalistike horizontale 1920 mije leke
- Sinjalistike vertikale 360 mije leke
- Blerje vegla punc 84 mije leke
- Dekorim qyteti 570 mije leke

8. Mobiliteti (levizshmeria urbane)

Bashkia Shkoder ka vazhduar perpjekjet e saj mbi sensibilizimin dhe mbeshtetjen e politikave per nje levizje te paster dhe te shendetshme te levizshmerise dhe transportit ne qytet, ku Shkodra ka qene nje iniciatore jo vetem ne rrang kombetar por edhe rajonal.

Ngjarja me e rendesishme per kete vit mbi Levizshmerine Urbane eshte Konferenca e pare Kombetare e organizuar me 5 Tetor 2012, mbi kete teme.

Organizimi ne Shkoder i kesaj Konference ka qene si rezultat i perpjekjeve te vazhdueshme te Bashkise Shkoder ne ruajtjen e traditave te shendetshme te levizjes, si pedalimi, si dhe permbyllja e projektit 2-vjecar "Mobalb".

Me 5 Tetor, gjithashtu u hap edhe Ekspozita me titullin "Levizshmeri Shkodrane" ku foto te vjetra (Marubi, Jakova, Pici, Nenshati) mbi menytrat shkodrane te transportit u integruan me ato te viteve ne vazhdim, gjer ne ditet e sotme.

Dy broshura u konceptuan dhe u botuan; njera me profil teknik e cila sensibilizonte bashkite e tjera shqiptare dhe fqinje mbi rendesine e levizshmerise, kurse tjetra me profil artistik promovues "Pedalimi Shkodran: Tradite e madhe, e ardhme e ndritshme".

Gjate kesaj Konference Shkodra mori Certifikaten BYPAD, i pari qytet ne Ballkan, si dhe u prezantua pjesmarria ne "Champ" (qytetet europiane kampione ne pedalim).

Java Europiane e Mobilitetit Urbane u organizua nga shoqatat pjesemarrese por pati mbeshtetjen e Bashkise Shkoder.

Nderkohe Bashkia Shkoder bashke me qytetin e Tivarit, ka aplikuar kete vit ne nje projekt europian nderkufitar IPA. Projekti synon:

Organizimin e nje zyre mbi levizshmerine e qendrueshme urbane, trajnimin e eksperteve te rinj, plan te pergjithshem levizshmerie dhe transporti per qytetin, modernizimin e infrastrukturave te pedalimit, studime mbi parkimin e makinave, organizimin e fushatave sensibilizuese, krijimin e nje rrjeti pedalimi, si dhe organizimi i dy atelieve me studenta te Universiteteve Europiane mbi dizenjimin dhe konceptimin e dy shesheve dhe bulevardeve ne Shkoder.

Nderkohe GO2, nje shoqate qe merret me ceshtjet e levizshmerise se qendrueshme urbane, po ofron nje sherbim 3-mujor ne kuadrin e studimit te nje rrjeti paraprak te pedalimit ne Shkoder.

9. Transporti urban

Subvencioni i planifikuar per 6 mujorin e vitit 2012 nga Bashkia Shkoder eshte realizuar plotesisht per Parkun e Udhetareve sipas relacioneve dhe situacioneve te rregullta te barabarta me shumen e planifikuar 7 719 mije leke mbeshtetur ne VKM nr.14 date 12.03.2012, ku ishte parashikuar qe ne se nuk realizohej procesi i privatizimi i ketij sherbimi brenda ketij afati te behej shtyrja e subvencionit i cili u be me VKM nr. 57 date 29.06.2012 per shumen 2.572 mije leke, me shumen e pergjithshme per 8-mujorin te barabarte me 10 292 mije leke.

Me kalimin e ketij sherbimi me operator privat pas konkurimit, Firma "ERGYS MS 2010" operon ne kete lloj sherbimi duke marre persiper sherbimin ne linjat tradicionale tashme si

:Bahçallek-Fermentim-Bahçallek, Qender-Zogaj-Qender por edhe te linjes Kiras-Stacioni i Trenit-Kiras e te Unazes ne dy sense nje sherbim i ri.

Mbeshtetur ne Akt- marreveshjen e nenshkruar nga Bashkia dhe firma fituese eshte ngritur grupi i kontrollit dhe monitorimit te punes dhe zbatimin e kesaj Akt-marreveshje verehet se ka nje ndryshim rrenjesor ne kete sherbim si ne zbatimin e orareve e frekuencave te levizjes,permiresimin e kushteve ne nivele bashkekohore te udhtimit,zgjatjen e orarit te sherbimit deri ne oren 22.00,gje qe me pare nuk realizohej per linjen Bahçallek-Fermentim.

Po ashtu deri tani eshte eksperimentuar linja e Unazes dhe po shikohet mundesia e venies ne eficence te plote te kesaj linje megjithese ka probleme pasi nuk garantohet numri i mjaftueshem i udhetareve gje qe nuk do te siguroje te ardhura per te mbuluar shpenzimet.

Sipas vezhgimeve te kryera vihet re se ka nje numer te konsiderueshem udhetaresh qe frekuentojne udhetimin me kete lloj transporti nga kategori qe perfitojne udhetim falas te cilet jane parashikuar per tu subvencionuar nga Bashkia sipas kontrates se nenshkruar per nje subvencion social qe duhet te behet per keto shtresa sociale.

Parku i udhetareve Shkoder SH.A (ne likuidim)

Me VKB nr 58, date 29.06.2012 "Per ngritjen e strukture qe do te merret me administrimin e shoqerise Parku i Udhetaresve Shkoder SH.A" i ndryshuar me VKB nr. 93 date 30.10.2012 ka kryer funksionet kjo strukture. Afati i kryerjes se veprimtarise se saj eshte data 31.12.2012.

Shpenzimet per kete periudhe jane detajuar:

- Fondi i pagave mujore	800 mije leke
- Fondi i sigurimeve shoqerore	135 mije leke
- Shpenzime operative mujore (telefon+energji)	10 mije leke
Karburant	5 mije leke
- Shpenzime operative 4-mujore	60 mije leke

TOTAL (Paga, sig. Shoqerore, shpenzime operative) 995 mije leke

B. INVESTIME PUBLIKE**INFRASTRUKTURE RRUGORE****Rikonstruksion rruga "30 Korriku"(Vazhdim) me vlere 1 000 mije leke.**

Ky objekt nuk eshte realizuar. Do planifikohet ne vleren e nevojshme per vitin 2012.

Rikonstruksion rruga "At Shtjefen Gjeçovi" me vlere 1 858 mije leke

Punimet ne kete objekt kane perfunduar dhe me fondin e programuar u realizua mbulimi i shpenzimeve te sipermarrjes se zbatimit ku perfshihen kryesisht sistemimi i ujrave te bardha,ndertimi i pusetave,shtrimi i rruges me asfalt,etj. dhe shpenzimet e mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve .Ne kete objekt jane kryer punimet ne KUZ dhe ujesjelles nga KFW

Rikonstruksion rruga pas Stacionit te trenit me vlere 1 998 mije leke

Punimet ne kete objekt kane perfunduar dhe me fondin e programuar u realizua mbulimi i shpenzimeve te sipermarrjes se zbatimit ku perfshihen kryesisht sistemimi i ujrave te bardha,ndertimi i pusetave,shtrimi i rruges me asfalt,etj. dhe shpenzimet e mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve .Ne kete objekt jane kryer punimet ne KUZ dhe ujesjelles nga KFW

Rikonstruksion rruga Musa Luli me vlere 19 728 mije leke

Ky objekt ka qene ne planin e investimeve te vitit 2011 dhe punimet kane perfunduar ne vitin 2012 per shkak te koordinimit ne kohe me investimet ne infrastrukturen nentokesore nga KFW.Financimi per kete objekt ne vitin 2011 eshte 11 000 mije leke diferenca prej 9 109 mije leke mbetet per tu perballuar nga buxheti i vitit 2013,ku jane perfshire diferenca e punimeve te zbatimit,mbikqyrja dhe kolaudimi.

Rikonstruksion rruga "At Donat Kurti" 1 554 mije leke

Me fondin e programuar do te mbulohen shpenzimet e zbatimit,mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve.Fshte parashikuar te behet sistemimi i ujrave te bardha,ndertimi i pusetave,shtrimi i rruges me asfalt,etj.Punimet nuk kane filluar pasi pritet te perfundojne punimet ne ujesjelles kanalizime te planifikuara nga KFW.

Rikonstruksion rruga "Beslidhja" me vlere 1 170 mije leke

Per kete objekt ne vitin 2011 u programua dhe u realizua vlere prej 11 676 mije leke,Por me VKV nr.67 date 05.12.2011 eshte miratuar ne parim fondi prej 1 170 mije leke me burim financimi Buxheti i Bashkise viti 2012.Ky fond mbulon shpenzimet e zbatimit,mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve dhe eshte realizuar.

Rikonstruksion rruge dytesore me vlere 4 362 mije leke

Ky objekt nuk eshte realizuar pasi ne rruget e parashikuara per nderhyrje pasi do te kryhen me pare punimet ne infrastrukturen nentokesore Ujesjelles – Kanalizime nga KFW.Pas perfundimit te punimeve keto rruge do te jene ne prioritetet tona per vitin 2013 per rikonstruksionin e tyre.

RIKONSTRUKSION TROTUARE**Sistemim i trotuare rruga "Fahri Ramadani" me vlere 1 700 mije leke**

Ne kete rruge ne vitin 2011 jane kryer punime ne sistemimin e ujesjellesit,kanalizimit te ujrave te bardha , kanalizimin e ujrave te zeza nga sh.a Ujesjelles Kanalizime,ndertimin e pusetave,shtresat asfaltike.Me fondin e programuar per kete vit u be sistemim i tratuareve dhe shtrimi i tyre me beton.Per vitin 2012 eshte financuar 1 689 mije leke dhe mbetet per tu financuar vlere 41 200 leke ne vitin 2013.

Rikonstruksion trotuare rruga "Sheshi Demokracia" me vlere 3 884 mije leke.

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit,te mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve per sistemimin e plote te trotuareve per rreth sheshit dhe sistemimin e nyjeve te qarkullimit ku jane realizuar edhe punime per shtimin e siperfaqeve te gjelberta.

NDRICIMI RRUGOR**Ndricim rruge dytesore me vlere 1 160 mije leke.**

Eshte ne procedure prokurimi.Me kete fond do te realizohet ndricimi i 8 rrugeve dytesore.

Rikonstruksion linja Zogu i I-re , M.Camaj, Q.Draçini, Europa me vlere 5 137 mije leke.

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit,te mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve per rikonstruksionin e plote te linjes elektrike ,ku jane zevendesuar kabllot e vjetra, lysterja me boje e shtyllave ekzistuese ,ndertimi i pusetave te reja ne rrugen Zogu i I-re,rrugen Martin Camaj,rrugen Qemal Draçini dhe rrugen Europa.

Ndricim blloku Perash (Qendra Shendetesore)me vlere 335 mije leke.

Eshte hartuar projekti dhe objekti do te realizohet brenda ketij viti.

GJELBERIMI**Rikonstruksion sheshi e lulishte qender Shiroke me vlere 10 000 mije leke.**

Ky objekt nuk eshte realizuar pasi me fondet e FSHZH -se do te realizohen punimet per rikonstruksionin dhe zgjerimin e rruges se Shirokes ku eshte perfshire dhe Rikonstruksioni i sheshit e lulishtes qender Shiroke.

Gjelberimi i rruges Zogu i I-re me vlere 1 205 mije leke

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e siper marrjes se zbatimit,te mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve per mbjelljen me drure te rinj dekorativ ne te dy kraheve te kesaj rruge.

TE NDRYSHME**Blerje kazane metalik 1100 lit(100 cope) me vlere 2 996 mije leke.**

Me kete fond jane blere 100 cope kazana me kapacitet 1 100 litra te cilat jane perdorur per zevendesimin e kazanava te demtuar dhe per plotesimin me kazana te pikave te reja te grumbullimit te mbetjeve.

Ndertim Varreza Publike me vlere 3 940 mije leke.

Me fondin e programuar jane realizuar shpenzimet e sipermarrrjes se zbatimit, te mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve per ndertimin e parcelave te reja per varreza publike ne siperfaqen e shpronesuar ne vitet e mepareshme. Jane kryhen punime per vendosje bordurash, shtrim te rrugeve ndermjetese me asfalt, gjeberime, etj. Punimet ne kete objekt jane ne vazhdim dhe deri ne fund te vitit do te perfundojne.

Ndertim bazamente per vendosje skulpturash me vlere 480 mije leke

Ky objekt nuk eshte realizuar.

Blerje kende informacioni me vlere 98 mije leke.

Me kete fond eshte realizuar blerja disa kendeve te informacionit ne varesi te nevojave te Bashkise.

Ndertim tavani i varur shkolla "28 Nentori" me vlere 473 mije leke.

Me kete fond u realizua ndretimi i tavanit te varur ne ambientin e Muzeut te ketij gjimnazi, ne kuader te 100 vjetorit te Pavaresise.

Furnizim e vendosje stenda e aksesore per muzeun. me vlere 474 mije leke

Me kete fond u realizuan shpenzimet per blerjen dhe vendosjen e stendave dhe aksesoreve per muzeun ne kuader te 100 vjetorit te Pavaresise.

Ndertim banjo Drejtoria e te Ardhurave me vlere 480 mije leke.

Jane realizuar punimet per ndertimin e banjove ne ambientet e punes ne Drejtorine e te Ardhurave.

Rik. & Lyerje Thertore me vlere 290 mije leke.

Me kete fond u realizua lyerja, mirembajtja e ambienteve dhe frigoriferit te Thertores.

Projekti "Aplikim punime silvikulture ne pyje artificiale" me vlere 7 108 mije leke

Qellimi ketij projekti eshte rrallimi, krasitja dhe pastrimi i ngastrave ne ekonomine pyjore Tarabosh, sensibilizimi i banoreve te zones per rendesine e ruajtjes dhe mirembajtjes se pyjeve. Punimet ne kete objekt jane ne vazhdim. Te planifikuara per financim per vitin 2012 jane 3 608 mije leke dhe per vitin 2013 mbetet per financim vlere 3 483 mije leke

Ripyllezimi i ngastrave te demtuara nga zjarri me vlere 3 144 mije leke

Ky objekt nuk eshte realizuar.

Rikonstrukcion rrjeti elektrik godina e Bashkise me vlere 2 000 mije leke.

Ky objekt nuk eshte realizuar.

Lyerje fasada godina e Bashkise me vlere te plote 1 000 mije leke.

Me kete fond jane realizuar punimet per riparimin e lyerjen e fasadave te godines se Bashkise Shkoder ne perputhje me arkitekturen e saj. Ketu jane perfshire punimet e zbatimit, mbikqyrja dhe kolaudimi.

Rikonstrukcion çatija e Bashkise me vlere 480 mije leke.

Me kete fond eshte realizuar rikonstrukcion i pjesshem çatise se godines se Bashkise, ne siperfaqet me te demtuara.

Gjate vitit 2012, me fonde te te ardhura nga rialokimet jane realizuar objektet e meposhtme:

Shpenzime ne realizimin e punimeve per sistemimin e vend depoziteve te mbetjeve urbane me vlere 287 mije leke.

Ne bashkepunim me Ministrine e Mbrojtjes eshte sitemuar venddepozitimi i mbetjeve urbane dhe mbullimi i tyre me dhe. Sipas akt marrveshjes me keto fonde jane mbuluar shpenzimet per furnizimin e karburant e lubrifikant si dhe akomodimi i punonjesve te Ministrise se Mrojtjes

Furnizim vendosje shtylla metalike per flamuj me vlere 213 mije leke.

Eshte kryer furnizimi dhe vendosja e shtyllave ne sheshet kryesore te qytetit per vendosjen e flamujve.

INVESTIME NGA BUXHETI I SHTETIT DHE DONATORE PER VITIN 2012

Rikonstruksion rruga "13 Dhjetori" me vlere 70 000 mije leke.

Ne vazhdimesi te nismes tone per kthim ne identitet te rrugeve me vlere arkitektonike, na eshte afruar bashkefinancimi nga Fondacioni Shqiptaro – Amerikan. Me fondin kete fonde jane kryher punime per shtrimin e rruges me pllaka guri, ne vazhdimesi te pedonale qender. Bashkefinacimi eshte ne vleren 42 000 mije leke nga Fondacioni Shqiptaro – Amerikan dhe 28 000 mije leke nga Bashkia Shkoder, kjo e fundit eshte prokuruar nga ana jone per blerjen e pllakave te gurit dhe eshte realizuar.

Rikonstruksion rruga Zooteknike – Shtepia e Bujqeve me vlere 988 mije leke.

Me kete fond u mbulua detyrimi i Bashkise per kontribut si bashkefinancim per kestin e trete per perfundimin e likuidimit te objektit.

Ndricimi fasada godina Bashkise me vlere 6 490 mije leke.

Me financim te PNUD –it eshte realizur ndricimi i fasades se godines se Bashkise Shkoder

Ndertim rruga Gjuhadol me vlere 800 mije Euro.

Me financim te K.Europjan jane realizuar punimet ne infrastrukturen nentokesore ,shtrimin e rruges e trotuareve me pllaka guri, ndricimi dekorativ i rruges si dhe plotesimi me sinjalistike vertikale.

Rikonstruksion fasada rruga Gjuhadol me vlere 300 mije Euro .

Me financim te Bankes Boterore dhe Bashkise Shkoder ka perfundur rikonstruksioni dhe lysterja e fasadave ne kete rruge.

Ndertim kolektori Teatri Migjeni – Sheshi Rus me vlere 99 200 mije leke.

Me financim te Bankes Boterore ka perfundur ndertimi i kolektorit dhe rikonstruksioni i rruges.

Ndertim kolektori Sheshi Rus – Agjencia Koplik me vlere 43 300 mije leke.

Me financim te Bankes Boterore ka perfundur ndertimi i kolektorit dhe rikonstruksioni i rruges.

Ndertim kolektori Pallati me Ure – Parruce me vlere 107 100 mije leke.

Me financim te Bankes Boterore ka perfundur ndertimi i kolektorit dhe rikonstruksioni i rruges.

FURNIZIMI ME UJE dhe SISTEMI I KANALIZIMEVE te KUZ .

Projekti "Furnizimi me uje dhe mbrojtja ambientale e Ligenit te Shkodres"

Sigurimi i furnizimit me uje te pjshem ne sasi dhe cilesine e kerkuar si dhe permiresimet e ndjeshme ne sistemin e kanalizimeve per ujerat e zeza dhe ujerat e bardha vjen si rezultat i kujdesit te Qeverise Qendrore e Lokale per orientimin e investimeve ne kete sektor te rendesishem jetik si me fondet e Qeverise Shqiptare ashtu dhe me financim nga projekte te huaja .

Me perfundimin me sukses te Projektit Austriak i cili konsiderohet si modeli me i mire ,ne Mars te vitit 2009 ne Ujesjellesin e Shkodres ka filluar zbatimi i Projektit “ Furnizimi me uje dhe mbrojtja ambientale e Liqenit te Shkodres “ bashkefinansim i tre donatoreve dhe me pjesmarjen e Qeverise Shqiptare.

- Qeveria Gjermane nepermjet KFW	7.5 milion Euro
- Qeveria Zvicerane nepermjet SECO	7.5 milion Euro
- Qeveria Austriake nepermjet ADA	1.9 milion Euro
- Qeveria Shqiptare	0.5 milion Euro

Aktivitetet e Projektit.

1. Komponenti A. (Projektim i detajuar) Realizuar gjate vitit 2010

- Projektimi e detajuar me vleresimin e azhornuar te kostove
- Pregatitja e Dokumentave te tenderit.
- Akordim i dy kontratave per zbatim.

2. Komponenti C. (Zhvillimi institucional) Realizuar gjate vitit 2010-2011

- Realizim i blerjes se paisjeve dhe programeve.
- Realizim i Trajnimeve te stafit te Ndermarjes.

Te gjitha programet jane perftuar dhe zbatohen ne punen e perditeshme nga Stafi i ndermarjes.

3. Komponenti B. (Furnizim dhe ndertim) Per zbatim gjate vitit 2011-2012

Objektet e realizuara deri ne vitin 2012

- *Ne Sektorin e Ujerave te Zeza*

1. Furnizimi me Mjete te specializuara per Pastrimin e Ujrave te perdorura
Realizuar Qershor 2012

2. Ndertimi i kolektorit te ujrave te perdorura ne Shiroke si dhe linja primare e sekondare.
Punimet ne keto objekte vazhdojne.

- *Ne Sektorin e UJESJELLESIT*

1. Rehabilitimi i Linjes Kryesore te Dergimit, punimet ne keto objekte vazhdojne.
Investime te tjera te realizuara ne Sektorin e Ujesjellesit nga te tretet.
Banka Boterore me investitor D.P.U.K. Tirane

1. Nderhyrje per mbrojtjen nga permbytjet ne Stacionin Qendror te Pompimit ne Dobraq me vlere **53,800 mije leke**
2. Nderhyrje per mbrojtjen nga permbytjet ne stacionin e pompimit ne Bahçallek me vlere **19,300 mije leke.**



PLANIFIKIMI URBAN

Realizimi i objektivave te Planifikimit dhe Zhvillimit Urban per vitin 2012.

Ne baze te punes per realizimin e Zhvillimit Urban per vitin 2012 ka qene Plani i Zhvillimit Strategjik te qytetit te Shkodres per periudhen 2005-2015

Vizioni qe ne kemi per zhvillimin e qytetit na ka dhene hapshire te qarte ne veprimtarine e zhvillimit urban te qytetit dhe percaktimin e prioriteteve.

Ne zbatim te detyrave te veta Drejtoria e pergjitheshme e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit ka mbeshtetur punen e saj ne zbatim te Ligjit " Per planifikimin e territorit " nr 10119 date 23.04.2009 si edhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij.

Hyrja ne fuqi e ketij Ligji te ri si ne permbajtje edhe ne koncept ka sjelle disa veshtiresi ne menyren e zhvillimit te territorit dhe dhenien e lejave per kete zhvillim. Kompletimi i Ligjit me aktet e veta nenligjore te cilat mund te fillojne te hapin rrugen per dhenien e lejeve per zhvillim apo ndertim , perfundoi ne muajin korrik 2012. Drejtoria jone menjehere mbas ketij procesi u filloi punen per pergatitjen e materialeve qe do te duhen per te filluar proceduren e Lejeve te zhvillimit apo ndertimit.

Keshtu mbeshtetur ne aktet e mesiperme nenligjore u formuluan Dokumentat te cilat do te duhen per tu pajisur me Leje zhvillimi apo ndertimi per sicilin rast : ndertim i ri, shtese objekti, adoptim objekti, ndertim infrastrukture etj. U pergatit Udhezimi per menyren se si do te shqyrtohet nje kerkese si edhe afatet ligjore te shqyrtimit te saj. Eshte punuar faqja zyrtare e web (internetit) ku do te publikohen te gjitha kerkesat per Leje , te sejciles kerkese qe do te paraqitet. Keshtu drejtoria jone ka bere gati te gjitha infrastrukturen e nevojshme qe me miratimin perfundimtar te Planit Territorial Vendor ne Keshillin Kombetar te Territorit te filloje menjehere punen.

Ky vit qe sapo lame pas pra viti 2012 ishte nje vit relativisht i veshtire sepse nuk jane dhene leje Ndertimi/Zhvillimi dhe kjo situatë reflektohet ne mbledhjen e tarifes vendore per " Ndertime te reja". Aktualisht Drejtoria jone ka mbledhur nje tarife prej 10.960.328 milion leke , (si 11 mujor) kur duhej te kishim realizuar 60 milion leke, pra eshte realizuar ne masen 18 %.

Bejme me dije se kjo e ardhur i eshte rikthyer komunitetit te qytetit te Shkodres ne formen e investimeve publike te cilat jane kryer nga Bashkia Shkoder, sic jane rikonstruksione te trotuareve, rrugeve, lulishteve, ndricimit etj.

Nder projektet – studimet e parashikuara per tu realizuar per vitin 2012 jane realizuar:

- Hartimi i projektit per " Zgjerimin e rruges Shkoder Shiroke" , projekt i cili eshte financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Hartimi i projekt Studimit te Sheshit Luigj Gurakuqi per ndertimin e nenkalimit dhe bashkimit e dy rrugeve te Qendres Historike.
- Hartimi i Studimit per " Kompleksin sportiv " te ish Instituti i Misrit.

Njekohesisht Drejtoria jone ka realizuar te gjitha detyrat e ngarkuara ne lidhje me planifikimin dhe arredimin urban te qytetit.

Situata e veshtire ekonomike pasqyrohet edhe ne kete rast ku nga njera ane jane nuk jane dhene leje zhvillimi/ndertimi dhe nga ana tjeter nuk ka pasur kerkesa per ndertime objektesh shumekateshe.

Megjithate nga ana jone per vitin 2012 jane dhene rreth 32 Leja perdorimi (shfrytezimi) objektesh duke filluar nga adoptimet e banesave dhe deri ne objektet shumekateshe . Nepermjettyre jane futur ne tregun imobiliar rreth 232 njesi / apartamente si edhe rreth 174 njesi tregetare me rreth 40 m2 per seicilen njesi rezulton nje siperfaqe prej 6960 m2 e cila ne qofte se shumezohet me vleren prej 38.400 lek/m2 kosto e shfrytezimit rezulton nje vlere 267.264.000 leke ose rreth 2 milion euro vlere monetare ndertimore e futur ne tregun imobiliar vetem me njesite e sherbimit. Po te arsyetajojme me te njejten menyre edhe per ndertimin e banesave rezulton nje vlere perj 890.880.000 leke ose 6.3 milion euro investim ne tregun imobiliar ose nje total prej 8.3 milion leke .

Detyrimi yne ligjor ne funksion edhe te politikës se Bashkise Shkoder ne fushen e planifikimit te territorit ka rritur pergjegjesine ne menyre qe te administrojme ne menyre korrekte situaten ndertimore ne qytet e cila ka te beje me perdorimin racional te tokes.

Nga analiza e situates rezulton qe kemi komunikuar dhe kryer veprime me rreth 26 Subjekte ndertimore te cilat kryejne aktivitetin ne qytetin e Shkodres. Keta klicnte aktualisht jane qytetaret apo sipermarresit persa i perket sigurimit te sherbimeve dhe faciliteteve dhe perseri jane qytetaret dhe sipermarresit per rolin e tyre proaktiv si promotore dhe investitore direkte dhe indirekte per zhvillimin urban dhe mjedisin urban me gjithe tiparet dhe potencialet e tij .

INSPEKTORIATI NDERTIMOR

Realizimi i objektivave te punes se Inspektoriatit Ndertimor per vitin 2012.

Ne zbatim te ligjit 9780.dt,16.07.2007."Per Inspektimin e Ndertimit" si dhe te Ligjit Nr 8402 dt 10.09.1998, "Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve ne Ndertim" i ndryshuar, bazuar dhe ne ligjin nr 10119 dt,23.04.2012"Per planifikimin e territorit",Inspektoriati ndertimor urbanistik vendor ka organizuar punen e tij gjate vitit 2012. Ky inspektoriat pergjate vitit 2012 ka ndermarre nje sere nderhyrjesh per prishjen e nje numeri te konsiderueshem objektesh te ndryshme,kryesisht per ti hapur rruge investimeve te ndryshme publike te bera nga Bashkia Shkoder. Disa nga treguesit e punes se inspektoriatit paraqiten ne tabelen e meposhtme.

Treguesit dhe statistikat,Vendime te nxjerra dhe te zbatuara

Vendimet e dala	Nr	Zbatuar	Objekte te prishura
Vendime te K.RR.T.	1	1	160
Urdher Egzekutimi te K/insp	13	13	Totali 160
Vendime pezullimi	13	13	
Vendime per dhenie gjobe	28	13	

Ne lidhje me arketimin e masave Administrative(gjobave),nga 1.400.000 lek qe ishte parashikuar per vitin 2012 ka arritur ne Shumen 7.251.527(shtate milion e dyqind e pesedhjet e nje mije e peseqind e njezet e shtate)lek. Persa i perket gjobave ne total,shuma e tyre arrin ne vleren 15.650.531(pesembedhjet milion e gjashteqind e pesedhjet mije e peseqind e tridhjet e nje)lek. Per Shumen 8.399.004 qe nuk jane arketuar akoma, jane derguar nga ana jone per egzekutim prane zyres se Sherbimit Permbarimor Shkoder,pasi urdherat e egzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder jane leshuar per keto Masa Administrative.



DREJTORIA ARSIMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

I. ZYRA E ARSIMIT

Po paraqesim te pritshimin 2012 per kete Zyre si me poshte:

000/ Leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>I pritshmi 2012</i>
Paga	33092	30462.7
Sigurime	5282	4948.7
Madhra e sherbime	27793	29056.1
Transferte korentre e brendeshme	2520	2511.5
Transferte ne buxhtet familjare	142	134.5
Investime	6311	870.2
TOTALI	75140	67983.7

000 / leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>I pritshmi 2012</i>
Materiale e sherb.zyre te pergjith.	30	30
Materiale dhe sherbime speciale	3782	2608.9
Sherbime	17060	20732
Shpenzime transporti	360	228.9
Shpenzime udhetimi		0
Mirmbajtje e zakonshme	2504	2159.5
Qera objekteve		0
Detyrime dhe kompensime legale		0
Shpenzime te tjera operative	4057	3326.8
TOTALI	27793	29086.1

E ndare si me poshte:

Materiale e sherbime zyre te pergjitheshme 30 mije leke e konsumuar per dizinfektimin e kuzhinave te konvikteve.

Materiale dhe sherbime specilae shuma e realizuar 2608.9 leke e realizuar si me poshte:

Uniforma per femijet e Festivalit Mbarkombetare te Kenges 285.6 mije leke, materiale hidraulike 245.0 mije leke, material elektrike 250.0 mije leke, materiale te ndrysheme 105. Mije leke, batanije per kopeshtet me drake 240 mije leke, rimbushje te fikseve te zjarrit 180 mije leke, ene kuzhine per konvikte e kopeshte 130 mije leke, xham 333 mije leke, bojra per lysterje 150 mije leke., punime skene per festivalin 690,280 mije leke

Shpenzime per sherbime : shuma totale 20732.0 mije leke, te kryera si me poshte:

Shpenzime per energji elektrike 8080.5 mije leke , shpenzime per konsum uji 10070.6 mije leke , sherbime telefonie 477.2 mije leke ,blerie lenede djegese dru zjarri 1918.9 mije leke, sherbime printimi 181 mije leke ,sherbime postare 1.3 m mije leke , dhe te tjera 2.5 leke

Shpenzime transporti per dy automejetet (nje per furnizimi ushqimesh dhe nje per transportin e nxenesve te shkolles Speciale) shuma totale 228.9 mije leke e ndare :

Siguracione dhe taksa 110.3 mije leke , pjese kembimi (goma etj) 32 mije leke, shpenzime te tjera mirmbajtjeje 88.6 mije leke.

Duhet te theksojme se automejetet jane te amortizuar, e vcanerisht ai i transportit te ushqime .

Shpenzime per mirmbajtje te zakoneshme ,shuma t totale 2159.5 mije leke, e ndare si me poshte :

*Shpenzime per mirmbajtje ndertese shuma 1878.5 mije leke ku perfshihen : lysterja e shkolles se mesme Industriale 398.5 mije leke, meremetime te vogla kopeshti 16 Shtatori 87 mije leke, riparime te vogla shkolla Azem Hajdari 98.8 mije leke, riparime te vogla dhe lysterje e pjeseshme shkolla Ndre Mjeda 245.8 mije leke , riparime te vogla dhe lysterje te pjeseshme shkolla Artistike 100.7 mije leke , vendosje matesa uji 356.8 mije leke , ndertim muri ndares dhe vendosje dere ne shkollen Bahcallek 80. mije leke ,prishje dhe ndertim muri ne shkollen Speciale 78 mije leke , riparime te vogla dhe lysterje e brendeshme shkolla veterinare 99.4 mije leke, lysterje e kuzhinave te kopeshteve 76 mije leke , lysterje e fasades se konviktit Industriale 78.5 leke, ne dispozicion per problem emergjence deri ne fund te vitit 179 mije leke

*Shpenzime per riparime aparate e paisje teknike 106 mije leke (te kryera per riparime kompjutash, lavatrice dhe shporete gatimi),

* Shpenzime per riparime paisje zyre (tryeza e karrige nxenesish) 175 mije leke,

Shpenzime te tjera operative : shuma totale 3326.8 mije leke , ;

I pritshimi i priudhes nga 01 janari deri me 31 dhjetor 2012, i ndare si me poshte :

* Siguracione ndertesash per kopeshte e shkolla shuma 480 mije leke ,

* Shpenzime per honorare shuma 1455.6 mije leke leke , te ndara : Per aktivitetin " Bilbilat e vegjel kendojne 505 mije leke, aktivitete sportive , artistike dhe shkencore per QKFemijeve 258.6 mije leke , aktiviteti I fundvitit ne shumen prej 692 mije leke.

* Te tjera materiale dhe sherbime operative shuma 1391.2 mije leke ne te cilen perfshihen,:

Akomodim ushqim per femijet pjesmarres ne festivalin e kenges per femije 243 mije leke,shpenzime per fjetje per femijet pjesmarres ne festivalin e kenges per femije 336,7 mije leke , ndricim i skenes se festiavlit 396. Mije leke, fonia per aktivitetin " Bilbilat e vegjel kendojne " 165.5 mije leke , aktiviteti I pervejtorit te Pavarsise tek Gjimnazi 28 Nentori 250 mije leke (ne proces)

TRANSFERTE KORRENTE TE BRENDESHME SHUMA 2511.5 mije Leke

E ndare ne : Krijimtaria e Festivalit te femijeve shuma 2391.5 mije leke , shpenzime per festen tradicionale te shkolles Speciale 120 mije leke,

INVESTIME SHUMA TOTALE 870.2 mije Leke

E ndare :Blerie ndertese e rikonstruksione , (per supervisor dhe kolodator) 258.3 mije leke , blerie paisje operationale (lavatrice , frigorifer, shporete etj) shuma 240.mije leke, blerie paisje zyre (karrige e tryeza per konviktin e industriale) 371.9 mije leke

II. DEGA EKONOMIKE KULTURES

Dega Ekonomike e Kultures trajton te gjitha marredheniet financiare te institucioneve kulturore te varesise qe jane:

Muzeu Historik, Biblioteka Marin Barleti, Galeria e Arteve dhe Qendra Kulturore Pjeter Gaci.

Gjithashtu kjo dege ka trajtuar financiarisht edhe shpenzimet per aktivitete te ndryshme social – kulturore te planifikuara nga Zyra e Kultures si dhe shpenzime te tjera per aktivitete te ndryshme (shtese) te miratuara gjate vitit me VKB-se, te cilat do trajtohen me vechte.

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
Paga	14596	13673
Sigurime shoqerore	2322	2227
Mallra dhe sherbime te tjera	12174	10097
Transf.buxhetet familjare dhe individ	12	12
Investime	2252	2074
TOTALI	31356	28083

Dega Ekonomike Kultures

000/leke

<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>I Pritshmi 2012</i>
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith	220	141
Materiale dhe sherbime speciale	460	20
Sherbime nga te trete	1210	1064
Shpenzime transporti	555	506
Shpenzime udhetimi	50	0
Mirembajtje e zakonshme	608	524
Shpenzime te tjera operative	9071	7842
TOTALI	12174	10097

A- Muzeu Historik

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
<i>Paga</i>	4595	4400
<i>Sigurime shoqerore</i>	724	714
<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	2306	2273
<i>Transf.buxhetet familjare dhe individ</i>	12	12
<i>Investime</i>	1023	1022
TOTALI	8660	8421

Ne Muzeun Historik , shpenzimet per te pritshmin 2012, sipas tabele sa siper ndahen:

1. Zeri shpenzime per paga e sigurime: ne shumen prej 5114 mije leke
- 2.Zeri shpenzime per mallara e sherbime , ne shumen prej 2273 mije leke, sipas pasqyres me poshte:

000/leke

<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
<i>Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith</i>	40	24
<i>Sherbime nga te trete</i>	416	400
<i>Mirembajtje e zakonshme</i>	408	408
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	1442	1441
TOTALI	2306	2273

3. Zeri shpenzime per Investime ne total 1022 mije leke eshte perdorur me objekt „ Ndertimi i pavionit Rilindja Qytetare Shkodrane“

B. BIBLOTEKA

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2012	I Pritshmi 2012
Paga	6355	5843
Sigurime shoqerore	1016	953
Mallra dhe sherbime te tjera	1225	603
Transf.buxhetet familjare dhe individ		
Investime	1077	1052
TOTALI	9673	8451

Në Bibliotekën „Marin Barleti“ shpenzimet për të pritshmin 2012, sipas tabelës së mësipërme ndahen:

1. Shpenzime për paga e sigurime në shumën prej 6796 mijë lekë
2. Shpenzime për Mallra e Sherbime në shumën prej 603 mijë lekë, sipas paqës me poshtë:

000/leke

Mallra dhe sherbime te tjera	Plani 2012	I Pritshmi 2012
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith	80	71
Materiale dhe sherbime speciale	170	
Sherbime nga te trete	416	348
Shpenzime udhetimi	50	
Mirembajtje e zakonshme	200	116
Shpenzime te tjera operative	309	68
TOTALI	1225	603

3. Zeri shpenzime për Investime në shumën prej 1052 mijë lekë është shpenzuar, 1000 mijë lekë blerje libra dhe gazeta dhe 52 mijë lekë, blerje fiksë zjarri.

C. GALERIA ARTEVE

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
<i>Paga</i>	1265	1108
<i>Sigurime shoqerore</i>	194	181
<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	1546	965
TOTALI	3005	2254

Ne Galerine e arteve shpenzimet per te pritshmin 2012, sipas tabelës sa sipër ndahen:

1. **Shpenzimet per paga dhe sigurime** ne shumen prej 1289 mije leke
2. **Shpenzimet per Mallra e Sherbime** ne shumen prej 965 mije leke te trajtuara ne pasqyren me poshte:

000/leke

<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith	50	8
Materiale dhe sherbime speciale	290	20
Sherbime nga te trete	171	160
Shpenzime transporti	55	50
Shpenzime te tjera operative	980	727
TOTALI	1546	965

D- QENDRA KULTURORE " P. GACI "

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>I Pritshmi 2012</i>
<i>Paga</i>	2381	2322
<i>Sigurime shoqerore</i>	388	379
<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	7097	6256
<i>Investime</i>	152	
TOTALI	10018	8957

Aktiviteti vjetor i ketij institucioni eshte mbuluar sipas zerave te shpenzimeve me poshte ku perfshihen

honoraret per aktivitet e ketij institucioni gjate vitit si dhe per honoraret per Orkestres Frymore te Qytetit dhe Orkerstren e Harqevc

1.Shpenzimet per paga e sigurime ne shumen prej 2701 mije leke

2. Shpenzime per Mallra e Sherbime ne shumen prej 6256 mije leke, te trajtuara me poshte:

000/leke

	Plani	I Pritshmi
Mallra dhe sherbime te tjera	2012	2012
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjithmi	50	38
Sherbime nga te trete	207	156
Shpenzime transporti	500	456
Shpenzime te tjera operative	6340	5606
TOTALI	7097	6256

AKTIVITETE TE ZYRES KULTURES

Ne total per realizimin e aktiviteteve jane shpenzuar 5450 mije leke te trajtuara sipas zerave te shpenzimeve ne pasyren me poshte:

	Plani	I Pritshmi
Emertimi i shpenzimeve	2012	2012
Mallra dhe sherbime te tjera	2600	2600
Transferime korente te brend.	3050	2850
TOTALI	5650	5450

Jane realizuar keto aktivitete :

Aktiviteti „ Karvan Karneval 2012

Aktiviteti 8 Marsi Dita e Gruas.

Aktiviteti 6 Maji Dita e luleve.

Aktiviteti Mini koncertet e veres ne rruget pedonale.

Aktiviteti Anifest Rozafa.

Aktiviteti per Dita e lumturimit te Nane Terezes.

Pjesemarrje bandes muzikore PAK ne Norvegji

Aktiviteti Giffoni Festival.

Aktivitete per Festat e Nentorit.

III. TEATRI MIGJENI

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
Paga	16503	16087
Sigurime shoqerore	2625	2568
Mallra dhe sherbime te tjera	2478	925
Sherbime nga te trete	700	700
Shpenzime transporti	400	
Mirembajtje e zakonshme	500	
Shpenzime te tjera operative	878	225
Transferime korente te brend.	3000	3000
Investime	3000	1726
TOTALI	27606	24306

Per Teatrin „Migjeni“ shpenzimet e te priteshmit 2012, sipas tabelës ndahen:

1. Shpenzimet per paga e sigurime ne shumen prej 18655 mije leke
2. Shpenzimet per mallra e sherbime ne shumen prej 925 mije leke
3. Shpenzimet per investime ne shumen prej 1726 mije leke
4. Shpenzime per Transferime per aktivitetin skenik shuma prej 3,000 mije leke, ka mbuluar shpenzimet per shfaqjet si me poshte:

- Komedia „Alo Telebingo“
- Monodrama „Seks‘ faleminders sa me e provu“
- Drama „Shtate shaljanet“
- Varicte humor e muzike „

IV. SPORT KLUB “VLLAZNIA”

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
Paga	8503	8191
Sigurime shoqerore	1390	1285
Mallra dhe sherbime te tjera	24066	21255
Transf.buxhetet familjare dhe individ	60	60
Investime	135	135
TOTALI	34214	30986

Per Sport Klub Vllaznia shpenzimet e te priteshmit 2012 ndahen sipas tabelës me siper ndahen:

1. Shpenzimet per paga e sigurime ne shumen prej 10082 mije leke

2. Shpenzimet per mallra e sherbime ne shumen prej **21255** mije leke ,ndahen sipas tabelës me poshte:

000/leke

<i>Emertimi i shpenzimeve</i>	<i>Plani 2012</i>	<i>IPritshmi 2012</i>
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith	100	107
Materiale dhe sherbime speciale	16950	14946
Sherbime nga te trete	1309	763
Shpenzime udhetimi	200	
Mirembajtje e zakonshme	100	100
Shpenzime te tjera operative	5407	5339
TOTALI	24066	21255

AKTIVITETI SPORTIV

GRUPI A

a - Boksi – shuma prej **3371 mije** leke eshte shpenzuar per aktivitetin e gjashte ekipeve zingjir, duke perfshire trajtime ushqimore 1930 mije leke , pagesa trajneresh 230 mije leke. Per Kampionatin Kombetar European **"Memorial Boks 2012"** jane likujduar laturat per shumen prej 911 mije leke, ne zerin pritje pcrejellje, dhe 300 mije faze pregatitore.

b – Basketboll M+F shuma prej 2681 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e gjashte, ekipeve zingjir duke perfshire trajtime ushqimore 2141 mije leke, pagesa trajneresh 426 mije leke, 53 mije leke materiale sportive, 61 mije leke pagese gjyqtaresh.

c - Volejboll M+ F shuma prej 2536 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e pese ekipeve zingjir duke perfshire trajtime ushqimore 1859 mije leke , pagesa trajneresh 390 mije leke, materiale sportive 65 mije leke, pagese gjyqtaresh 55 mije leke, faze pregatitore 170 mije leke.

d - Atletike shuma prej **2592 mije** leke eshte shpenzuar per aktivitetin tre ekipeve zingjir, duke perfshire trajtimi ushqimor 1698 mije leke, pagesa trajneret 444 mije leke dhe honorare per rezultate te larta 150 mije leke, faze pregatitore 300 mije leke.

e - Peshengritje shuma prej 1506 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e tre ekipeve zingjir, duke perfshire, trajtim ushqimor 1166 mije leke , pagese per trajneret 270 mije leke, materiale sportive 70 mije leke.

e - Gjimnastike shuma prej 663 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e ekipeve zingjir duke perfshire per pagesa per trajneret 60 mije leke, trajtime ushqimore per ekipin e te rriturve 603 mije leke.

GRUPI B

f - Mundje e lire shuma prej 500 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e tre ekipe duke perfshire pagesa trajneresh 150 mije leke , trajtime ushqimore 350 mije leke.

g - Ciklizem shuma prej 558 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e dy ekipeve duke perfshire trajtime ushqimore 468 mije leke dhe pagese per trajneret 90 mije leke.

gj - Shah shuma prej 295 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e tre ekipeve duke perfshire pagesa per trajneret 135 mije leke ,trajtim ushqimor 160 mije leke.

h - Judo shuma prej 140 mije leke perfshin pagese trajneri 75 mije leke dhe trajtim ushqimor 65 mije leke.

j - Hendboll shuma prej 120 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e dy ekipeve duke perfshire pagese per trajneret 120 mije leke.

k -Pingpong shuma prej 70 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e kater ekipeve duke perfshire pagese trajneri 70 mije leke.

l - Noti shuma prej 85 mije leke eshte shpenzuar per aktivitetin e ndare ne : trajtime ushqimore 35 mije leke dhe pagese trajneresh 50 mije leke.

SHERBIMET SOCIALE

Sherbimi social per vitin 2012 u planifikua te realizohej ne mbeshtetje te Planit Social Zonal duke fokusuar sherbimin sipas target-grupeve te parashikuara si femije, gra dhe te moshuar me prioritet sherbime sociale alternative per keto kategori sipas problematikave qe secili grup paraqet.

Nga sherbimet e ofruara ne zyre kane perfutuar shume qytetare sipas problematikave qe kane paraqitur edhe sherbimet komunitare jane mbeshtetur pjescrisht si psh:

dy qendrat polivalente ne shumen prej 240 mije leke

per sherbimin e identifikimit dhe mbrojtjes se viktimave te dhune ne familje shpenzohet 120 mije leke .e gjithë shuma e planifikuar ne aktivitetet promovuese te ketij sherbimi ne 16 ditet e aktivizimit kunder dhunes ne familje 25 nentor- 10 dhjetor.

ndersa rikonstruksioni i catise i planifikuar per shtepine e femijes shkollore eshte realizuar ne vleren e parashikuar.

Pasqyra permbledhese

000/lek

Nr	Lloji i sherbimit	Vlera e planifikuar	Realizimi 10 mujor	Realizimi 12 mujor i Pritshem
1,	Sherbime komunitare M.Lulaj			
	-shpenzime operative	132	4	8
	-aktivitete	240	0	0

2.	Sherbime komunitare Kiras -shpenzime operative	132	4	8
	-aktivitete	240		
3.	Sherb. Komunitare familje/gra femije	384	0	0
4.	Sherbime komunitare per te moshuar	360	0	0
5.	Sherbimi Anti-dhune	120		60
6.	Riparim catie shtepia e femijes 6-15vjec -investim	2500	1836.7	
	totali	4108	1844.7	76

ÇERDHE

Viti 2012	Totali	Paga	Sigurime	Mallra e Sherbime	Investime	Transferte individuale
Plani	26.318	15.929	2.541	6.506	1.250	92
I Pritshmi 2012	25.375	15.193	2.437	6.447	1.206	92

Zeri "mallra dhe sherbime te tjera" realizimi i pritshem do te jete 6447 mije leke, i ndare ne :

- Zeri "Materiale dhe sherbime speciale " ne shume 3981 mije leke, ku pjesa me e madhe e shpenzimeve jane ushqime.
- Zeri "Sherbime nga te trete" realizimi i pritshem do te jete 1750 mije leke, i ndare : ne 635 mije leke shpenzime per energjine elektrike, 815 mije leke shpenzime per konsum uji te pijshem dhe 300 mije leke shpenzime per lende djegese.
- Zeri mirëmbajtje te zakonshme realizimi i pritshem do te jete 476 mije leke, i ndare : ne mirëmbajtje ndortese 396 mije leke dhe mirëmbajtje paisje 50 mije leke.
- Zeri Qera objekti realizimii pritshem do te 240 mijë lekë, qe ka sherbyer per pagesen e qerave te dy kopshteve.

Zeri "Investime" realizimi i pritshem do te jete 1206 mije leke.



DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT

Gjate vitit 2012 Drejtoria e Promovim Zhvillimit dhe Marredhenieve me Publikun punen e saj e perqendroi ne aktivite per promovimin e territorit, ne koordinimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore si dhe ne hartim dhe aplikime projektesh te perbashketa me partnere vendore , kombetar dhe te huaj.

Panairi i Agrobiznesit dhe Produkteve Financiare

Ne Maj 2012 eshte organizuar panairi i Agrobiznesit dhe Finances, organizuar nga ProMali/SNV me mbeshtetjen e Bashkise Shkoder, LVIA dhe organizatave te tjera te interesuara. Panairi kishte qellim paresor promovimin e bizneseve lokale duke sjelle se bashku fermere te medhenj e te vegjel, prodhues, perpunues, tregtues dhe institucione financiare. Panairi ishte konceptuar qe te ishte: nje shfaqje e promovimit te produkteve tipike shqiptare, nje vend ku aktore te ndryshem te agrokultures mund te promovojne dhe shesin produktet/sherbimet e tyre dhe te shkembejne me njeri-tjetrin eksperiencat me te mira.

Ekspedita ne liqenin e Shkodres

Mbeshtetur nga Panairi i Romes dhe Qendra e Nautikes per kanoc dhe kajak te Trevinjano Romanos "Albatros" ne bashkepunim me Bashkine Shkoder , per here te pare realizohet ekspedita Shetitje ne Liqenin e Shkodres – Mali i Zi Shqiperi, ne qershor 2012 , nga nje grup nderkombetar kanoistash italiane, malazez dhe shqiptar. Qellimi i kesaj ekspedite ishte takimi me autoritetet vendore dhe popullsine lokale per shkembimin e eksperiencave te ndersjellta per nxitjen dhe zhvillimin e turizmit te qendrueshem nga kenveshtrimi ekologjik ne liqenin e Shkodres i cili perfaqeson nje pasuri kombetare dhe nderkombetare.

Dita e liqenit te Shkodres 17 Qershor 2012

Me rastin e "Dites se Liqenit", ne shetitoren prane Ures se Vjeter te Bunes, u organizuan nje sere aktivitetesh promovuese per vlerat e gjithanshme mjedisore, turistike, social kulturore dhe ekonomike te liqenit te Shkodres me qellim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kesaj trashegimije te pasur natyrore. Krahas organizimit te panairit te prodhimeve artizanale dhe produkteve agroushqimore te rajonit, ku moren pjese rreth 35 bizneseve, u zhvilluan disa aktivite ujqore si: Gara e maratones se notit, nga moloja e Shirokes deri tek moloja e Ures se Vjeter te Bunes, gara e notit per meshkuj dhe femra, ndeshje vaterpoli, gara me kanoc me pjesmarren e amatoreve te ketij sporti. I gjithë ky aktivitet u permbyll me nje koncert festiv live me pjesmarren e grupeve rinore muzikore te qytetit te Shkodres.

Projekti "SEENET 2- nje rrjet translokal per bashkepunimin mes Italise dhe Europes Juglindore".

Ne kuader te ketij projekti jane realizuar nje seri aktivitetesh nder te cilet mund te përmendim: Investim ne rehabilitimin e siperfaqeve publike te fshatit Zogaj me synim nxitjen dhe zhvillimin e turizmit mjedisor dhe familjar ne Liqenin e Shkodres.

Eshte realizuar nje trajnim veror me punonjes te administrates civile te institucioneve partnere. Gjithmone ne kuader te projektit eshte realizuar nje vizite studimore ne Udine per te pare nga afer funksionimin e hoteleve te shperndara. Vlora e realizuar ne kuader te projektit eshte 9 618 720 Leka. Me gjithë realizimin e sukseshem te aktiviteteve dhe te investimit nga Bashkia Shkoder, mbetet per zgjidhje diferenca e financimit per investimin e kryer ne Zogej per te cilen ka nje komunikim intensiv me donatorin e projektit per transferimin e pjeses se mbetur. Ne rast se perfundimisht nuk do te financohet kjo diference mendojme qe te perballohet nga ana e Bashkise Shkoder ne nje moment te mevonshem.

Projekti "Adria Muse"

Ne kuader te projektit AdriaMuse, u organizua ne Tetor 2012 ne Shkoder takimi nderkombetare me pjesmarrjen e te gjithë partnereve dhe Konferenca publike, me te fluar dhe pjescemarrjes te interesuar per zbatimin e ketij projekti ne Shkoder. Deri tani jane organizuar nje sere aktivitetesht promocionale si fletëpalosje, broshura, postera dhe website. Jane organizuar dy fokus grupe, njeri me aktore te interesuar te trashegimise kulturore dhe tjetri per zhvillimin e turizmit.

Projekti i zyres me nje ndalese (ZIN)

Projekti i Zyres me Nje Ndalese, i cili kontribuon per nje qeverisje lokale efektive dhe optimizim te reagimit ndaj nevojave të komunitetit, eshte ne proces zbatimi. Jane realizuar procedurat per kryerjen e punimeve te parashikuara. Vazhdojne punimet per rehabilitimin e mjedisve dhe mobilimit te ZIN, si dhe instalimin rrjetit te intranetit te gjithë bashkise.

Krijimi i Zones per Zhvillimin e Biznesit rruga "13 Dhjetori dhe 28 Nentori".

Bashkia Shkoder dhe Fondacioni per Zhvillim Shqiptaro – Amerikan ne bashkepunim te ngushte me komunitetin e biznesit dhe pronaret e zones se permiresimit te biznesit te rrugeve "13 Dhjetori" dhe "28 Nentori", ne zbatim te marreveshjes se lidhur ndermjet tyre kane krijuar shoqaten e "Zones se zhvillimit te Biznesit rruga "28 Nentori". Ashtu sic ishte parashikuar edhe ne marreveshje , gjate vitit 2012 e ne vazhdim, eshte duke u zbatuar nje nga projektet infrastrukturore me te rendesishem te qytetit, shetitortja e rruges "13 Dhjetori dhe 28 Nentori". Ne kuader te ketij projekti u realizua dhe rikonstruktimi i Qendres Kulturore per Femije. Rikonstruksioni i fasadave te ndertesave te ketyre dy rrugeve, i parashikuar ne marreveshjen perkatese, per tu realizuar gjate vitit 2013.

**DREJTORIA JURIDIKE****Mbi realizimin e buxhetit 2012 per kryerjen e procedurave ligjore, investimeve ne fushen e prokurimeve dhe inventarizimin e aseteve te Bashkise.**

Ne mbeshtetje te buxhetit te vitit 2012 dhe ndryshimeve te bera gjate vitit sipas vendimeve te Keshillit te Bashkise Shkoder , nga Drejtoria Juridike , Prokurimeve dhe Aseteve, sherbimet jane kryer si me poshte vijon :

I- Sektori Juridik: Gjate kesaj periudhe ka ushtruar detyren e saj ne disa procese dhe konkretisht ne proceset gjyqesore, marrja pjese aktive ne komisionet e shproncimit te qirave dhe privatizimit te banesave shtetore si dhe komisionet e vleresimit.

Ka hartuar urdhera te brendshem , urdheresa, projekt vendime, akt marreveshjeve dhe kontratave te sipermarrjes, supervizimit dhe kolaudimit.

Gjate vitit 2012 ka perfqesuar Bashkine ne 39 procese gjyqesore me objekte te ndryshme nga te cilat : 8 jane te pushuara , 9 jane gjykuar dhe 22 jane ne proces.

Jane realizuar nga sherbimet e kryera nga zyra juridike (vertetime martese,ctj) rreth 1.278.000 leke.

II. Sektori i Aseteve

Sektori i Aseteve gjate vitit 2012 ka ndjeke procesin e tansferimit te pronave ne njesine e qeverisjes vendore, mbeshtetur ne dispozitat ligjore :

Ligji Nr. 8652, date 31.7.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

Ligji Nr.8744, date 22.2.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore"

Vendimin Nr.500, date 14.8.25001 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore" Udhezimin Nr.15, date 30.06.2003 "Per Menyren e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per tranferimin ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike.

VKM. Nr.366, date 27.03.2008 "Per miratimin e listes paraprake te Pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim, te Bashkise Shkoder, te Qarkut Shkoder"

VKM Nr.421 , date 2.06.2010 "Miratim I listes se pjesshme te pronave shtetore qe kerkohen per transferim ne pronesi te Bashkise Shkoder

VKM Nr.598, date 14.5.2008 "Per miratimin e listes përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, qe do te transferohen ne pronesi te njesisë se qeverisjes vendore, Bashkia Shkoder, te Qarkut te Shkoderes"

VKM Nr.421 , date 2.06.2010 është mbështetur në VKB nr. 51, date 14.04.2009 "Miratim I listes se pjesshme te pronave shtetore qe kerkohen per transferim ne pronesi te Bashkise Shkoder ku pronat jane si me poshte:

Me VKM nr.421, date 2.06.2010 „Per miratimin e listes përfundimtare (te pjesshme)te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Shkoder, te Qarkut te Shkoderes“ pronat qe kalohen ne pronesi te

Bashkisë Shkodër janë si më poshtë :

Nr. rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Nr.1 pronave	Lloji i transferimit
7,13-19,21-23	Prona që përdoren në fushën Administrative	11	Ne pronesi
32-73,851,852,853	Prona që përdoren për realizimin e programeve mesimore	50	Ne pronesi
78-86,90-95,854	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	16	Ne pronesi
216;218÷225(pjesa e paprivatizuar);228÷234	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	16	Ne pronesi
241-248	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	8	Ne pronesi
107-109,121-135,173-205	Zhvillim ekonomik	51	Ne pronesi
330-403	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	74	Ne pronesi
621-631	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik	11	Ne pronesi
619-620	Infrastruktura vendore	2	Ne pronesi
578,579	Shërbim funeral	2	Ne pronesi
Totali		241	

Janë dërguar për regjistrim në ZVRPP Shkodër 164 prona, nga keto finalizuar me proces regjistrimi 58 prona dhe në proces regjistrimi 106 prona.

Faza e II-te

Jane dërguar në Ministrinë e Brendshme në A.I.T.P.P. VKB Nr.144, datë 30.12.2009 "Lista e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë :

- a) Miratimi I listës së pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të bashkisë Shkodër me fushë përdorimi "Lulishte" dhe "Rruge" me VKM Nr.144, datë 30.12. 2009 .

- ❖ Prona që përdoren në fushën e infrastruktures së shërbimeve publike, lulishta **46 prona**
- ❖ Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës së shërbimeve publike, rruge **132 prona**

Gjithsej 419 prona

Eshtë bashkëpunuar me Ministrinë e Brendshme për mbarrëvatjen e procesit të inventarizimit të aseteve të Bashkisë.

Janë zbatuar të gjitha Vendimet e Këshillit të Ministrave për pronat.

Janë përgatitur plan rievimet për pronat pyje dhe kullota të cilët do të transferohen në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe janë dërguar për regjistrim në ZVRPP Shkodër".

Pronat për Ekonomitë Pyjore dhe Kullosore të regjistruara në ZRPP Shkodër gjithsej 962.62 ha Pyje, kullota dhe toka inproduktive.

- Janë hartuar projekte për punimet silvi kulturore dhe ripyllezimit në zonën ekonomia pyjore Tarabosh.

Gjate kësaj periudhe ka ushtruar detyrën për:

Regjistrimin e aseteve në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër pas miratimit në Këshillin e Ministrave .

- **Hapjen e dosjeve** për çdo aset ku në dosje janë vendosur planimetritë e ndërtesës, plan rievimit e ndërtesës, certifikatën e pronësisë (kur ka), vlerësimet e gjendjes, etj.

Bashkërendimi i punës për vlerësimin e aseteve privatë të propozuara për shpronësim për interes publik :

- Llogaritja e koston së përafërt për shpronësim.
- Hartimi i projekt vendimeve të këshillit bashkiak për shpronësimin e aseteve për nevojat publike në përputhje me ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999.
- Bashkëpunimi me sektorin juridik për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimin e Këshillit Bashkiak për shpronësimin, duke iu përmbajtur kërkesave ligjore.
- Kryerja e procedurës së shpronësimit me të marrë miratimin e këshillit të Ministrave dhe transferimin e aseteve tek bashkia për përmbushjen e nevojave publike për të cilat është kërkuar shpronësimi.

Eshtë punuar për azhurmimin e pronave sipas kërkesave, në ndihmë të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Përgatitja e dokumentacionit për nxjerrjen e koeficientit të bashkëpronësisë së truallit të objekteve të privatizuara sipas informacioneve që disponohet duke ju përmbajtur kërkesave të qytetarëve si informacionit që merret nga Ministria e Financave.

Përgatitja e dokumentacionit hartografik për kontratat dhe akt marrëveshjet që do të lidhen ndërmjet bashkisë dhe të tretëve do të përgatiten planimetria dhe gjatë plani.

- Eshtë bashkërenduar puna me Drejtorinë Juridike, Finances dhe Urbanistike në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të shpronësimit , bazuar në fondin e miratuar në buxhetin e vitit 2012 për likuidim shpronësimi dhe procese gjyqësore (vendime përmbartimore) sqarojnë se janë realizuar këto likuidime nga drejtoria e finances për vitin 2012 në vlefën prej 8 307 828 lek.

III- Drejtoria e Prokurimeve

Gjate vitit 2012 nga Drejtoria e Prokurimeve Publike , mbështetur në miratimin e buxhetit dhe VKB përkatëse, gjatë vitit janë realizuar procedurat e prokurimit në vlefën prej 208.332.167 leke nga të cilat :

a- punë civile	121.007.294	leke
b- furnizime	81.025.271	leke
c- shërbime	6.299.602	leke



ADMINISTRATA

Drejtoria e Administrimit dhe Personelit mbulon nevojat per shpenzimet operative per administraten e Bashkise dhe pjeserisht (gaz, karburant, kanceleri, leter, boje dhe materiale pastrimi) per institucionet e varesise ku perfshihen: Teatri, Dega Ekonomike e Kultures, Klubi Shumesportesh "Vllaznia", Zyra e Arsimit (arsimin parauniversitar, kopshte) dhe Drejtorine e Cerdheve.

ADMINISTRATA

leke

Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + i pritshem 2012
Paga	103,008,500	91,723,830
Sigurime Shoqerore	16,653,000	14,493,351
Transferime buxhete familj. individuale	1,831,500	1,831,500
Shpenzime Operative	57,487,200	49,822,053
Investime	3,445,000	2,920,826

A- Ne vitin 2012 ne zerin shpenzime operative jane realizuar gjithsejt :

leke

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	I Pritshem 2012
602	Mallra dhe sherbime te tjera	57,487,200	49,822,053
6020	Materiale dhe sherbime zyre te pergjithme	8,400,000	6,730,702
6021	Materiale dhe sherbime speciale	480,000	391,680
6022	Sherbime nga te trete	14,216,000	12,971,676
6023	Shpenzime transporti	9,709,200	9,059,831
6024	Shpenzime udhetimi	782,500	782,500
6025	Mirembajtje e zakonshme	1,460,000	780,000
6026	Qeradheniet	480,000	480,000
6027	Detyrime dhe kompensime legale	7,000,000	7,000,000
6028	Shpenzime per huamarrjen	0	0
6029	Shpenzime te tjera operative	14,959,500	11,625,664

Po vijojme analizen sipas grupeve dhe ne menyre analitike.

➤ *Materiale e sherbime zyre te pergjithshme* “ i detajuar si me poshte:

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + I pritshem
6020	Materiale e sherbime zyre te pergjithme	8,400,000	6,730,702
6020100	Kancelari	3,000,000	2,368,561
6020200	Materiale per pastrim,ngrohje dhe ndricim	3,000,000	2,453,148
6020300	Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres	480,000	477,400
6020400	Materiale per funksionim paisjeve speciale	480,000	304,813
6020500	Blerje dokumentacioni	960,000	646,780
6020900	Furnizime ,materiale te tjera zyrc	480,000	480,000

- Zeri "Kancelari"eshte realizuar me tender ne vleren prej *2 369 mije leke*.
- Zeri "Blerje materiale pastrimi “ eshte realizuar me tender ne vleren *2 453 mije leke*, keto per nevoja te institucioneve te varesise dhe te administrates se bashkise
- Tek zeri “Materiale per funksionimin e paisjeve te zyres “,ishte parashikuar ne vleren prej 480 mije leke shpenzime per blerje llampa ,zgjatues ,karroca dore, tela elektrike, zorre etj ,realizim + I pritshem eshte ne vleren prej *477 mije leke* .
- Tek “ Materiale per funksionimin e paisjeve speciale” ishte parashikuar ne vleren prej *480 mije leke* per blerje paisje te ndryshme kompjuterike, realizim + I pritshem eshte ne vleren prej *304 mije leke*.
- Tek “Blerje dokumentacioni “ishte parashikuar ne vleren prej *960 mije leke* per shpenzime blerje shtypshkrime per nevoja te institucioneve te varesise dhe administrates se bashkise dhe shpenzime blerje gazeta pregatitje harta per regjistrim kullota etj, realizim + i pritshem eshte ne vleren prej *647 mije leke*
- Tek “Furnizime materiale te tjera zyre” ishte parashikuar ne vleren prej *480 mije leke* per shpenzime per blerje kurora, aksesore per perde , shpenzime per funksionimin e fikesave te zjarrit ,shirite per inaugurime, bishta flamujsh etj, realizim + i pritshem eshte ne vleren prej *480 mije leke*.

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + I pritshem 2012
6021	Materiale dhe sherbime speciale	480,000	391, 680

- Zeri “*Sherbime speciale*” ishte parashikuar ne shumen prej 480 mije leke per blerje te uniformave te policise bashkiake,bazuar ne vendimin e keshillit te ministrave nr. 333 date 02.06.1998 per “Miratimin e normes se veshmbathjes per policine” per kostume, pantallona verore, xhakovento, kemisha, kepuce,pulovra, stema dorca pune etj dhe eshte realizuar ne shumen prej *392 mije leke*.

- Zeri **"Sherbime"** i detajuar si me poshte:

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + I pritshem
6022	Sherbime	14,216,000	12,971,234
6022001	Energji elektrike	2,600,000	2,600,000
6022002	Uje	600,000	600,000
6022003	Telefon	1,200,000	928,000
6022004	Postare	200,000	200,000
6022005	Lende djegese	7,425,000	7,232,134
6022007	Tarifa bankare	30,000	
6022009	Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit		
6022010	Printime dhe publikime	550,000	144,000
6022011	Trajnim dhe seminare		
6022099	Te tjera	1,611,000	1,267,100

- Zeri **Energji elektrike** ishte parashikuar ne vleren prej **2 600 mije lekesh**, eshte realizuar ne vleren prej **1 663 mije leke** dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **2 600 mije leke**.
- Zeri **Uje** ishte parashikuar ne vleren prej **600 mije lekesh** per shpenzime uji dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **600 mije leke**.
- Zeri **Telefon** ishte parashikuar ne vleren prej **1 200 mije leke** per shpenzimet per telefonine fikse per titullaret dhe drejtoret e drejtorive shpenzime keto te parashikuar ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 864, dt 23.07.2010 si dhe telefonine fikse per titullaret dhe drejtorite ,realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **928 mije leke** .Mosrealizimi i parashikimit eshte si rrjedhoje e ndryshimit te nivelit te pagave me VKM nr.518 date 16.08.2012 per kategorie "drejtor i pergjithshem".
- Zeri **"Postare"** ishte parashikuar ne vleren prej **200 mije leke** per shpenzime sherbime telegrafike e postare dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **200 mije leke**.
- Zeri **Lende djegese** ishte parashikuar ne vleren prej **7 425 mije lekesh** .Ne kete ze perfshihen shpenzimet per gaz sipas kerkesave te paraqitura nga drejtorite dhe institucionet e varesise.Fshte realizuar me tender ne vleren prej **7 232 mije leke**.
- Zeri **"Sherbime te printimit dhe publikimit "**ishte parashikuar ne vleren prej **550 mije leke**.
- per shpenzimet per njoftime,botime ne gazeta lokale e kombetare, spote publicitare, reklama etj, dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **144 mije leke**.
- Zeri **"Sherbime te tjera"** ishte parashikuar ne vleren prej **1 611 mije leke** per shpenzimet per sherbim interneti ne vleren prej per faqen e internetit,shpenzime per sherbime vleresim objekte ,pagese sherbim AKEP,instalime programe finance dhe per burimet njerezore sherbim vrasje qensh,sherbim larje tapeta,kolltuke,automjete etj. dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **1 267 mije leke**.

- Zeri “*Shpenzime transporti*” është realizuar si me poshte:

leke

	Emertimi i shpenzimeve	Plan	Realizim + i pritshëm
		2012	2012
6023	Shpenzime transporti	9,709,200	9,059,831
6023100	Karburant	8,269,200	8,060,337
6023200	Pjesc kembimi	480,000	480,000
6023300	Siguracion	480,000	332,694
6023900	Shp. te tjera(riparime auto)	480,000	186,800

- Zeri “*Shpenzime karburant*” ishte parashikuar ne vleren prej 7 872 mije leke per shpenzimet per blerje karburant per kaladaja dhe automjete , vaj makinash ,keto sipas nevojave te institucioneve te varesise dhe administrates. Me VKB nr.34 date 30.05.2012 u miratua edhe nje fond shpenzimesh prej 397 mije leke per shpenzime karburant per realizimin e punimeve per sistemimin e vend depozitimit te mbetjeve urbane dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej 8 060 mije leke.
- Zeri “*Pjese kembimi*” ishte parashikuar ne vleren prej 480 mije leke per shpenzimet per pjesc kembimi goma,bateri etj. dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej 480 mije leke.
- Zeri “*Siguracion*” ishte parashikuar ne vleren prej 480 mije leke per siguracionet e makinave te administrates e policise bashkiake dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej 333 mije leke.
- Zeri “*Shpenzime te tjera*” ishte parashikuar per riparimet e avarive te makinave te administrates, motor gjeneratorit, autoshkallës,elektrovincit, makines se vizimit, prereses etj dhe dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren prej 187 mije leke.
- Zeri “*Shpenzime udhetimi*”:

leke

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + I pritshëm 2012
6024	Shpenzime udhetimi	782,500	782,500
6024100	Udhetimet e brendshme(dieta)	582,500	582,500
6024200	Udhetime e dieta jashte shteti	200,000	200,000

- Zeri "Mirembajtje e zakonshme" ishte parashikuar ne vleren prej 1 460 mije leke

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + I pritshem 2012
6025	Mirembajtje e zakonshme	1,460,000	780,000
6025300	Mirembajtje ndertesa(lyerje etj)	480,000	200,000
6025400	Mirembajtje,rrjete elektrike	200,000	-
6025500	Mirembajtje aparate e pajisje teknike	300,000	300,000
6025800	Mirembajtje paisje zyre te pergjith	480,000	280,000

- Zeri "Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore" ishte parashikuar ne vleren prej 480 mije leke shpenzime per lyerje ndertesa ,meremetime, riparime te ndryshme objekti etj dhe realizim + i pritshem i eshte ne vleren prej 200 mije leke
- Zeri "Shpenzime per mirembajtje per ngrohje, rrjete elektrike, telefonike, ujore ishte parashikuar ne vleren prej 200 mije lekesh per sherbime dhe instalime rrjete elektrike, pjese hidraulike , kablo elektrike etj.nuk eshte realizuar.
- Zeri "Mirembajtje per aparate paisje teknike" ishte parashikuar ne vleren prej 300 mije lekesh, per mirembajtje per aparatet teknike, mirembajtje paisje fonie,riparime skanera/pc/fotokopje,printera etj dhe realizim + i pritshem i eshte ne vleren prej 300 mije leke
- Zeri "Shpenzime per mirembajtje paisje zyre te pergjithshme" ishte parashikuar ne vleren prej 480 mije lekesh per mirembajtjen e paisjeve te zyrave dhe realizim + i pritshmi 2012 eshte ne vleren prej 280 mije leke.
- Zeri "Qera objekte" ishte parashikuar ne shumen prej 480 mije leke ,eshte realizuar ne vleren prej 264 mije leke dhe realizim+ i pritshmi 2012 eshte 480 mije leke.

leke

	Emertimi i shpenzimeve	Plan 2012	Realizim + i pritshem 2012
6026	Qera objekteve	480,000	480,000
6026100	Qera salle, etj.	480,000	480,000

- Zeri "Detyrime dhe kompensime legale" ishte parashikuar per detyrimet gjyqesore ne vleren prej 7 000 mije leke dhe ka mbetur per likuidim ne vitin 2013 .

➤ Zeri "Shpenzime te tjera operative" eshte realizuar si me poshte:

	Emertimi i shpenzimeve	Plani 2012	Realizim + i pritshem 2012
VIII	Shpenzime te tjera operative	14,959,500	11,625,664
6029001	Shpenzime pritje,percjellje	780,000	480,000
6029002	Aktivitet te ndryshme	800,000	714,764
6029004	Siguracion ndertese	480,000	469,000
6029005	Shpenzime per honorare	9,417,000	7,541,000
6029006	Shpenzime kompensimi (per zyrtare te zgjedhur)		
6029099	Te tjera mat e sherb operative	3,040,500	2,420,500
6029099	Te tjera (Projekti seenet)	145,000	

- Per shpenzime pritje peregjellje ishte parashikuar ne vleren prej **780 mije leke**, dhe realizim + i pritshem eshte ne vleren **480 mije leke**.
- Per aktivitete te ndryshme ishte parashikuar ne vleren prej **800 mije leke**, u realizua ne vleren prej **715 mije leke** per dreken e Iftarit, festen e liqenit dhe aktivitetin e 2 Prillit.
- Siguracioni i nderteses se bashkise ishte parashikuar ne vleren prej **480 mije leke** dhe eshte realizuar ne vleren prej **469 mije leke**.
- Fondi i planifikuar per "**Honorare dhe shpenzime kompensimi**" ishte planifikuar ne vleren prej **9312 mije leke**, realizim + i pritshmi i v.2012 eshte **7541 mije leke**, mosrealizimi eshte si pasojë e mosrritjes 5% te pagave qe duhej te shtohet ne baze te vendimit nr.518 date 16.08.2012 "Per disa ndryshime ne vendimin nr.1619 date 02.07.2008 te Keshillit te Ministrave, per klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive te qeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjesve te organeve te qeverisjes vendore".
- **Te tjera materiale e sherbime operative** ishte planifikuar ne vleren prej **3 040 mije leke** per blerje dhurata, blerje korniza per tituj nderi postera, banca, blerje albume, shpenzime per sete flamuj NATO, kombetare, stema bashkie ,fishcekzjarre etj dhe realizim + i pritshmi i v.2012 eshte **2 421 mije leke**.
- B- Ne zerin "**Investime**" per vitin 2012 u realizua ne vleren **2 921 mije leke** te ndara : Blerje pajisje ne vleren prej **2 446 mije leke** dhe rikonstruksione ne vleren prej **475 mije leke**.



BURIMET E FINANCIMIT


TE ARDHURAT

Të ardhurat e njësjve të qeverisjes vendore përbëhen nga:

I.1 TË ARDHURAT E VETA

I.2 TË ARDHURA NGA BURIME KOMBETARE

	000/leke	ne %
Burimet e Financimit	Plani 2013	Peshe specifike
Grant	373044	49.4%
Ardhurat e veta & Donator	381684	50.6%
Shuma	754728	





TE ARDHURAT

Taksa vendore e biznesit te vogel

Zbatohet nga çdo subjekt, kur e ardhura bruto vjetore gjatë vitit fiskal është me e vogël ose e barabartë me 8.000.000 Leke. Kategoritë e bizneseve sipas llojit janë: shitje (shumicë dhe pakicë), prodhim, shërbim dhe profesione të lira.

Nivelet treguese të takses orientohen sipas aneksit 5 të Ligjit 9632 „Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me të drejtën për ndryshim -30/+10% nga organi legjislativ i bashkisë.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksë mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, biznese dhe familjarë, pronarë të pasurive ndërtesa dhe tokë bujqësore. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nivelet treguese të takses orientohen sipas aneksit 1 dhe 2 të Ligjit 9632 „Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me të drejtën për ndryshim +/-30% nga organi legjislativ i bashkisë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e takses është vlera në Leke e investimit të ri që kërkohej të kryhet, ndërsa niveli shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe shlyhet nga investitori. E ardhura nga kjo takse mbledhet nga organi që lejon lejen e ndërtimit.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit rrugor

Detyrimi për këtë takse llogaritet sipas pikës 3, të nenit 4 të Ligjit Nr. 9975, dt. 28.07.2008 „Për Taksat Kombëtare“ i ndryshuar. Detyrimi për taksën i takon pronarit të mjetit sipas vendbanimit ose selisë së tij. E ardhura nga taksa mbledhet nga strukturat e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësive për pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësive për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të të drejtës së pronësive bazuar në sipërfaqen e ndërtimit të pronës që transferohet nga personi që kalon të drejtën e pronësive, dhe llogaritet nga zyrtarët e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rolin e agjentit tatimor.

Taksa e fjetjes në hotel

Baza e takses është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Niveli i takses është 5% e çmimit të fjetjes. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel dhe mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë.

Taksa te tjera:

Taksa per zenien e hapesires publike per qellime biznesi llogaritet si detyrim mujor dhe shprehet ne meter katror siperfaqe publike te zene.

Taksa e tabelës ndahet sipas qellimit te tabelës ne:

-tabela per bizneset per qellime identifikimi, te trupezuar ne siperfaqen e ndertesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin, dhe kur nuk perdoret per te reklamuar aktivitetin e te treteve.

-tabela per qellime reklamimi, te thjeshta dhe elektronike.

Te ardhura jo tatimore

Te ardhura nga tarifat vendore, siç jane tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit vilen ne baze te ligjit 8652, dt. 31.07.2000 „Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“, dhe paguhen nga bizneset, institucionet e familjaret. Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per sherbimet publike qe ofron, si pastrim, gjelberim, ndriçim, duke u orientuar ne pergjithesi ne perafrimin e kostos se tyre.

Te ardhura te tjera jotatimore, siç jane te ardhura nga veprimtarite ekonomike, te ardhura nga shitja e pasurive kapitale te njesise vendore te lejuara me ligj, te ardhura nga qerate mbi trojet, ndertesat dhe objektet e tjera vendore, te ardhura nga kontribute dhe sponsorizime te ndryshme, si ndihma, dhurime, sponsorizime, te ardhurat nga gjobat dhe kundravajtjet administrative“, si dhe nga te ardhura te tjera.

Te ardhura nga institucione varesie te njesive te qeverisjes vendore, ku bejne pjese pagesat per çerdhet, pagesat per kopshtet, pagesat e nxenesve te shkollave te mesme, pagesat nga konviktor me burse, gjysme-burse si dhe te ardhura te tjera nga institucione vendore.

Te ardhurat e parashikuara nga biznesi, duke perfshire edhe taksen e ndikimit ne infrastrukture, zene 55% te te ardhurave te veta, ndersa se bashku me taksat dhe tarifat familjare, duke perfshire edhe parkingun per mjetet personale, zene rreth 70% te te ardhurave te Bashkise Shkoder.

Te dhenat per biznesin perpunohen, ruhen dhe administrohen nepermjet sistemit te kompjuterizuar fiskal, qe ofron shpejtesi ndaj tatimpaguesit, siguri ne ruajtjen e te dhenave

Te dhenat per taksapaguesit familjare per vitin 2013 do te vazhdojne te perpunohen dhe administrohen nepermjet sistemit te kompjuterizuar te ndermarjes se Ujsjelles Kanalizime, qe ne rolin e agentit tatimor bashke me tarifat per sherbimin e ujit vjel edhe taksat dhe tarifat familjare. Taksat dhe tarifat do te vilen ne baze mujore, dhe mund te paguhen ne cdo arke te ndermarjes se Ujsjelles Kanalizime te shperndare ne qytetin e Shkodres si dhe nepermjet te gjitha bankave te nivelit te dyte.

Strategjia e rritjes se te ardhurave si nga biznesi ashtu dhe nga familjaret shihet ne shtrirjen e bazes se taksapaguesve dhe ne saktesimin e te dhenave te taksueshme te subjekteve, gje qe realizohet nga Drejtoria e te Ardhurave dhe nepermjet bashkrendimit te punes me drejtorite paralele dhe institucionet e pushtetit qendror si Drejtoria Rajonale Tatim-Taksave, Zyra Regjistrimit Pasurive Paluajtshme, QKR etj.,

Arketimet per taksa dhe tarifate familjare parashikohet te kene rritje, kjo kryesisht nepermjet sensibilizimit te taksapaguesve familjare, kontaktet nga afer me institucionet shtetore per shlyerjen nga punonjesis buxhetore te ketij detyrimi dhe ne ndjekjen e masave shtrenguese.

Te ardhurat e veta luajne nje rol te madh per sigurimin e burimeve financiare ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj. Burimet kryesore jane taksat dhe tarifate e bizneseve dhe familjeve.

Burimet kryesore jane planifikuar ne rritjen e bazeve taksapaguese, rritjen e konkurrences se ndershme, goditjen e evazionit fiskal, uljen e numrit te subjekteve debitoare, implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe ndertimin e marrëdhënieve te mira me taksapaguesit, rritja e sensibilitetit te biznesit per perfshirjen ne skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritja e ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, perqendrimi i administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe bashkepunimi i mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.

Struktura e biznesit në bazë të xhirrove dhe kategorive, Planifikimi për vitin 2013

Niveli i biznesit sipas detyrës dhe kategorisë së veprimtarisë	N. shtet. për vitin 2013	Taksa e BV		Taksa Tabare		Taksa ndërese		Tarifa gjelbra		Tarifa ndajm		Tarifa pasiv		
		Vlera / rjes	Te ardhurat	Vlera / rjes	Te ardhurat	Vlera / rjes	Sasa	Te ardhurat	Vlera / rjes	Te ardhurat	Vlera / rjes	Te ardhurat	Vlera / rjes	Te ardhurat
Detyrimi	1.000													
TREGU	1.000	27.500	23.345.000	120	114.800	150	27.400	4.125.000	350	345.177	320	314.940	1.941	1.859.421
SHERBIME	346	22.300	7.512.000	120	41.800	150	12.900	1.620.150	215	96.596	200	89.960	1.536	531.124
PRODHIM	55	51.300	580.100	120	4.200	40	2.376	95.131	320	11.596	301	10.344	1.779	62.250
PROFESIONE TËLËR	100	39.300	4.200.000	120	18.800	150	2.332	348.800	439	55.836	399	51.675	2.347	305.269
- shërbim ligjor							40	371						
2.3 mil.	398													
TREGU	255	52.300	15.570.000	120	35.400	150	17.200	1.840.000	727	206.541	545	180.275	3.808	1.123.364
SHERBIME	59	47.300	1.844.700	120	4.800	150	1.800	95.000	652	24.631	576	22.474	3.430	132.865
PRODHIM	25	49.300	1.455.500	120	3.400	40	1.333	121.333	652	19.190	304	17.305	3.555	103.372
PROFESIONE TËLËR	55	58.300	1.923.500	120	3.900	150	305	130.750	722	25.815	714	23.554	4.214	139.261
- shërbim ligjor							40	0						
3.4 mil.	45													
TREGU	29	89.300	2.006.100	120	3.400	150	1.576	356.400	823	27.066	351	24.686	5.025	145.748
SHERBIME	6	81.300	219.000	120	800	150	168	25.180	825	4.398	782	3.912	4.620	23.399
PRODHIM	6	89.300	386.000	120	710	40	311	36.880	858	6.327	510	4.860	4.752	26.593
PROFESIONE TËLËR	8	74.300	586.100	120	860	150	211	31.650	818	6.067	520	7.360	5.432	43.453
- shërbim ligjor							40	0						
4.5 mil.	43													
TREGU	6	85.300	514.800	120	750	150	800	73.800	1.159	6.954	1.258	6.345	6.243	37.461
SHERBIME	3	81.300	340.900	120	360	150	188	27.000	1.054	3.251	385	2.966	6.838	17.513
PRODHIM	1	82.300	62.500	120	130	40	130	4.800	1.14	1.114	1.216	1.016	6.030	6.300
PROFESIONE TËLËR	5	61.300	375.600	120	360	150	59	7.650	1.254	3.703	1.126	3.375	6.849	19.348
- shërbim ligjor							40	0						
5.6 mil.	12													
TREGU	5	102.300	511.500	120	900	150	305	42.750	1.355	6.825	1.264	6.315	7.451	37.306
SHERBIME	2	96.300	190.000	120	340	150	35	6.350	1.310	2.819	1.195	2.390	7.055	14.111
PRODHIM	2	91.300	196.000	120	340	40	138	6.650	1.340	2.680	1.223	2.445	7.216	14.435
PROFESIONE TËLËR	3	107.300	325.400	120	360	150	75	11.800	1.460	4.381	1.333	3.688	7.067	23.301
- shërbim ligjor							40	110						
6.7 mil.	11													
TREGU	4	118.300	118.600	120	130	150	100	16.000	1.611	1.511	1.470	1.470	8.875	8.379
SHERBIME	3	113.300	359.900	120	360	150	167	26.000	1.535	4.507	1.401	4.204	8.273	24.519
PRODHIM	2	116.300	381.000	120	340	40	210	6.400	1.558	3.132	1.429	2.858	8.435	16.871
PROFESIONE TËLËR	5	134.300	251.500	120	360	150	141	21.150	1.655	6.432	1.539	7.694	9.055	45.424
- shërbim ligjor							40	300						
7.8 mil.	0													
TREGU	0	121.300	0	120	0	150	0	0	1.827	0	1.576	0	8.897	0
SHERBIME	0	123.300	0	120	0	110	14	0	1.762	0	1.502	0	9.491	0
PRODHIM	0	122.300	0	120	0	40	0	0	1.752	0	1.536	0	9.853	0
PROFESIONE TËLËR	0	141.300	0	120	0	150	0	0	1.913	0	1.745	0	10.332	0
- shërbim ligjor							40	0						
Transit	105													
	11	13.250	211.750	120	1.200			0	247	2.720	226	2.482	1.332	14.563
	27	38.300	1.434.700	120	4.400			0	511	16.907	496	17.251	2.753	101.361
	22	30.300	885.600	120	3.800			0	425	12.977	370	11.640	2.184	69.303
	12	44.300	528.000	120	1.400			0	558	7.098	535	6.420	3.159	37.304
	9	52.300	415.200	120	1.300			0	707	6.362	545	6.605	3.906	34.273
	3	55.300	55.000	120	150			0	757	737	573	673	3.970	3.970
	4	82.300	330.000	120	400			0	1.114	4.455	1.216	4.065	6.030	24.300
Grande	205	18.250	4.094.000	120	34.900	150	2.370	356.500	247	51.435	226	46.500	1.332	277.373
Armatë (Mensurat)	117	5.000	540.500					0	75	6.816	85	8.044	406	47.480
Banorë i vogël	2.385	31.741	15.643.800		271.900	4.031	73.325	1.893.640	419	997.736	382	910.343	2.258	5.374.366
Biznesi i Madh dhe Institucional														
PRANIMORITET	58			120	8.300	150	1.645	248.750	15.020	870.000	4.700	252.000	70.000	6.080.000
PRODHIM	30			120	9.600	40	69.528	2.787.120	4.020	320.000	4.700	330.000	90.000	4.000.000
TREGU	318			120	35.190	150	25.024	3.753.600	4.020	1.272.000	4.700	1.272.000	25.000	7.950.000
SHERBIME	146			120	17.500	150	10.423	1.518.450	4.020	584.000	4.700	554.000	30.000	4.300.000
- Shërbim Internal, Armatë, Agjenci, Bankat						40	4.273	170.920						
KARBURANTE	12			120	1.410	150	1.036	154.400	7.000	84.000	7.000	34.000	45.000	540.000
OJF	48			120	5.750	30	7.955	221.850	2.500	120.000	2.500	120.000	3.000	144.000
INSTITUTETORE	30			120	3.840	30	1.758	52.740	2.500	80.000	2.500	30.000	33.000	58.014
Biznesi i Madh	694			120	83.250	12.891	121.240	8.906.830	4.738	3.339.000	3.679	2.682.000	31.000	21.332.614
Për rimbursim sipas planit për vitin 2013														
Te ardhura nga shërbimi me infrastrukturë														
TOTAL														
	3.074	23.142	71.139.614		354.840	6.025	18.519.670	1.408	4.327.716	1.172	3.602.343	9.208	21.308.680	

KATEGORITE E	Plani 2013 (ne mije Leke)
TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ	381,685
TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE	230,738
Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel	71,140
Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertesa)	33,440
nga biznesi	20,600
nga familje	12,840
Taksa fjetjes ne hotel	1,250
Taksa ndikimit ne infrastrukture	50,000
Taksa kalimit drejtes pronesis	6,550
Taksa e regjis pervitshem mjete transp	56,000
Takse zenie hapësira publike	3,700
Takse tabele	355
Taksa reklame	8,303
TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	109,407
Tarife vjetore per pastrimin, heqje mbeturina	58,607
nga biznesi	28,307
nga familje	30,300
Tarife ndriçimi	15,722
nga biznesi	3,602
nga familje	12,120
Tarife gjelberimi	10,388
nga biznesi	4,328
nga familje	6,060
Tarife per leje sherbimi veterinar	1,500
Tarife sherbimi parkim automjete	5,100
nga mjetet per biznes	1,600
nga mjetet personale	2,000
parking i rezervuar	1,500
Tarife licensa transporti	505
Tarife per license karburanti	1,100
Tarife sherbimi per Urbanistiken	300
Tarife per Legalizim, Urbanizim (ALUIZNI)	13,000
Tarife sherbimi dublikate arkivi	85
Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	3,100
Muzeu Historik	1,500
Teatri Migjeni	1,400
Qendra Kulturore Femijeve	100
Pallati Sportit	100
TE ARDHURA JOTATIMORE	18,512
Te ardhura nga qera	720
Te ardhura nga gjendja civile	200
Te ardhura nga bursa (shkollat)	250
Te ardhura nga kopshtet	6,438
Te ardhura nga cerdhet	4,004
Te ardhura nga kundrvajtje administrative	6,900
gjobe per mosshlyerje detyrimi ne afate ligjore	3,500
gjobe nga kontrole dhe inspektime	300
gjoba Policia bashkiake	1,700
gjoba nga Inspektoriat Ndertimit Vendor	1,400
TE ARDHURA NGA KONTRIBUTE	23,028
Donacione	23,028
projekte	23,028

1.2 TË ARDHURA NGA BURIME KOMBETARE

Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga këto burime kombëtare:

1. Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", si dhe për arritjen e barazisë së burimeve mes njësive të ndryshme të qeverisjes vendore në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2013 është **373 044 mijë leke**.

Për vitin 2013 janë bërë këto përmirësime

- Të dhënat e popullsisë për vitin 2013, janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me të dhënat e Shtatorit 2012.*
- Janë përfshirë në transfertën e pakushtëzuar edhe administrimi i konvikteve të arsimit parauniversitar.*
- Eshtë përfshirë në transfertën e pakushtëzuar dhe administrimi i 5 qendrave të shërbimit social.*
- Krahasuar me vitin 2012 të gjitha njësitet e qeverisjes vendore kanë përfituar 1-7 % më shumë transfertë të pakushtëzuara.*

2. Transferta të Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2013, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde do të përdoren nga njësitet e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë dhe në përputhje me rregullat e caktuara nga pushteti qendror. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund ti përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara.

Për buxhetin e vitit 2013 transferta e kushtëzuar që do akordohet për Bashkinë Shkoder do konfirmohet nga Ministrinë e linjes gjate vitit 2013.

Në fondet e kushtëzuara për funksionet e përbashkëta përfshihen:

- **Transfertat e Kushtëzuara për funksionet e përbashkëta**
- **Fondet për zhvillimin e rajoneve.** Në bazë të Aneksit nr.3 të ligjit "Për buxhetin e vitit 2013", për shpërndarjen e fondeve të rajoneve ngrihet komiteti vlerësimit dhe miratimit të projekteve.

Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për objektet arsimore.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për objektet e ujësjellës kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimore, thertoresh dhe objekte për ujë/kullim.
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbehet nga:

- *Granti konkurrues për infrastrukturën vendore*
- *Granti konkurrues për arsimin baze parauniversitar dhe universitar*
- *Granti konkurrues për shëndetësinë*
- *Granti konkurrues për objektet kulturore*
- *Granti konkurrues për ujësjellës kanalizime*
- *Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh*
- *Granti konkurrues për Ujitjen dhe Kullimin*
- *Granti konkurrues për Pyllëzimet*

- **Arsimi parauniversitar**

Investimi: Në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës për vitin 2013, janë të planifikuar fondet për investime për arsimin parauniversitar në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve. Njësitë e qeverisjes vendore do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të vlerësimit të tyre nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet konkurrimit. Njësitë e qeverisjes vendore mund të financojnë edhe nga të ardhurat e veta në arsimin

- **Transferrat e Kushtëzuara për Funkcionet e Deleguara**

- Fonde për Ndihmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.
- Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta pra përfshihen në buxhetin e kësaj Ministrie. Ato ju delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmës ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore. Për buxhetin e vitit 2013 transferat e kushtëzuar që do akordohet për Bashkinë Shkodër do konfirmohet nga Ministritë e linjës gjatë vitit 2013.

KAPITULLI I SHPENZIMEVE**III. SHPENZIMET**

Shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore ndahen në:

II.1 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E VETA (EKSKLUZIVE)**II.2 SHPENZIMET PËR FUNKSIONET E PËRBASHKËTA****II.3 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E DELEGUARA****II.1 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E VETA (EKSKLUZIVE)****II.1 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E VETA (EKSKLUZIVE)**

Funksionet e veta, përfaqësojnë funksionet që janë përgjegjësi ekskluzive e vetë njësive të qeverisjes vendore.

Financimi i tyre bëhet nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Në shpenzimet për funksionet e veta përfshihen:

- *Të gjitha shpenzimet për administratën vendore duke përfshirë pagat, kontributin e sigurimeve shoqërore, shpenzimet operative dhe investime.*
- *Të gjitha shpenzimet për shërbimet publike si: pastrim, gjelbërim, dekor, funeral, ndriçim qyteti etj. duke përfshirë kosto të personelit, shpenzime operative dhe investime.*
- *Të gjitha shpenzimet për institucionet vendore të kulturës dhe sportit (me përjashtim të shpenzimeve për cilësinë sportive, ku Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve mbulon me grantin e saj, financimin e sportistëve dhe trajnerëve cilësorë .*
- *Të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve vendore duke përfshirë kosto të personelit, shpenzime operative dhe investime.*
- *Shpenzimet për transportin urban.*

II.2 SHPENZIMET PËR FUNKSIONET E PËRBASHKËTA

Funksionet e përbashkëta, lidhen me ato fusha të veprimtarisë që janë përgjegjësi e përbashkët e qeverisjes qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore, përgjegjësi kjo e ndare qartë për secilin nivel.

Shpenzimet për kryerjen e funksioneve të përbashkëta përballohen nga:

- *Transferta e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit për njësitë e qeverisjes vendore.*
- *Të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore.*
- *Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) për investime në arsimin parauniversitar.*
- *Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) për investime në kujdesin parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik.*

➤ Arsimin:

Mirëmbajtjen dhe funksionimin e shkollave të cilat financohen nga burimet e veta vendore. Këto shpenzime miratohen në buxhetin e pavarur të njërive vendore.

Investime në arsimin parauniversitar, të përfituara nga njësitë e qeverisjes vendore nga granti konkurrues për arsimin. Këto shpenzime miratohen në buxhetin e kushtëzuar të njërive vendore.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të financojnë nga të ardhurat e veta për ndërtim, rikonstrukcion dhe pajisje të kopshteve dhe shkollave të arsimit parauniversitar dhe në këtë rast shpenzimet miratohen në buxhetin e pavarur të njërive vendore.

Shpenzimet për trajtimin ushqimor të nxënësve bursistë, konviktore përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

II.3 SHPENZIME VENDORE PER FUNKSIONET E DELEGUARA.

Në shpenzimet vendore për funksionet e deleguara përfshihen:

Shpenzimet për mbrojtjen sociale

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta detajon në fillim të vitit 2013, fondet e ndihmës ekonomike dhe pagesën e paaftësisë. Këto fonde i delegohen çdo njësie të qeverisjes vendore që në fillim të vitit.

Shpenzimet për përkujdesjen shoqërore

Financimi i shërbimeve të përkujdeset shoqëror, që realizohen nga bashkitë komunat dhe qarqet, do të bëhen nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat vendore. Fondet nga buxheti jepen në formën e grantit të kushtëzuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që në fillim të vitit,

- Bashkitë dhe komunat administrojnë shërbimet e përkujdesjen shoqërore për qendra të përkujdeset që u shërbejnë individëve, banorë të bashkisë ose komunës si dhe shërbimet e përkujdeset për këta individë.

Shpenzimet për këtë qëllim që përballohen me fonde të kushtëzuara nga buxheti i shtetit përfshihen në buxhetin e kushtëzuar të njërive të qeverisjes vendore.

III. SHPENZIMET QË KRYHEN NGA NJESITË E QEVERISJES VENDORE PER LLOGARI TË PUSHTETIT QËNDROR, POR QË NUK JANË SHPENZIME VENDORE DHE NUK MIRATOHEN NË BUXHETIN VENDOR NGA KESHILLI PERKATËS.

Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për QKR.

Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të gjëndjes civile.

DISA ELEMENTË TË SHPENZIMEVE BUXHETORE**• Paga dhe shtesat mbi paga (Artikulli 600)**

Këtu përfshihen shpenzimet për pagën bazë dhe shtesat mbi page. Numri i punonjësve për administratën e njësisë së qeverisjes vendore dhe për personelin e ndërmarrjeve në varësi të njësisë së qeverisjes vendore përcaktohet nga këshilli përkatës i njësisë. Paga bazë sipas klasave dhe shtesat mbi pagë do të përlogariten në bazë të V.K.M Nr. 518 date 16.8.2012 Per disa ndryshime ne vendimin 1619 date 2.7.2008 te Keshillit te Ministrave "Për klasifikimin e funksionëve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organëve të qeverisjes vendore".

Përlogaritja e Fondit te Veçante dhe përdorimi i tij, behet sipas Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 929 Date 17.11.2010 « Mbi krijimin dhe përdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme" ndryshuar me VKM 493 date 63.7.2011 , VKM nr. 826 date 5.12.2011 , VKM 949 date 6.12.2012 .Për kompensimet, do të zbatohet V.K.M Nr. 499, datë 13.08.1998, ndryshuar me V.K.M Nr. 683, datë 28.10.1998.

Sipas VKM Nr. 1619, datë 2.7.2008, këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë shpërbimin mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës, përkatësisht, të kryetarit të këshillit të qarkut, kryetarit të bashkisë, kryetarit të njësisë bashkiake dhe atij të komunës.

Bazuar ne projektligjin " Per buxhetin e vitit 2013" neni 15 : " Bashkitë, që kanë mbi 50 001 banorë, përdorin deri në 15 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ " (Programi 1110 -zeri paga dhe sigurime shoqerore)

• Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Artikulli 601)

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 10070 date 5.2.2009 "Për disa ndryshime të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", do të jetë nga punëdhënësi përkatësisht 16.7 % dhe nga punëmarrësi 11.2 %.

Fondi i pagave mbi të cilin llogaritet kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas: Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është 21 000 leke, ndërsa paga maksimale 105 000 leke.

a. Planifikimi për mallra dhe shërbime të tjera (Artikulli 602)

Planifikimi i shpenzimeve për "Mallra dhe shërbime të tjera" (shpenzime operative) për vitin 2013, do bëhet sipas ndarjes në nënartikuj sipas klasifikimit ekonomik për çdo funksion në veçanti. Për secilin nga zërat e përfshirë në këtë artikull planifikimi i nevojave duhet të mbështetet në normativa sa me të drejta të vendosura nga bashkitë dhe komunat. Ne baze te ligjit 10160 date 15.1.2009 " Per rregullimin e sherbimit te transportit per funksionarët publike dhe nepunesit civil" tabela 2 perfitimi financiar (bonus) mujor per sherbimin e transportit per Kryetarin e Bashkise eshte 45 mije leke ne muaj.

b. Planifikimi për investime (231)

Investimet përballohen nga të ardhurat e veta të njërive të qeverisjes vendore, transferta e pakushtëzuar, si dhe nga buxheti i shtetit. Të gjitha fondet për investime do të menaxhohen sipas procedurave të përcaktuara në:

- o Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik"
- o Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
- o V.K.M Nr. 1, datë 10.01.2007, "Rregullat e prokurimit publik" etj.

1. Fondet e investimeve (230,231) nga grandet prej fondeve të zhvillimit rajonal.

Procedurat e prokurimit të këtyre fondeve kryhen mbi bazën ligjore të cilësuar me lart. Këto procedura fillojnë pas marrjes së shkresës nga Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për akordim fondi sipas destinacionit të përcaktuar. Të gjitha fondet për investime nga granti konkurrues të cilat akordohen nga Ministria e Brendshme prokurohen drejtpërdrejt nga njësia vendore pavarësisht nga vlera.

2. Fonde të tjera për investime

Për fonde të tjera për investime (me burim financimi të ndryshëm) që miratohen nga Ministria e Brendshme do të zbatohet V.K.M Nr. 1, datë 10.01.2007.

3. Investimet që kryhen në njësitë e qeverisjes vendore

Fondet për investime që kryhen në njësitë e qeverisjes vendore kanë si burim financimi të ardhurat e tyre dhe transfertën e pakushtëzuar.

➤ Për Fondin e Kontigjences

Bazuar në Nenin nr.19/7.a.iii të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe nenit 6 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë. Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjences. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara.

Per vitin 2013 është parashikuar një Fond Kontigjence këto fonde janë parashikuar **14 699 mijë leke**.

➤ Per Detyrimin e Keshillit te Qarkut


Ne baze te ligjit nr.8652 date 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Neni 18 njësitet e qeverisjes vendore derdhen një kuote për llogari të Këshillit të Qarkut. Per vitin 2013 është llogaritur shuma prej **7 500 mije leke**.

Tabele Permbledhese e Programeve per vitin 2013

000/leke

EMERTIMI	PLANI 2013
Programi 6260-Sherbime Publike	221757
Programi 4570-Transporti Publik	747
Programi 4530-Infrastruktura rrugore	45662
Programi 6330-Ujsjelles Kanalizime	22915
Programi 8250-Kultura	67771
Programi 8140-Sporti	56202
Programi 9240-Arsimi	79136
Programi 10140-Kujdesi Social	36763
Programi 1110 - Administ. e Bashkise	186048
Programi 4980- Shpenz. te tjera	37727
TOTALI (I-X)	754728

Plani 2013





SHERBIMET PUBLIKE

Pasqyra e shpenzimeve per Sherbimin e Pastrimit te Qytetit.

000/leke

Nr.	Emertimi i Sherbimit	Plani 2012	Realizimi i Pritshem 2012	Plani 2013
1	Paga	1158	1158	1197
2	Sigurime shoqerore	185	185	191
3	Shpenzime operative	106139	96558	96667
	Totali	107482	97901	98055

Sherbimi Pastrimit te Qytetit

Sherbimi pastrimit ne buxhetin 2013 eshte llogaritur 98 055 mije leke e ndare ne dy pjese. Deri me 31 Korrik 2013, kur mbaron kontrata themelore e ketij sherbimi parashikohen 56 667 mije leke sipas preventivit. Diferenca prej 40 000 mije leke parashikohet per periudhen Gusht-Dhjetor si pjese e fondit limit per tenderin e ri. Gjate ketij viti do te kryhen keto sherbime:

- Sherbimi mbledhje e transport mbeturina urbane do te realizohet ne te gjithe qytetin. Cdo dite do te transportohen ne vend-depozitim 550 cope kazane mbetje.
- Nga Sipermarrrja e sherbimit te Pastrimit do te realizohet cdo dite edhe pastrimi i mbeturinave perreth kazaneve duke i sistemuar neper kazane.
- Menaxhimi i kazaneve, duke kryer larjen e tyre, riparimet e rrotave, si dhe lysterjen e tyre nga dentimet, do te realizohet cdo muaj sipas planifikimit.
- Fshirja e rrugeve me mekanike dhe me dorë do te kryhet cdo dite sipas siperfaqeve te hartuara ne grafik, ndersa pjesa tjeter e siperfaqeve te rrugeve do te mirembahet cdo dite nga punonjes te kesaj sipermarrrjeje.
- Larja e rrugeve do te kryhet per 200 dite sipas grafikut te larjes se rrugeve nga 1- 2 here ne dite ne dite. Ky proces pune eshte llogaritur te kryhet deri ne oren 08.00 te mengjesit dhe pas dite pas ores 18.00.
- Menaxhimi i gropes se plehrave. Per periudhen Janar-Korrik 2013 llogaritjet jane bere per depozitim e mbetjeve sipas kontrates themelore 3 km larg Shkodres. Sipermarrrja e pastrimit ka detyrim qe cdo muaj te kryeje mbylljen e gropes me dhera duke mos lejuar ndotjen e ambientit perreth saj nga djegiet e mbeturinave urbane. Detyre kryesore e menaxhimit te mbetjeve mbetet ruajtja dhe sistemimi i tyre , administrimi i mbetjeve me mbulim me dherera sistematikisht me buldozier.
- Ne rast se do te filloje shfrytezimi I landfillit Bushat do te behet ristrukturimi i preventivit per diferencen e transportit dhe koston e menaxhimit te mbetjeve dhe efektet financiare do t'i paraqesim per miratim ne Keshillin e Bashkise.

- Gjate ketij viti do te synojme sensibilizimin qytetar ne menyre sistematike ne bashkepunim me nxenes shkollash, student, administrate, ndermarrje, institucione, organizata te ndryshme. Ky sensibilizim do te konsistoje ne diferencimin e mbetjeve urbane.

Pasqyra e shpenzimeve operative per vitin 2013 ne mije leke.

Nr	Emertimi	Plani 2013	Periudha Janar- 31 Korrik	Periudha Gusht-Dhjetor
1	Shpenzime operative	96667	56667	40000

Pasqyra e shpenzimeve per periudhen 01.01.2013 deri 31.07.2013

Nr	Emertimi i sherbimeve	Njesi	ZONA A			ZONA B		
			Sasia	Çmimi	Vlefte	Sasia	Çmimi	Vlefte
1	Mbledhje, transport i plehrave urbane	kazan	70262	220	15457640	46842	240	11242080
2	Menxhim e mirembajtje kazanesh	kazan	210	7500	157500	140	7000	980000
3	Mbledhje e transport inertesh, plehu voliminoz	m3	1167	702	819234	-	-	-
4	Fshirje manuale te rrugeve (30645m2/dite)	m2	5519058	0.3	1655717	5519058	0.5	2759529
5	Fshirje mekanike te rrugeve (85067m2/dite)	m2	15482240	0.2	3096448	15482240	0.3	4644672
6	Larje te rrugeve (28571m2/dite)	m2	3418572	0.35	1200000	3428572	0.4	1371429
7	Menaxhimi i gropes se plehrave	kazan	-	-	-	93106	26	2420756
		Shuma			23804039			23418466
	T.V.Sh	20%			476080			4683693

					8			
					285648			28102159
					47			
SHUMA TOTALE ZONA A + ZONA B (leke)					56667006			

Objekti i Bashkisë Shkoder për vitin 2013 është modernizimi i shërbimit të pastrimit, të qytetit dhe ofrimi i shërbimit në të gjithë territorin. Mëqenëse në muajin Korrik 2013 përfundon kontrata e këtij shërbimi kërkohej miratimi i fillimit të procedurave për tenderin e ri në afat 5-vjeçar, e ndare në dy zona shërbimi.

Për periudhën 5-mujore Gusht-Dhjetor është parashikuar vlera paraprake prej 40 miliona leke, pasi fondi limit vjetor për tenderin e ri parashikohet 96 miliona leke. Vlera e saktë do të përcaktohet pas hartimit të dokumentacionit teknik-ekonomik dhe nëse ka rritje do të kërkohej miratimi i ndryshimeve në Këshillin bashkiak.

Në kontratën e re synojmë:

- zgjerimin e shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane, fshirjes rrugore, larjen e rrugëve në të gjitha zonat e banuara të qytetit në mbrojtje të shëndetit të banorëve dhe mjedisit, duke përmirësuar menaxhimin dhe monitorimin e këtij shërbimi.
- Kalimin në shkallë të gjere të mbledhjes së diferencuar nëpërmjet shtimit të pikave të grumbullimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me qytetaret dhe operatorët e interesuar.
- Uljen e sasisë së mbetjeve urbane që ndikon direkt në uljen e shpenzimeve të transportit si dhe kostos së depozitimit, nëpërmjet reduktimit të mbetjeve që depozitohen në landfill. Për realizimin e kësaj nisme, Bashkia Shkoder në bashkëpunim me *"dlldp"* dhe *"Cooperacion Zviceran"* po harton një strategji për ndërtimin e një stacioni të ndërmjetëm depozitimi. Ky projekt parashikon ndërtimin e një objekti të përshtatshëm dhe blerjen e agregateve për funksionimin e këtij stacioni përpunimi.
- Është hartuar një plan veprimi me *"Cooperacionin Zviceran"* për të asistuar gjatë 6-mujorit të parë në Bashkinë Shkoder për hartimin e dokumentacionit teknik për tenderin e ri ku përfshihet: Analiza e kostos për zërat e shërbimit të parashikuar, llogaritja e efekteve financiare nga venia në funksionim e stacionit të ndërmjetëm të përpunimit, etj.

2. Shërbimi i Mirembajtjes së Siperfaqeve të Gjellberta

Pasqyra e shpenzimeve për Mirembajtjen e siperfaqeve të gjellberta në mijë leke

Nr	Emërtimi i Shërbimit	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshëm 2012	Plani i vitit 2013
1	Paga	601	601	624
2	Sigurime shoqërore	96	96	100
3	Shpenzime operative	22596	18912	27710
	Totali	23293	19609	28434

Sherbimi i Mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta

Ky sherbim do te kryhet me sipermarrje nga firma fituese e tenderit qe eshte ne procedure ne zbatim te VKB nr. 96, dt. 13.10.2012.

Sipas preventivave dhe analizave te hartuara fondi limit per keto sherbim eshte 27710 mije leke dhe konkretisht sipas pasqyres se meposhtme:

Pasqyra e shpenzimeve: Mirembajtje siperfaqe te gjelberta

Nr.	Emertimi i punimit	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte
1	Mirembajtje Lulishte (me gjithë elementet e saj)	m2	66000	264.658	17467428
2	Prodhim fidana lule sezonale	m2	500	504.691	252346
3	Mirembajtje drure dekorativ (gjelberimi rrugor)	cope	4020	474.661	1908137
4	Mirembajtje shkurre dekorative (rruga M.P.Plaku)	cope	800	244.511	195609
5	Mirembajtje siperfaqe ujore	m2	650	931.556	650511
6	Mirembajtje stola dekorativ	cope	150	2210	331500
7	Mbjellje drure dekorativ	cope	174	10690	1860060
8	Mbjellje shkurre dekorative	cope	100	2327	2232700
9	Mbjellje bordura te gjelberta	ml	100	1592.8	159280
10	Mirembajtje shkurre dekorative ne vazo te medha	cope	250	315	78750
	Shuma				23091321
	TVSH	20%			4618264
	Shuma totale				27709585

Ne preventivat e hartuar per sherbimin e mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta jane parashikuar te kryhen keto sherbime:

- Sherbimi i mirembajtjes se lulishteve do te kryhet ne nje siperfaqe prej 75 mije m2. Meqenese vitet e fundit jane kryer rikonstruksionet e plota te lulishtave me te gjithë elementet e saj ne nje siperfaqe prej 66 mije m2 do te kryhen sherbime intensive ne te gjithë zerat e preventivit. Ne cdo 1000 m2 lulishte perfshihen: bar i kultivuar 450 m2, siperfaqe lulesh 250 m2, siperfaqe rruge ne lulishte 300 m2 si dhe mirembajtje drure dekorativ, shkurre dekorative e bordure te gjelberta. Pervet tyre ne siperfaqet e tjera prej 9 mije m2 qe nuk kane keto elemente do te kryhen sherbime te pjesshme ne mirembajtje.
- Mirembajtje e drureve dekorativ perfshin mirembajtjen e drureve dekorativ te gjelberimit rrugor, vec lulishtave. Ne preventivin e hartuar perfshihen proceset e krasitjes se tyre,

vaditjes, prashitjes si dhe pleherimit per nje zhvillim sa me te mire. Sipas inventarit rezultojne 4020 drure dekorativ ne rruget kryesore te qytetit.

- Mirembajtja e shkurreve dekorative prej 800 cope perfshin mirembajtjen e shkurreve dekorative ne parterin e rruges Mehmet Pashe Plaku.
- Mirembajtje siperfaqe ujore prej 650 m² perfshihen punimet e mirembajtjes se shatervanit ne lulishten e Parruces dhe shatervani Sheshi Demokracia. Punimet qe perfshihen jane pastrami dhe larja e tyre cdo muaj, si dhe riparimi I pompave dhe elektropompave ne raste te difekteve.
- Mbjellja e drureve, shkurreve dhe bordurave te gjelberta do te kryhen kryesisht per zevendesimin e tyre nga tharjet ne lulishta si dhe per plotesim te gjelberimit rrugor.
- Mirembajtje shkurre dekorative cope 250 ne vazo te medha. Keto ndodhen ne hyrjen e qytetit tone si dhe ne Pedonalen e Piacet. Eshte llogaritur ne preventive prashitja, vaditja, mirembajtja e vazove si dhe ndonje zevendesim ne rast tharjeje.

Ne buxhet eshte llogaritur fondi limit prej 27710 mije leke, por me perfundimin e procedures se tenderimit dhe lidhjen e kontrates me operatorin fitues, vlera e mbetur nga konkurrimi do te rialokohet.

3. Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike dhe Deshmoreve

Pasqyra e shpenzimeve te varrezave ne mije leke

Nr	Emertim	Plani i vitit 2012	Realizimi i Pritshem 2012	Plani i vitit 2013
1	Paga	130	130	130
2	Sigurime shoqerore	21	21	21
3	Shpenzime operative	4400	4400	4400
	Totali	4551	4551	4551

Sherbimi i mirembajtjes se Varrezave Publike e Deshmoreve

Realizimi I ketij sherbimi do te kryhet ne perputhje me preventivat e hartuar per cdo proces pune. Fondi eshte parashikuar per te kryer sherbimet deri me 30 Qershor 2013, pasi mbas kcsaj date mbaron edhe kontrata themelore me sipermarresin.

Pasqyra e shpenzimeve operative per vitin 2013, ne mije leke

Nr	Emertimi	Plani 2013	Periudha 6-mujori I	Periudha 6-mujori II
1	Shpenzime operative	4400	2200	2200

Pasqyra e shpenzimeve per periudhen 01.01.2013 deri 30.06.2013

Nr	Emertim i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Pastrim parcelash e rruge te brendshme ndermjet blloqeve	000/m2	143.833	4612.63	663449
2	Mirembajtje drure dekorative e shkurre	000/cope	2.157	13891	29963
3	Mbjellje drure dekorative (selvi)	cope	50	4090	204500
4	Mirembajtje e krijim gardhe te gjelberta me rozmarine dhe levantine	000/ml	4.091	31839	130254
5	Kositje, grumbullim e transport bari	000/m2	113.15	854.36	96671
6	Mirembajtje bordura te brendshme betoni konturuese te parcelave	000/ml	544	52.5	28560
7	Lyerja me gelqere e brodurave te rrugeve dhe varrezave provizore (2 here ne vit)	m2	3500	43.65	152780
8	Zevendesim bordura, varre provizore	cope	50	1280	64000
9	Roje ne varrezat publike dhe Deshmoreve	lek	-	-	425957
10	Mirembajtje e varrezave te deshmoreve	000/m2	33.6	500	16800
11	Mirembajtje e varrezave te deshmoreve nga amortizimi	varre	68	300	20400
	SHUMA	lek			1833334
	T.V.SH	20%			366668
	TOTALI	lek			2200002

Sipas pasqyres se shpenzimeve te mesiperme, sherbimet ne mirembajtjen e Varrezave Publike e Deshmoreve perfundojne ne 6-mujorin e pare te viti 2013, prandaj kerkojme miratimin e fillimit te procedurave per tenderin e ri me afat 5-vjecar.

Per 6-mujorin e dyle eshte parashikuar fondi prej 2200 mije leke. Pas hartimit te dokumentacionit tekniko-ekonomik per tenderin e ri, do te percaktohet vlera reale e fondit limit. Nese vlera e parashikuar prej 2200 mije leke nuk i pergjigjet koston reale, do t'i drejtohem Keshillit Bashkiak per miratimin e differences.

Me gjithë punen e mire qe po kryhet ne mirembajtjen e varrezave publike dhe te Deshmoreve, per nje ecuri me te mire te ketij sherbimi per vitin 2013 kerkohet shpronesimi i parcelave te planifikuara si dhe ndertimi i parcelave te reja per te mos krijuar probleme per vendet e varrimit ne dy vitet e ardhshme, pune e cila po ndiqet sistematikisht nga Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria e Urbanistikes.

4. Mirembajtje rruge e trotuare ne qytet

Pasqyra e shpenzimeve ne mirembajtje rruge e trotuare ne mije leke

Nr.	Emertimi i sherbimeve	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshem 2012	Plani i vitit 2013
1	Shpenzime operative	8380	8380	7500

Mirembajtje e rrugeve dhe trotuareve qytet

Per vitin 2013 me VKB Nr. 97, dt. 30.10.2012 eshte miratuar fillimi i procedurave te prokurimit per objektin "Mirembajtje e rrugeve dhe trotuareve qytet" me fond limit prej 7500 mije leke.

Me kete vlere po hartohen preventivat dhe dokumentacioni teknik me te cilin do te zhvillohet tenderi dhe vlere fituese do te jete plani real i buxhetit per vitin 2013.

Gjate vitit 2013 do te punohet ne riparimin e rrugeve te demtuara me teper qe kane krijuar gropa te vogla ose qe eshte demtuar shtresa e asfalto-betonit. Ne keto raste do te nderhyhet ne mbylljen e gropave me te gjitha nenshtresat e shtresat asfaltike, si dhe ne riveshjen e nje pjese te rrugeve te demtuara si shtrese punuese.

Nje vemendje te vecante do t'i kushtohet edhe riparimit te trotuareve. Kryesisht do te nderhyhet ne trotualet qe kane amortizim me te madh ose qe kane pesuar demtime ose shembje te tyre.

Po ashtu do te punohet ne riparime te pusetave te demtuara ne rruge, pasi kemi shume demtime te tyre, duke krijuar veshtiresi ne levizjet e mjeteve.

5. Mirembajtje KUB

Pasqyra e shpenzimeve ne mirembajtje KUB ne mije leke

Nr	Emertimi i sherbimit	Plan 2012	Realizimi i pritshem 2012	Plani i vitit 2013
1	Paga	7608	7154	3989
2	Sigurime Shoqerore	1210	1142	635
3	Mallra e Sherbime te tjera	6362	6362	3000
4	Trans. Buxh. Familjare & Individ	120	33	30
5	SHUMA	15300	14691	7654

Mirembajtje e KUB

Per vitin 2013 per sherbimin e mirembajtjes se sektorit te KUB, parashikojme perballimin e shpenzimeve per paga, sigurime e shtesa si dhe shpenzime operative per 6-mujorin e pare te vitit. Fondi i parashikuar eshte ne vleren **7 654 mije lek**.

a) Plani ne zerin paga, sigurime e shtesa:

Per 6 mujorin e pare te vitit 2013 parashikojme paga 3989 mije leke, sigurime shoqerore 635 mije leke, transferte buxhet familjare/individ 30 mije leke

b) Plani ne zerin "Shpenzime Operative" 3000 mije leke e ndare:

- Zeri "Materiale dhe sherbime speciale"	ne shumen	1600 mije leke
- Zeri "Sherbime transporti"	ne shumen	1390 mije leke
- Zeri "Shpenzime udhetimi"	ne shumen	10 mije leke

Per 6 mujorin e I-re te vitit 2013 eshte bere nje detajim i plote i shpenzimeve sipas qellimit dhe destinacionit per cdo objekt dhe ne vecanti per nevojat emergjente per nderhyrje. Te gjitha keto jane te shoqeruara me analizat e kostove duke i ndare vec shpenzimet direkte te sherbimit dhe ato indirekte. Gjate 6 mujorit te pare SH.A Ujesjelles-Kanalizime duhet te kryeje studimin per perballimin e shpenzimeve te 6 mujorit te dyte nga burimet financiare te ndermarrjes.

Ne totalin e shpenzimeve operative nje vend te rendesishem zene shpenzimet e transportit. Sektori KUB ka ne inventarin e saj disa mjete transporti dhe mjete te specializuara sherbimi mjaft te amortizuara per shkak te vjetersise, te cilat kerkojne shpenzime relativisht te larta per mirembajtje e riparime si dhe konsum per vajra e karburante.

7. Ndricim rrugor

Pasqyra e shpenzimeve per ndricimin rrugor ne mije leke.

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Plani i vitit 2012	Realizimi i pritshem 2012	Plani i vitit 2013
600	Paga	1886	1886	3952
601	Sigurime shoqerore	300	300	629
602	Shpenzime operative	37200	37200	43130
606	Kompens.punonjesish			24
	Totali	39386	39386	47735

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR SHËRBIMIN E NDRIÇIMIT PUBLIK PËR VITIN 2013:

1. Pagat dhe Sigurimet Shoqërore :

Për Pagat janë parashikuar **3952 mije lekë** dhe për Sigurimet Shoqërore **629 mije lekë** dhe kompensime punonjesish **24 mije leke**. Gjithsej **4 605 mije leke**.

2. Shpenzimet Operative:

Këto shpenzime, do të kryhen: a) për "Materiale e shërbime speciale" e që do të përfshijnë shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të Ndriçimit Rrugor të qytetit; b) për "Shërbime" që përfshijnë shpenzimet për pagesat e energjisë elektrike të rrjetit elektrik të këtij ndriçimi.

a) "Materiale e shërbime speciale" Keto shpenzime janë në vartësi direkt nga madhësia e sipërfaqes së rrugëve të ndriçuara që do të mirëmbahen gjatë vitit. Kjo sipërfaqe gjatë vitit 2013

do të jetë 531 000 m² (507 00 m² rrugë e 24 000 m² lulishte) rreth 9% më e madhe meqenëse kemi një rritje të rrugeve të reja të ndricuara. Elementë të veçantë të infrastrukturës së ndriçimit, si llampa, lëshues, rele etj. kanë një jetëgjatësi të kufizuar dhe pas 4-5 vjet pune kanë nevojë të zëvendësohen.

Nisur nga eksperiencia e viteve të kaluara është bërë detajimi i nevojave për pjesë elektrike për mirëmbajtjen ku kerkohen 2 630 mijë lekë, dhe duke ju referuar sipërfaqes së ndriçuar prej 531 000 m², del një kosto prej 4,9 lek/m².

b) "Shërbime". Shpenzimi për energjinë elektrike për vitin 2013, do të rritet me 9 % meqenëse, do të kemi një rritje konsumi energjie si rezultat i investimeve të kryera gjatë vitit 2012. Keto investime janë realizuar në vitin 2012 në objektet: Bllokun ish-lekurave, Blloku i pallateve Bulevardi Zogu I, Blloku Vau Dejes – Lopcej, Rruga Gjuhadol (ndricim tokesor dhe ajror), Ndricim 8 rrugë dytesore (te cilat janë në procedure), Segment i rruges 13 Dhjetori. Për shpenzimet për pagesën e energjisë elektrike të rrjetit të ndricimit për vitin 2013, nevojiten 2 500 000 Kh/vit ose 42 600 mijë leke (me T.V.Sh) Ky parashikim është bërë për një furnizim të rregullt me një mesatare vjetore 10.5 orë në natë.

Nga eksperiencia e viteve të kaluar, për shkak të ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike nga C.E.Z. Shpërndarja Sh.a. dhe difekteve të ndryshëm e dëmtimeve të linjave, një shpenzim i tillë pritët të jetë rreth 5 % më i vogël, prandaj kërkojme të miratohet shuma 40 500 mijë lekë për pagesat e faturave të energjisë elektrike.

Shpenzimet operative,(a + b), do të jenë (2 630 000+ 40 500 000) leke. Gjithsej **43 130 mijë leke.**

Për këtë shërbim (1+2), janë parashikuar (4 605 000 + 43 130 000) lekë. Gjithsej **47 735 mijë leke.**

10. Sinjalistike – Dekor

Pasqyra e shpenzimeve për sinjalistike - dekor në mijë leke

Nr.	Emertimi i shpenzimit	Plani i vitit 2012	Realizimi i Pritshëm 2012	Plani 2013
600	Paga	750	750	750
601	Sigurime Shoqërore	120	120	120
602	Shpenzime operative	2934	2934	2860
	Shuma	3804	3804	3730

**SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR SHËRBIMIN E SINJALISTIKES DHE
DEKORIT PËR VITIN 2013****1. Pagat dhe Sigurimet Shoqërore:**

Për Pagat janë parashikuar **750 mijë lekë** dhe për Sigurimet Shoqërore parashikohen **120 mijë lekë**. Gjithsej **870 mijë leke**.

2. Shpenzimet Operative.*a. Blerje materiale per sinjalistiken*

(horizontale + vertikale) janë parashikuar **2 280 mijë leke**.

- Për sinjalistikën horizontale parashikojmë 1 920 mijë leke për vijëzime, me një cikël lëvizjeje, që i përkët gjatësisë prej 29 km të 41 rrugëve të qytetit, detajimi i të cilave tashmë është bërë; vijëzime këmbësorësh, korsitë bicikletash dhe vendqëndrime autobusësh urban. Për to do të përdoren rreth 3100 kg bojë rrugore dhe 600 kg shkrirës bojë.

- Për sinjalistikën vertikale 360 mijë leke ku do të kryehen shpenzimet për blerjen e 70 tabelave të ndryshme rrugore dhe një sasi tuba antirrotativ mbajtës tabelash. Specifikimet e tabelave bëhen në momentin e azhurnimit të rrugëve dhe të porosisë.

b. Për dekorin e qytetit janë parashikuar gjithsej 580 mijë leke të ndara:

- Blerje aksesoriesh dekori për festat e fundit të vitit 480 mijë leke.
- Blerje bredha për zbukurim 100 mijë leke

Shpenzimet operative parashikohen (a+b) **2 860 mijë lekë**.

Gjithsej, për këtë shërbim (1+2) janë parashikuar **3 730 mijë lekë**.

11. Mobiliteti (lëvizshmëria urbane)

Për këtë vit, do të vazhdojnë të hidhen hapa të mëtejshëm mbi përmirësimin e qarkullimit në qytet. Ku fokusi kryesor do të jetë mbi menyrat e shëndetshme dhe të pastra të qarkullimit në qytet, si ecja në këmbë, pedalimi, transporti urban.

Do të kryhen fushata sensibilizuese si:

- "Dita e Bicikletës"
- "Java Europiane e Mobilitetit"
- Prodhimi i posterave dhe broshurave me qëllim promovimin e mëtejshëm të pedalimit, por edhe mbi kujdesin në rrugë nga shoferat.
- Si dhe rritja e cilësisë në shërbimin e transportit urban

Modernizimi i infrastrukurës së pedalimit do të jetë prioritet.

Krijimi i pistave ku mendohet se qarkullimi i makinave krijon rrezikshmëri për pedaluesit
Vendosje të parkimeve për bicikleta

12. Transporti urban

Me VKB nr 58, date 29.06.2012 "Per ngritjen e strukture qe do te merret me administrimin e shoqerise Parku i Udhetareve Shkoder S.H.A" i ndryshuar me VKB nr. 93 date 30.10.2012 ka kryer funksionet kjo strukture. Afati i kryerjes se veprimtarise se saj eshte data 31.12.2012. Meqe procesi i likuidimit te ndermarrjes nuk ka perfunduar akoma dhe sipas parashikimeve per kryerjen e transferimit te asetave ky proces do te zgjase rreth 3 muaj kerkojme miratimin e shpenzimeve per kete periudhe duke ruajtur te njejten strukture dhe te njejtin nivel shpenzimesh mujore.

Nr	Emertimi	Nr. punonjes	Klasa Arsimit larte	Paga sipas pozicionit 000/leke	Shtese diplome 000/leke	Paga arsim mesem 000/leke
1	Drejtor	1	II-b	40	14	---
2	Ek. Finance	1	III-b	30	14	---
3	Rojc objekti	4	---	---	---	22
	Totali	6	---	---	---	---

Shpenzimet per kete periudhe jane detajuar:

- Fondi i pagave 600 mije leke
- Fondi i sigurimeve shoqerore 102 mije leke
- Shpenz. Oper. mujore:
- Shuma Shpenzime operative 45 mije leke
 - a. (telefon+energji) 10 mije leke x 3
 - b. Karburant 5 mije leke x 3

TOTAL (Paga, sig. Shoqerore, shpenzime operative)

747 mije leke

Ky fond do ti transferohet "Parkut te udhetareve Shkoder SH.A" nga zeri i transferimeve te brendshme sipas kushteve te akt marreveshjes per priudhen 1 Janar-31 Mars 2013.

Ne mbeshtetje te Udhhezimit te perbashket te Ministrise se Financave Nr.666/3 , Ministrise se Transporteve Nr. 360/3 dhe Pushteti Lokal dhe Decentralizimit Nr.1663,date 27.03.2000 ,"Per kriteret dhe procedurat e subvencionit te transportit urban", Akt-Marreveshjes se nenshkruar ne mes te Bashkise dhe operatorit,firma "ERGYS MS 2010" eshte hartuar edhe kerkesa per subvencionin e transportit urban per qytetin e Shkodres .

Menyra e funksionimit te linjave do te jete sipas miratimit te bere nga Keshilli Bashkiak si per stacionet, frekuencat, oraret,dukje lene te hapur edhe mundesine e permiresimeve te metejshme,per plotesimin sa me te mire te nevojave te komunitetit.

Po ashtu duke pare edhe evidencat dhe situacionet te cilat operatori sjell periodikisht sipas akt-marreveshjes se perbashket,si dhe te monitorimeve te kryera vihet re qe shpenzimet nuk perballohen nga te ardhurat e grumbulluara gjate punes per kryerjen e ketij sherbimi.

Subvencioni per operatorin sipermarres te transportit urban

Duke patur parasysh se ka kategori te ndryshme qe perfitojne udhetim falas,si veterane,te semure paraplegjike,invalidet, etj (numri i te cileve eshte i konsiderueshem ne shkalle rrethi) si dhe duke nxjerre te dhena nga monitorimi i kryer gjate kesaj periudhe eshte vene re qe çdo dite udhetojne shume persona qe per nje vit vlera qe duhet te perballohet nga bashkia eshte akoma ne studim Po bejme perpjekje te identifikojme qarte referencat ligjore per te realizuar nje subvencion social te mbeshtetur ligjerisht dhe te argumentuar sakte me numer personash ne qarkullim me sherbimin urban.Ky material do te paraqitet per miratim ne shkurt - mars 2013. Efektet financiare sipas nevojës do te perballohen me ristrukturimin e buxhetit.

INVESTIME TE VITIT 2013 FONDET E VETA

Nr.	Emertimi i projektit/sherbimit	Plani vitit 2013 mije/leke
	INVESTIME TOTALI	88.493
I	Programi 6260	37.192
1	Shtese kon. Sistemim blloku i pallateve Vau i Dejes Lopçej	1.508
2	Shtese kon. Sistemim blloku i pallateve Qaf hardhi	711
4	Restaurim i fasadave Gjuhadol	3.000
5	Restaurim fasada rruga 13 Dhjetori e 28 Nentori	7.000
6	Blerje shina metalike Zyra me nje ndalese	480
7	Rikonstruksion fasada e hyrjes se pasme te Bashkise	480
8	Blerje tabela informacioni	300
9	Ndertim linja elektrike per aktivitetet rruga Kol Idromeno	230
10	Proj."Aplikim punime silvikulture ne pyje artiçic." (borxhe)	3.483
11	Shpronsime	20.000
II	Programi 4530	35.302
1	Rikonstruksion rruga Musa Luli (borxhe)	9.109
2	Sistemim trotuare rruga "Fahri Ramadani"(Mbik+Kol) (borxhe)	42
3	Riveshje asfalti e ndert. Trot. Rr.Industrial 1 qyteti Shkoder(Mbik+kol) (borxhe)	652
4	Rik.rruga Zooteknike -shtepia bujqeve(Mbik+ Kol) (borxhe)	1.270
5	Rikonstruksion i rruges se kalase(Mbik+Kol) (borxhe)	930
6	Rikonstruksion rruga "Karvanej" (borxhe)	1.278
7	Rikonstruksion rruga "30 Korriku" (borxhe)	2.000
8	5% garanci "Ndertim trotuare Don Bosko" (borxhe)	21
9	Rikonstruksion rruge dytesore	20.000
III	Programi 6330	15.261
1	KUB dalje ne lumin Kir + dalje Nr.2	15.261
IV	Programi 9240	592
1	Rik.Shkolla e mesme e pergj."28 Nentori"(Mbik+ Kol) (borxhe)	592
V	Programi 8140	146
1	Rik.kendi sport.prane spitalit(ish fab.lekur-kepucceve)(Mbik+Kol) (borxhe)	146

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE 2013

Programet		Vlera 000/leke	Pershkrimi
Totali programeve		286.899	
PROGRAMI 6260	Emertimi	Vlera 000/leke	Pershkrimi
	Pastrimi i qytetit	98.055	Perfshihen paga, sigurime e shpenzime per kete sherbim. Sherbimi pastrimit ne buxhetin 2013 eshte llogaritur 98 055 mije leke e ndare ne dy pjese. Deri me 31 Korrik 2013, kur mbaron kontrata themelore e ketij sherbimi parashikohen 56 667 mije leke sipas preventivit. Diferenca prej 40 000 mije leke parashikohet per periudhen Gusht-Dhjetor si pjese e fondit limit qe parashikohet te jete 96 000 mije leke ne vit per tenderin e ri me afat 5-vjecar.
	Sherbimi i Mirembajtjes se Siperfaqeve te Gjelberta	28.434	Perfshihen paga, sigurime dhe shpenzimet per mirembajtjen e siperfaqeve te gjelberta. Ky sherbim do te kryhet me siper marrje nga firma fituese e tenderit qe eshte ne procedure ne zbatim te VKB nr. 96, dt. 13.10.2012. Ne kete sherbim perfshihen 75.000 m2 lulishte dhe 4020 peme ne gjelberimin rrugor.
	Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike dhe Deshmoreve	4.551	Perfshihen paga, sigurime dhe shpenzimet per mirembajtjen e varrezave publike dhe te deshmoreve nga te cilet shpenzimet vetem per mirembajtje jane 4400 mije leke. Realizimi I ketij sherbimi do te kryhet ne perputhje me preventivat e hartuar per cdo proces pune. Fondi i mirembajtjes prej 2200 mije leke eshte parashikuar per te kryer sherbimet deri me 30 Qershor 2013. Pas kesaj date mbaron edhe kontrata themelore me sipermarresin. Per 6-mujorin e dyle eshte parashikuar fond per mirembajtje prej 2200 mije leke pasi per tenderin e ri me afat 5-vjecar parashikohet fondi limit prej 4400 mije leke ne vit.
	Mirembajtje rruge e trotuare ne qytet	7.500	Perfshihen shpenzimet per mirembajtje rruge e trotuare Per vitin 2013 me VKB Nr. 97, dt. 30.10.2012 eshte miratuar fillimi i procedurave te prokurimit per objektin "Mirembajtje e rrugeve dhe trotuareve qytet" me fond limit prej 7500 mije leke.

		Me kete vlere po hartohen preventivat dhe dokumentacioni teknik me te cilin do te zhvillohet tenderi.
Ndricim rrugor	47.735	Perfshihen shpenzimet per paga, sigurime dhe shpenzime operative. Shpenzime per paga dhe sigurime jane 4605 mije leke. Shpenzimet operative: pagesat e faturave te energjise elektrike jane parashikuar ne rritje prej 4% si rezultat i investimeve te kryera ne vitin 2012 ne shumen 40500 mije leke; mirembajtjen e rrjetit ne shumen 2630 mije leke. Me keto shpenzime parashikohet sigurimi i bazes materiale te nevojshme te rrjetit te ndricimit rrugor qe tashme mbulon 95% te rrugeve te qytetit.
Sinjalistike Dekor	3.730	Perfshihen shpenzimet per paga & sigurime 870 mije leke dhe shpenzime operative te ndara: -Për sinjalistikën horizontale parashikojmë 1920 mije leke per vijëzime, me një cikël lysterjeje, prej 63 km, që i përket gjatësisë prej 29 km të 41 rrugëve të qytetit. - Për sinjalistikën vertikale 360 mije leke ku do te kryhen shpenzimet per blerjen e 70 tabelave te ndryshme rrugore dhe nje sasi tuba antirrotativ mbajtes tabelash. Per dekorin e qytetit jane parashikuar gjithsejt 580 mije leke me te cilat do te realizohen: - blerje aksesoresh dekori per festat e fundit te vitit 480 mije leke dhe blerje bredha per zbukurim 100 mije leke
Transporti urban	747	Perfshihen shpenzimet per paga, sigurime dhe shpenzime operative. Me VKB nr 58, date 29.06.2012 "Per ngritjen e strukture qe do te merret me administrimin e shoqerise Parku i Udhetaresve Shkoder SH.A" i ndryshuar me VKB nr. 93 date 30.10.2012 eshte aprovuar vazhdimi i funksionimit te kesaj strukture deri me 31.12.2012. Meqe procesi i likuidimit te ndermarrjes nuk ka perfunduar akoma dhe sipas parashikimeve per kryerjen e transferimit te aseteve ky proces do te zgjase rreth 3 muaj shpenzimet per kete periudhe do te jene 3 muaj duke ruajtur te njejten strukture.

Investime	37.192	Perfshihen investime ne infrastrukture per sistemimin blloqeve te banimit, objekte ne vazhdim per permiresimin e mjedisit , kthimin ne identitet te objekteve te trashigimise kulturore nepermjet restaurimit te fasadave si dhe disa objekte per permiresimin e sherbimeve publike, permiresimin e varrezave te deshmoreve. Ne kete program perfshihen gjithashtu dhe 20,000 mije leke per shpronsime te disa siperfaqeve ku do te realizohen investime publike. Shtese kon. Sistemim blloku i pallateve Vau i Dejës Lopçej 1,508 mije leke, Shtese kontrate Sistemim blloku i pallateve Qafhardhi 711 mije leke, Restaurim i fasadave Gjuhadol 3,000 mije leke, Restaurim fasada rruga 13 Dhjetori e 28 Nentori 7,000 mije lek, Blerje shina metalike Zyra me nje ndalese 480 mije leke, Rikonstrukcion fasada e hyrjes se pasme te Bashkise 480 mije leke, Blerje tabela informacioni 300 mije leke, Ndertim linja elektrike per aktivitete rruga Kol Idromeno 230 mije leke, Proj."Aplikim punime silvikulture ne pyje artific." (borxhe) 3,483 mije leke.
Shuma	227.944	

PROGRAMI 4530	Emertimi	Vlera 000/leke	Pershkrimi
	Investime	35.302	Perfshihen investime ne infrastrukture, ku 20,000 mije leke jane parashikuar per rikonstruksionin e rrugeve dytesore, hapësirave midis pallateve, sipas prioriteteve. Kelo investime do te harmonizohen me investimet qe po realizon Ujesjelles-Kanalizime SH.A nepermjet bankes gjermane KFW per rehabilitimin e rrjetit te ujesjellesit dhe kanalizimeve te ujrave te zeza. Pjesa tjeter e financimit e ketij programi prej 15302 mije leke perbehet nga detyrime te prapambetura (borxhe) ne zbatim, mbikqyerje e kolaudim punimesh per objektet e perfunduara: Rikonstruksion rruga Musa Luli (borxhe) 9,109 mije leke; Sistemim trotuare rruga "F. Ramadani" (borxhe mbikq+kolaud) 42 mije leke; Riveshje asfalti e ndertim trotuar Rr. Zone Industriale 1 (borxhe mbikq+kolaud) 652 mije leke; Rik.rruga Zooteknike -shtepia bujqeve (borxhe mbikq+ kolaud) 1,270 mije leke Rikonstruksion i rruges se kalase(borxhe mbikq+kolaud) 930 mije leke Rikonstruksion rruga "Karvanej" (borxhe) 1,278 mije leke Rikonstruksion rruga "30 Korriku" (borxhe) 2,000 mije leke Ndertim trotuare Don Bosko (borxhe 5% garanci) 21 mije leke
	Shuma	35.302	

PROGRAMI 6330	Emertimi	Vlera 000/leke	Pershkrimi
	Mirembajtje KUB	7.654	Perfshihen shpenzimet per paga, sigurime shoqerore e shpenzime operative per 6-mujorin e I-re per sektorin KUB te ndermarrjes Ujesjelles kanalizime sh.a. Plani ne zcrin "Shpenzime Operative" parashikon 3,000 mije leke te ndare ne zera: "Materiale dhe sherbime speciale" ne shumen 1600 mije leke; "Sherbime transporti" ne shumen 1390 mije leke; "Shpenzime udhetimi" ne shumen 10 mije leke. Per 6-mujorin e dyte 2013 UK SH.A do te kryeje nje studim per funksionimin e ketij aktiviteti me shpenzimet e veta.
	Investime	15.261	Perfshihen shpenzimet per realizimin e grykederdhjeve kryesore te kolektoreve te ujrave te bardha. Ky investim siguron shkarkimin e ujrave te bardha te zones industriale dhe te unazes lindore te qytetit ne lumin Kir.
	Shuma	22.915	
PROGRAMI 9240	Emertimi	Vlera 000/leke	Pershkrimi
	Investime	592	Perfshihen shpenzimet per mbikqyerje e kolaudim te objektit "Rikonstruksion shkolla e mesme "28 Nentori"" (Borxhe) Ne fondin e programuar per realizimin e ketij objekti kane qene te perfshira vetem punimet e zbatimit, ndersa mbikqyerja dhe kolaudimi eshte detyrim i Bashkise.
	Shuma	592	

INVESTIME NGA DONATORET**FURNIZIMI ME UJE dhe SISTEMI I KANALIZIMEVE te KUZ.***Projekti "Furnizimi me uje dhe mbrojtja ambientale e Liqenit te Shkodres"*

Ne kete vit vazhdon zbatimi i Projektit "Furnizimi me uje dhe mbrojtja ambientale e Liqenit te Shkodres" bashkefinansim i tre donatoreve dhe me pjesmarrjen e Qeverise Shqiptare ne shumet perkatese :

- Qeveria Gjermane nepermjet KFW	7.5 milion Euro
- Qeveria Zvicrane nepermjet SECO	7.5 milion Euro
- Qeveria Austriake nepermjet ADA	1.9 milion Euro
- Qeveria Shqiptare	0.5 milion Euro

Ajo çfare eshte e rendesishme per tu theksuar ne kete projekt pervecse ne sistemin e ujesjellesit, nje vlere te konsiderueshme zene investimet rehabilituese ne sistemin KUZ ne Stacionin e pompave ,kolektoret kryesore si dhe rrjetet terciare e sekondare.

Objekte ne vazhdim*- Ne Sektorin e Ujerve te Zeza .*

- 1.Rehabilitimi dhe ndertimi i Linjes se Re te K.U.Z. Afati viti 2011 - Korrik 2013
- 2 .Rehabilitimi i kanaleve te demtuar dhe pusetave perfshire kapaket.
Afati viti 2011 - Korrik 2013
3. Ndertimi i kolektoreve te ujrave te perdorura ne Dobrac.
Afati viti 2011- korrik 2013
4. Ndertim Impianti Trajtimit te KUZ.ne Shiroke Afati viti 2011- Mars 2013
5. Rehabilitimi i Stacionit te Pompave te Ujrave te Perdorura.
Afati viti 2011 - Korrik 2013

- Ne Sektorin e UJESJELLESIT

- 1.Ndertim i Rezervuarit te ri. 1000 m3 Afati viti 2011 - Korrik 2013
- 2.Instal.+ rakorderi i Matesave te Medhenj ne Depot e ujit. Afati viti 2011 - Korrik 2013
- 3.Rehabilitimi i Rrjetit te Furnizimit me Uje. Afati viti 2011 - Korrik 2013
- 4.Furnizim dhe instalim i sistemit SCADA. Afati viti 2011 - Korrik 2013
- 5.Furnizim dhe vendosje te matesave te ujit ne lidhjet e shtepive.
Afati viti 2012 - Nentor 2014

Siç shihet nga te dhenat e pasqyruara me lart ne vitin 2013 perfundon zbatimi i punimeve te fazes se pare te projektit , nepermjet te cilave qytetaret Shkodrane do te perftojne permiresim te ndjeshëm te sherbimeve kryesore jetike si furnizimi me uje dhe largimi i ujrave te perdorura.

Investime ne infrastrukture rrugore

1. Ndertimi i by-pass me vlere **1,902,000 mije leke** veper e rendesishme jo vetem ne infrastrukture por edhe ne mbrojtjen e qytetit nga permbytjet
2. Rikonstrukcion i rruges Zona Industriale nr. 1 me vlere **46,000 mije leke**. Kane perfunduar infrastruktura nentokesore, po punohet per trotuaret dhe shiresat ne trupin e rruges.



PLANIFIKIMI URBAN

Per vitin 2013 Vlera e tarifes qe parashikojme te mblidhet ne lidhje me Ndikimin ne Infrastruktura parashikojme te jete ne masen **50 milion leke**. Ky parashikim vjen si analize e situates ndertimore ne qytetin e Shkodres , dhe njekohesisht si faze e pare e fillimit te punes me Planin e ri vendor i cili do te hyje ne fuqi ne kuader te ligjit te ri " Per Planifikimin e Territorit"

Politika e Bashkise ne funksion te se ciles ka kryer veprimtarine e vet edhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit te Territorit , ka qene e mbeshtetur ne parimin baze qe : asnje Planifikim Urban modern nuk mund te jete i tille kur nuk merr ne konsiderate lidhjen e ngushte midis manaxherit te zhvillimit urban qe aktualisht eshte Bashkia dhe te gjithe aktoret e tjere dhe klienteve te tij.

Buxheti i vitit 2013 është një program konservativ në drejtim të një përpjekje për të dhënë një kontribut të çmuar në stabilitetin ekonomik të qytetit , përmes miradministrimit te financave publike. Një maturi e qeverisjes lokale për të programuar jo me rezerva, por nisur dhe nga pritshmëritë jo fort pozitive që do të kemi ne kete periudhe, hartojme nje buxhet te qendrueshem dhe me vlera ne investime.

Departamentit te Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit do të jete i orientuar profesionalisht drejt mobilizimit dhe punes me eficence, efikasitet, transparence dhe integritet, ne perputhje me politiken dhe prioritetet e Programit te Zhvillimit Strategjik te Bashkise, Planit te Pergjithshem Territorial vendor si edhe te gjithe Politikes se zhvillimit te qytetit te Shkodres.

Per vitin 2013 PROGRAMET ku parashikojme te nderhyjme gjithnje ne funksion te plotikes se Bashkise dhe Programit strategjik jane:

Kodi i titullit	PROGRAMI	Vlera ne leke	Pershkrimi
4530	Menaxhimi i transportit rrugor	2.860.000	Ne kete program perfshihet hartimi i projektit te zbatimit te ndertimit te nenkalimit ne shshi " Nene Tereza".
9240	Aresim i mesem (profesional)	200.000	Ne kete program perfshihen hartimi i projekteve dhe pershtatje e ekzistuesve per objektet arsimore.
6140	Urbanistika vendore	280.000	Ne kete program perfshihen hartimi i projekteve per infrastrukturen rrugore.
6260	Sherbime publike vendore	2.060.000	Ne kete ze perfshihen studim-projektime te cilat perfshijne projekte te ndricimeve publike, tregjeve publike etj.
	TOTAL	5.400.000	

- Hartimi i projektit te zbatimit ndertimin e nenkalimit ne Sheshi " Nene Tereza" Vlera e perafert e preventivit 100 milion leke. Vlera e projekt – preventivit te zbatimit **2.860.000** leke.
- Studim projektim " Ndricim objekte publike" vlera **480.000** leke.
- Hartim projekte infrastrukture dhe objektesh arsimore sipas kerkese per investime ne vleren **480.000** leke. Ketu perfshihen pervec nevojave epr projekte te reja edhe pershtatja e projekteve ekzistuese me kushtet e reja dhe nevojat per investime si ne objektet shkollore ashtu edhe ne infrastrukture.
- Hartim i Plan Biznesit per funksionimin e tregjeve ne qytet. (Tregu i fushes , tek ish parku i autobuseve , tek ish fabrika e tulles etj) **480.000** leke
- Hartimi i projekt zbatimit te Projektit te Tregut tek fusha (aktualisht ekziston Projekt-idca c ketij tregu) vlera e projektit **1.100.000** lek vlera e investimit te parashikuar 20.000.000 leke.



DREJTORIA ARSIMIT, KULTURES, RINISE DHE SPORTEVE

ZYRA E ARSIMIT

Planifikon dhe detajon te gjitha shpenzimet per institucionet e arsimit baze dhe QKF te cilat mbulohen nga fondet buxhetore te deleguara nga MASH si dhe nga buxheti i krijuar nga te ardhurat e Bashkise. Gjithsej trajtohen institucionet e arsimit baze si me poshte:

- Shkolla te mesme te arsimit te pergjithshem - 3 gjithsej 2908 nxenes
- Shkolla te mesme profesionale - 7 gjithsej 1572 nxenes
- Shkolla 9- te vjecare - 19 gjithsej 9267 nxenes
- Arsimi parashkollore 11 kopeshite pa dreke me anekse +5 kopeshite me dreke 1398 femije
- Konvikte te shkollave te mesme profesionale - 4 gjithsej 279 nxenes
- Qenda Kulturor e Femijeve.

STRUKTURA E BUXHETIT

000 leke

Paga	Sigurime	Transferte individuale	Mallra e sherbime	Transferta	Investime	Totali
33354	5314	100	33326	2520	3450	78064

A. Shpenzime per Paga dhe Sigurime shuma prej **38,768** mije leke mbulon shpenzimet per pagat dhe sigurimet e punonjesve te zyres se arsimit dhe punonjesve te konvikteve.

B. Shpenzime per Mallra dhe Sherbime, shuma prej **33326** mije leke ndahet:

1. Materiale te pergjitheshme zyre shuma 30 mije leke
2. Materiale dhe sherbime speciale, perfshin shumen prej **10072** mije leke, te ndarc:

000/ leke

Veshje per Festivalin e femijeve	300
Punime skene druri e metali per Festivalin e Femijeve	760
Rimbushje fikse zjarri	322
Blerje materiale elektrike per institucionet	250
Blerje materiale hidraulike	300

Blerje ene guzhine per konvikte e kopshtet	180
Blerje batanije e carcafe konvikte + kopshte	200
Blerje e vendosje xhama ne dritare	340
Blerje e vendosje materiale ndryshme (brava, mjete pune etj)	200
Blerje bojra per lysterjen e shkollave	160
Blerje bombola boshe gazi (rreth 200 cope)	260
Totali	3272

Pervec shumes prej 3272 mije leke ne kete shpenzim jane edhe 6800 leke shpenzime per femijet e kopeshteve me dreke (mesatarisht 320 femije) si dhe nxenensit konviktor me pagese.

3.Shpenzime per sherbime me te trete- shuma prej **16242** mije leke, ku perfshihen:

000/leke

Shpenzime per pagese fature konsum energjie elektrike.	8,400
Shpenzim per pagese fatura konsum telefoni. Mbulon shpenzimet e telefonise fikse ne institucionet arsimore	620
Shpenzimet per blerje lende djegese - dru zjarri. Mbulojne shpenzimet per gatim ne nje konvikt, ngrohje ne tre shkolle 9-te vjecare dhe ne gjashte kopshte	1,920
Shpenzime per pagese fature konsum uji i pijshem. Mbulojne shpenzimet per kete sherbim ne 43 institucionet e arsimit baze.	5,000
Shpenzime per sherbime postare	2
Shpenzime per printime dhe faqosje	200
Te tjera shpenzime	100

Ne shpenzimet per **energji ekektrike** parashikimi eshte bere duke marre faktin e 2012 dhe i eshte shtuar borxhi mbi planin e parashikuar per kete ze ne vitin 2012 ne shumen 400 mije leke. Plani per 2013 eshte 8000 mije leke

Per shpenzimet per ujin e pijshem plani i vitit 2013 eshte 5000 mije leke

Ne shpenzimet **per telefonine** , parashikimi eshte bere duke marre faktin e 2012 dhe i eshte shtuar borxhi mbi planin e parashikuar per kete ze ne vitin 2012 ne shumen 140 mije leke. Plani per vitin 2013 eshte 480 mije leke

4. Shpenzime transporti, shuma prej **320 mije leke**, ku perfshihen:

000/leke

Shpenzimi per siguracione per automjetet	100
Pjese kembimi dhe shpenzime te tjera per dy automjetet	220

5. Shpenzime per mirembajtje te zakonshme shuma prej **3010** mije leke, ku perfshihen:
000/leke

Riaprim banjo shkolla Speciale	190
Hidroizulim tarrace dhe riparime te vogla shkolla Azem Hajdari	200
Lyerje e pergjitheshme dhe riparime shkolla Ismail Qemali	420
Lyerje e pjeseshme fasade konvikti Industriaile	190
Punime emergjente te pa parashikuar per 40 objekte te arsimit baze (nderhyje ne sanitare, demtime tavanesh, dycr e dritare ctj)	1,300
Vendosje aspirator kuzhine konvikti i ri dhe kopeshte me dreke	420
Riparime te paisjeve ndryshme teknike dhe elektronike	110
Riparime paisjesh (rreth 40 tryeza dhe 160 karrike nxenesish, etazhe dhe paisje te tjera)	180

6. Shpenzime te tjera operative, shuma ne total prej 3652 mije leke, ku perfshihen:

Siguarçione ndertese, shuma **480** mije leke, qe ka si objekt sigurimin e konvikteve, kopshteve me dreke dhe te shkollave profesionale.

Shpenzime honorare shuma **1,462** mije leke, ku perfshihen ; aktivitet e Q.K.Femijeve si Bilbilat e vegjel kendojne 510 mije leke , Aktiviteti i fundvitit 692 mije leke ,aktivitet spotive e te tjera 260 mije leke ,te cila do te trajtohet me poshte ne menyre analitike .

Te tjera shpenzime shuma **1710** mije leke, e ndare; akomodim per ushqim dhe fjetje per femijet e festivalit 710 mije leke ,ndricim skene festivalit 400 mije leke, sherbim fonie per aktivitetin bilbilat e vegjel kendojne 200 mije leke, per aktivitete jubilarë dhe pervjetore te shkolla Ismail Qemali 400 mije leke.

C. Shpenzime per Investime, shuma prej **3,450** mije leke, ku perfshihen:

a. Rikonstruksione:

000/ leke

Shkolla Ndre Mjeda (punime hidroizolimi e te ndryshme)	1,200
Shkolla Deshmoret e Prishtines (rikonstruksion banjo e te tjera)	1,400

b. Blerje paisje operationale

000/leke

Blerje ngrohese,paisje kuzhine per konviktin e ri, e te tjera paisje per konvikte e kopeshte me dreke	470
Blerje karrige e tryeza per mensen e konviktit shkolles artistike, pedagogjike dhe kopshte me dreke.	380

D. Shpenzime per Transferime Korente, shuma prej 2,520 mije leke, perfshin:

000/leke

Festa e dites se femijeve me aftesi te kufizuara, Shkolla Speciale " 3 Dhjetori"	120
Qendra Kulturore e Femijeve	2,400

Aktiviteti i Qendres Kulturore te femijeve per vitin 2013

000/leke

Mallra e sherbime	Transferta	Totali
3,982	2,400	6,382

A- Shpenzime per Mallra e Sherbime – shuma prej 3,982 mije leke, ku perfshihen:

Festivali Mbarekombetar i Femijeve, Shpenzime per blerje veshje e femijeve 300 mije leke, punime metal e druri per skenen, ne shumen 760 mije leke, ndricim skene 400 mije leke, akomodimi i nxenesve pjesemarres ne festival 710 mije leke, shtypshkrime e printime 150 mije leke.

Si dhe aktivitet e meposhteme :

Bilbilat e vegjel kendojne

Ky aktivitet mbeshetel ne shumen prej 710 mije leke ku perfshihen:

a.Shpenzime per honorare ne shumen prej 510 mije leke te ndara:

000/leke

Krijimtaria	305
Cmimet per fituesit (cmimi pare 13 mije/ cmimi dyte 10 mije leke/cmimi trete 7.5 mije leke/ cmimi inkurajues 5 mije leke)	71
Per anetaret e jurise (faza I-re 1 mije leke faza II-te 2 mije leke,moderimi 5 mije leke,orkestracione 30 mije leke,skenari nates finale 10 mije leke)	134

Sipas zcrave per njesi per krijimtarine e mesiperme kemi: (libreti = materiale humoristike **40 mije leke**, regjia **20 mije leke**, kenge **20 mije leke**, valltaret **7 mije leke** /person, aktor i ftuar **12 mije leke** / person, fonist **30 mije leke**, orkestracione + realizim muzikor **25 mije leke**, skenografi **40 mije leke**.)

b. shpenzime per sherbime tjera – shuma prej 200 mije leke per fonine e aktivitetit

Veprimtari masive artistike, sportive, shkencore

Keto aktivitete mbeshketen ne shumen prej **260 mije leke** , ku perfshihen:

a.Shpenzimet per honorare

000/leke

Cmimet per fituesit sipas garave	146.5
Shperblim per jurite	48.2
Shperblim per realizuesit	40
Shperblim per gjygtaret	25.3

(sipas zereve per njesi jane: vendi I- re **5 mije leke**, vendi II-te **4. 5 mije leke**, vendi III-te **4 mije leke**,cmim inkurajues **3. 5 mije leke**, pagese per gjygtare dhe juri **1. 15 mije leke**/ person, moderimi **5 mije leke**/ person, skenografi **25 mije leke**/person)

Festat e Fund vitit me nxenesit e dalluar

Ky aktivitete do mbeshketet ne shumen prej **692 mije leke**, ku perfshihen:

000/leke

Shpenzime per nxenesit e dalluar (4,5 mije leke /per nxenes)	315
Shpenzime per artistet e vegjel (1,4 mije leke / per femije artist)	98
Shpenzime per krijimtarine	279

DEGA EKONIMIKE E KULTURES

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Trans individuale	Investime	Totali
14,681	2,454	10,844	12	4,125	32,116

1-Qendra e Kulturës "Pjetër Gaci".

Per vitin 2013, shpenzimet e parashikuara ne buxhet per kete institucioni paraqiten si me poshte:

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Investime	Totali
2,421	405	7260	565	10,651

A. Shpenzime per Mallra e Sherbime -per vitin 2013, eshte parashikuar ne shumën 7,260 mije leke, ku perfshihen:

I- Shpenzime operative shuma 343 mije leke, e ndare:

1-shpenzime per sherbime me te trete	161 mije leke
2-shpenzime per siguracion ndertese	29 mije leke
3-shpenzime te tjera administrative	103 mije leke
4-shpenzime per mbushje fikse zjarri	50 mije leke

II.Shpenzime per honorare shuma 5192 mije leke, e ndare:

1- Orkestra Frymore	3674 mije leke
2- Orkestra e Harqeve (per 6-te muaj)	759 mije leke
3- Aktivitete me grupin e valleve dhe korin e qyteteve	759 mije leke

III. Shpenzimet per aktivitetet e kesaj Qendre gjate vitit ne total jane **1,725** mije leke sipas tabelës me poshte:

Emertimi aktiviteve gjate vitit	Honorare	Shp.tjera	Transport	Total
Edicioni i 12-te i konkursit "Pjeter Gaci"	450	230	20	700
Pjesmarrje ne festivalin e kenges popullore – Berat	300		80	380

Pjesemarrje ne fest. Valles burimore – Iushnje	100		50	150
Pjesemarrje ne Festivalin kombetar te Orkestrave frymore – Sarande	120		120	240
Pjesemarrje ne “oda Dibranc”	175		80	255
totali	1145	230	350	1725

B. Shpenzime per Investime ne shumen prej **565** mije leke, ku perfshihen:

- | | |
|---------------------------------------|---------------|
| 1 - shpenzime per rifreskim garderohe | 200 mije leke |
| 2 - blerje pjano forte studio | 300 mije leke |
| 3 - dy tavolina kompjuteri | 30 mije leke |
| 4 - blerje fshese me korent | 15 mije leke |
| 5- blerje makine qepse | 20 mije leke |

MUZEU HISTORIK

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Transferta	Investime	Totali
4,679	782	973	12	600	7,046

A. Shpenzime per Mallra e Sherbime - per vitin 2013 eshte parashikuar ne shumen prej **973** mije leke, ku perfshihen:

- | | |
|---|---------------|
| 1- shpenzime per materiale dhe sherbime zyre | 60 mije leke |
| 2- shpenzime per sherbime me trete | 411 mije leke |
| 3- shpenzime per mirembajtje zakonshtme | 200 mije leke |
| 4- shpenzime dhe sherbime tjera operative | 152 mije leke |
| 5- shpenzime per materile dhe sherbime speciale | 150 mije leke |

B. Shpenzime per Investime ne shumen prej **600** mije leke, ku perfshihen:

Prodhim dhe vendosje rafte per arkivin	200
Sistem alarmi	200
Blerje printeri dhe skaneri	200

3. BIBLIOTEKA "MARIN BARLETTI"

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Transferta	Investime	Totali
6,421	1.073	1,225		2500	11,219

A. Shpenzime per Mallra e Sherbime- per vitin 2013 eshte parashikuar shuma 1,225 mije leke, ku perfshihen:

- | | |
|---|---------------|
| 1- shpenzime per materiale dhe sherbime zyre | 70 mije leke |
| 2- materiale dhe sherbime speciale | 170 mije leke |
| 3- shpenzime per sherbime me te trete | 416 mije leke |
| 4 - shpenzime per mirembajtje te zakonshme | 240 mije leke |
| (rikonstruksion fasade, rregullim tafani e dysheme, rregullim mure dhe instalimeve elektrike) | |
| 5-siguracion ndertese | 29 mije leke |
| 6-rimbushje fikse zjarri | 60 mije leke |
| 7-mirembajtje e fletes O- Pac per faqen e Biblotekes | 50 mije leke |
| 8-shpenzime per aktivitete gjate vitit sipas tabelës me poshte: | |

Emertimi aktivitetit	Honorare	Shpenzime tjera
Festivali letrar i librit	70	20
Dita poezise per femije	30	70
Totali	100	90

B. Shpenzime per Investime- eshte parashikuar shuma prej 2500 mije leke , ku perfshihen:

000/leke

Blerje libra dhe gazeta-BBT	2000
Blerje sistem kondicionere	400
Blerje fshese me korent	25
Vendosje sistem alarmi	75
totali	2500

4. GALERIA E ARTEVE DHE APARATI

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Investime	Totali
1,160	194	1,386	460	3,200

A. Shpenzime per Mallra e Sherbime - eshte parashikuar shuma prej **1,386** mije leke, ku perfshihen:

I. Shpenzime operative shuma 1,061 mije leke, e ndare:

1- shpenzime per sherbime me te trete	191 mije leke
2- shpenzime per siguracion ndertese	29 mije leke
3- shpenzime per mirembajtje zakonshme	466 mije leke
4- shpenzim per mbushje fikse zjarri	60 mije leke

II. Shpenzime per aktivitetet gjate vitit sipas pasqyres me poshte:

Kalendari i ekspozitave tematike dhe aktiviteve promovuese te Galerise 2013

	Katalog	Transp.	Honorare	Shp.tjera.op	Total
Çmimi Idromeno	80	10	130	160	380
Galeria publike qender arti modern			20	80	100
Ekspozita vjetore "Salloni I Vjeshtes"	80	20	20	40	160
Totali	160	30	170	280	640

B. Shpenzime per Investime shuma prej **460** mije leke , e ndare:

1 - blerje dhe vendosje sistem kondicioneresh	400 mije leke
2- blerje aparat special fotografik	60 mije leke

AKTIVITETE TE ZYRES KULTURES

Shpenzimet per aktivitetet e Zyres Kultures ne Bashki ne total jane 7,600 mije leke. Veprimet financiare per keto aktivitete do te kryhen nga Dega Ekonomike e Kultures.

Karnevalet 2013 – aktiviteti i tradites ne nje shtrirje kohore prej tre ditesh, fillon me sfilaten e karnavaleve me nxenesit e shkollave te qytetit, me aktivitete te ndryshme, karvanin e karnavaleve qe do kaloje ne te gjitha rruget e qytetit, vazhdon me koncertin e madh te karnavaleve dhe dita e fundit me shfaqjen me maska ne Teatrin "Migjeni". Fondi i planifikuar ne shumen 1.200 mije leke, i ndara sipas tabelës përmbledhese.

8 Marsi – Dita e Gruas – takim-koktej me grate e qytetit mbeshlet **100** mije leke , sipas tabelës permbledhese.

6 Maji “Dita luleve- nje feste popullore, e kthyer tashme ne festen e qytetit, mbeshtetur mbi nje tradite te lashte, per kultivimin e luleve, permisimin e mjedisit natyror, shpirtëror dhe estetik. Kete vit festa do organizohet ne dy dite, dita e pare do i kushtohet femijeve dhe nxenesve te shkollave, me ekspozita , demonstrime te ndryshme dhe me panairë te shkollave me prodhime te ndryshme.Dita e dyte do i ktheje rruget pedonale te qytetit ne nje panair te vertete lulesh, shoqeruar me performanca te ndryshme artistike, ne nje hapsire te gjere ku do te kete vend per te gjithë, muzikante, instrumentiste , kengetare artiste, piktoe e skulptore. Ne permbyllje do shfaqet nje koncert me muzike zbavitese. Mbeshtetet ne total ne shumën **1.400** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Festivali i muzikes moderne” edicioni dyte do zhvillohet ne muaji qershor. Festivali do kete nje strukture tre ditore, nata pare ne teatrin “Migjeni”, nata dyte ne pedonale dhe nata trete ne sheshin para Bashkise. Ne festival do performojne grupe muzikore e soliste nga tirana , Kosova, si dhe grupe te huaja , si Alkord nga Italia, Grupi Greasha nga Bullgaria, grupe nga Spanja etj. Risi e ketij festivali do jete trajtimi modern i muzikes tradicionale shqiptare e ne vecanti i asaj shkodrane, e detyrueshme kjo per te gjithë grupet pjesemarrëse. Ne festival do performojc dhe grupi rinor i balerineve shkodrane, se bashku me balerinen spanjole Sivilja Cali, ne versionin flamenco. Do mbeshtet ne shumën prej **600** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Dita Boterore e Muzikes” me datën 21 qershor, ne te gjitha qytetet artedashese te botes kjo ngjarje perkujtohet nga muzikate dhe instrumentiste te gjinive te ndryshme te cilet performojne ne vende te ndryshme, salla koncertesh, sheshe , piaca, rruge. Kete vit nga kuarteti “Pasion” ne perberje te cilit jane instrumentiste dhe soliste te njohur do shfaqet nje koncert, i cili do mbeshtetet nga Bashkia ne shumën prej **200** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Koncertet e Veres, eshte kthyer tashme ne tradite qe ne muajt korrik- gusht , pikerisht kur qyteti gjallërohet me shume nga kthimi i emigranteve, si dhe nga nje rritje e konsiderueshme e numrit te te huajve qe vizitojne qytetin, te zhvillohen koncertet e verës ne sheshe te hapura, apo oborre karakteristike shkodrane, te cilat sherbejne jo vetem per te pasuruar jetën artistike e shpirtërore, te qytetareve por dhe per te promovuar vlerat qe ky qytet mbart, si ne art , kulture , trashigimi kulturore etj.Mbeshtet nga Bashkia ne shumën prej **400** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Anifest Rozafa 2013 – aktivitet filmit animuar per femije – eshte zhvilluar vitin e kaluar me shume sukses, perfshin pothuajse te gjithë nxenesit e shkollave 9-te vjecare.Kete vit do te mbeshtet nga Bashkia ne shumën prej **800** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Giffoni festival 2013 aktivitet i filmit per te rinjet - do mbeshtete ne shumën **300** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Koncert “Dita lumturimit Nane Terezës – aktivitet i formacioneve muzikore te qytetit, shkollave, ne nje koncert “In memoriam” per Shejtorën e Madhe Shqiptare. Do mbeshtet ne shumën prej **200** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Festat Pavaresise dhe Clirimit te Atdheut- Koncert Festiv – aktiviteti artistik i ketyre festave do mbeshtet ne shumën **400** mije leke, sipas tabelës permbledhese.

Ndermendje 2013- me rastin Festave Fund Vitit – aktivitet festiv me pjesemarrjen e Orkestres Sinfonike,Orkestres se Harqeve, Korit te qytetit dhe me shume kengetare te mirenjohur te

skencës shqiptare. Do të mbështetet nga Bashkia në shumën prej 1.200 mijë lekë, sipas tabelës përmbledhëse.

Aktiviteti me rastin e 100 vjetorit të Bashkisë, aktiviteti me këtë rast do të zhvillohet në muajin gusht dhe bashkia do të mbështesë në shumën prej 400 mijë lekë, sipas tabelës përmbledhëse.

Aktiviteti, Zhvillimi i sporteve të ujit, projekt nga Shoqata e sporteve të ujit, i cili shërben për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe lartësimin e njohjes së liqenit Shkodrës, për nxitjen e investimeve në zonat liqenore. Ky aktivitet do të mbështetet në shumën prej 400 mijë lekë sipas tabelës përmbledhëse.

Tabela përmbledhëse e shpenzimeve për aktivitetet e zyrës së kulturës :

	Emertimi aktivitetit	Honorare	Shp.tjera	Transferim		Total
				Vlera	Subjekti	
1	Karnevalet e Shkodrës 2013	300	300	600	Venice Art	1,200
2	8 Marsi		100			100
3	6 maji- Dita Luleve	400	400	600	Creative city	1,400
4	Festivali muzikës moderne		600			600
5	Koncertet e verës			400	Creative city	400
6	Dita botërore e muzikës	200				200
7	Anifest Rozafa 2013			800	Koha e fëmijëve	800
8	Gjifoni fest 2013		300			300
9	Dita lumturimit të Nënë Terezës	200				200
10	Festa Pavaresisë dhe Çlirimit	200	200			400
11	Koncert fundviti -Ndërmendje	900	300			1200
14	Aktivitetet për 100 vjetorin e Bashkisë		400			400
16	Sportet e ujit			400	Shoqata e sporteve të ujit	400
	TOTALI	2200	2600	2800		7600

TEATRI "MIGJENI"

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Transferta	Investime	Totali
16,718	2,659	2,478	2.500	4,500	28,855

A. Shpenzime per Mallra e Sherbime - per vitin 2013 parashikuar ne shumen prej 2,478 mije leke , ku perfshihen:

- shpenzime per sherbime me te trete	800 mije leke
- shpenzime per mirembajtje e zakonshme	500 mije leke
- shpenzime per transport	300 mije leke
- shpenzime per materiale dhe sherbime tjera operative	878 mije leke te ndara:
1. shpenzime per pritje percjellje	300 mije leke
2. shpenzime per aktivite ndryshme	300 mije leke
3. shpenzime per honorare	225 mije leke
(anetaret e bordit artistik te Teatrit)	
4. shpenzime per sigurim ndertese	53 mije leke

B. Shpenzime per Transferime Korente- 2,500 mije leke eshte shuma qe mbulon shpenzimet per projekte premiere, qe perfaqesojne aktivitetin kryesor te ketij institucioni gjate vitit 2012. Sipas ligjit nr 10 352, dt 18.11.2010 " Per Artin Skenik", perzgjedhja e veprave, si dhe shpenzimet per venjen ne skene te sejciles prej tyre, miratohen me pare nga Bordi Artistik i Teatrit , i cili eshte organ kolegjal vendimarrës.

C. Shpenzime per Investime - shuma prej 4,500 mije leke parashikuar te shpenzohet :

000/leke

	Shpenzime per Investime	Plani 2013
1	Rikonstrukcion i sistemit ngrohjes dhe percimit te nxehtesise	4,000
2	Rikonstrukcion i dhomave te aktoreve , kati nendheshem	500
	TOTALI	4,500

SPORT KLUB VLLAZNIA

000/leke

Paga	Sigurime	Mallra e sherbime	Transferta	Investime	Totali
8.889	1.448	24.066	30	1623	36,056

A. Zeri- Mallra dhe Sherbime- per vitin 2013, ne total eshte parashikuar shuma prej 24,066 mije leke, qe mbulon shpenzimet per blerje mallra e sherbime, si dhe per aktivitetin sportiv te klubit, e cila ndahet:

- **Mallra e sherbime tjera** shuma 1,697 mije leke trajtohet ne tabelen me poshte:

000/ leke

Shpenzime per materiale zyre	100
Shpenzime per sherbime per te trete	1,192
Shpenzime per mirembajtej e zakonshme	100
Shpenzime per siguracione	75
Shpenzim per blerje ilace	30
Shpenzime per udhetim dieta administrata	200

Shpenzime per aktivitetin sportiv - shuma prej 22,369 mije leke, perfshin trajtimet ushqimore te sportisteve, pageset per honorare per trajnera, pagese honorare per gjygtareve etj, sipas klasifikimit bere nga Sport Klub Vllaznia.

GRUPI A

a) Boksi, nje nder ekipet me rezultate me te mira. Ne kete sport jane pese ekipe (sipas moshave), te gjitha ne vendin e pare ne kampionate kombetare dhe nderkombetare. Shpenzimet per aktivitetin ne total shuma 4,636 mije leke e ndare: 2,785 mije leke shpenzime per trajtim ushqimor, 391 mije leke pagesa per tre trajneret, 110 mije leke materiale sportive, 150 mije leke honorare per rezultate te larta. 300 mije leke faze pregatitore, dhe 900 mije leke aktivitet nderkombetar, sipas Kalendarit europian "Memorial Vllaznia 2013", per akomodimin e sportisteve.

b) Basketboll, M +F trajtohen gjashte ekipe, vende nderi ne kampionat kombetar e kane ekipet e te rinjeve dhe te rejave, ndersa ekipet e rritura M +F jane ne vendin e katert. Shpenzimet ne total per aktivitetin shuma prej 4,457 mije leke e ndare: 3,270 mije leke trajtime ushqimore, 644 mije leke pagesa per gjashte trajneret, 120 mije leke materiale sportive, 60 mije leke pagesa per gjygtaret e tavolines, 100 mije leke honorare per rezultate te larta sportive, 170 mije leke, faze pregatitore grumbullim, 93 mije leke, per licensime.

c) Volejboll, M + F trajtohen pese ekipe te cilet kane rrezultate te mira ne klasifikim Shpenzimet ne total 3,799 mije leke, e ndare; 2,797 mije leke shpenzime per trajtim ushqimor, 598 mije leke pagesa per pese trajneret, 100 mije leke materiale sportive, 60 mije leke pagesa gjygtari i tavolines, 50 mije leke honorare per rezultate te larta sportive, 170 mije leke faze pregatitore grumbullimi, 24 mije leke per licensime.

d) Atletike, trajtohen ekipe zingjir te rritur, te rritura, te rinj te reja, nga ku per meshkuj renditen ne ved te pare. Shpenzimet ne total jane 3,525 mije leke, te ndara : 2,375 mije leke trajtim ushqimor, 690 mije leke pagesa per gjashte trajnere, 200 mije leke faze pregatitore, 150 per rezultate te larta sportive, 110 per baze materiale.

e) Peshengritje, trajtohen tre ekipe, fituese te vendeve te kreut te renditjes, dhe ne Kampionate Nderkombetare. Shpenzimet ne total 2,314 mije leke te ndara: 1,780 mije leke trajtimi

ushqimor, 414 mije leke, pagesa per gjashte trajneret, 70 mije leke materiale sportive, 50 mije leke, honorare per rezultate te larta.

f) **Gjinnastike**, trajtohen gjashte ekipe, nga te cilat ekipi i te rriturave kampion kombetar. Ne muajin shtator eshte hapur akademia e gjinnastikes ne nje palester me qera, ku streviten ekipet zingjir te gjinnasteve djem dhe vajza. Shuma ne total 1,006 mije leke nga te cilat 276 mije leke pagese trajnereve tre trajnere, 730 mije leke trajtim ushqimore.

GRUPI B

a) **Mundje e lire**, trajtohen tre ekipe (sipas moshave) fituese ne vendet treta e katerta. Shpenzimet per aktivitetin ne total jane 635 mije leke te ndara: 385 mije leke trajtime ushqimore, 230 mije leke pagesa per dy trajneret, 20 mije leke per materiale sportive.

b) **Ciklizem**, trajtohen dy ekipe, ku ne ekipin e te rinjeve kemi kampion kombetar dhe kampion Ballkanik. Shpenzimet per aktivitetin ne total jane 666 mije leke te ndara: 478 mije leke trajtime ushqimore, 138 mije leke pagese per dy trajneret, 50 mije leke baze materiale.

c) **Shah**, trajtohen tre ekipe, ekipi i te rriturave vendin pare Kampionat Kombetar. Shpenzimet per aktivitetin jane 367 mije leke te ndara: 160 mije leke trajtim ushqimor 207 mije leke pagesa per dy trajneret.

d) **Judo**, 230 mije leke e ndare 115 mije leke per trajtim ushqimor dhe 115 mije leke per pagese trajneresh.

dh) **Hendboll**, jane dy ekipe ne Kampionatin kombetar te rinj vendi pare.

Shpenzimet per aktivitetin jane 234 mije leke te ndara: 50 mije leke trajtim ushqimor 184 mije leke pagese per dy trajneret.

e) **Pingpong**, jane kater ekipe, M + F te rritur dhe te rinj, fitues ne vende treta e katerta. Shpenzimet per aktivitetin jane 155 mije leke te ndara: 40 trajtim ushqimor ,115 mije leke pagesa per nje trajner.

f) **Not**, trajtohen kater ekipe (sipas moshave) fituese ne vendet e katerta dhe e tete. Shpenzimet per aktivitetin jane 95 mije leke te ndara: 35 mije leke trajtim ushqimor, dhe 60 mije leke pagesa per trajneret.

Aktivitete tjera

Me rastin e perfundimit te vitit kalendarik, Sportklub " Vllaznia" organizon aktivitetin festiv " Shpallja e sportisteve me te mire te vitit".

Shpenzimet per kete aktivitate parashikohen ne shumen prej 250 mije leke.

B. Shpenzime per Investime - shuma e parashikuar prej 1,623 mije leke e ndare:

- | | |
|---|---------------|
| ➤ Rikonstrukcion i pjeshem i pallatit sportit, (sallave te strevitjeve per peshengritjen, boksen) | 878 mije leke |
| ➤ Blerje paisje , kompjuter | 50 mije leke |
| ➤ Blerje rafte e tavolina per pallatin | 30 mije |
| ➤ Prozhektor per pallatin (24 cope) | 665 mije leke |

Klubi i futbollit KF Vllaznia sh.a.

Ne mbeshtetje te ketij klubi caktohet fondi prej 20 000 mije leke per te cilen do te kete vendim te vecante te keshillit bashkiak.

SHERBIMI SOCIAL

Nje nder prioritetet e bashkise ne sherbimet sociale eshte edhe mbeshtetja e sherbimeve me baze komunitare dhe sherbimeve alternative per target-grupe ne nevoje sipas prioriteteve te PSZ dhe strategjive kombetare dhe rajonale. meqenese plani social eshte bere para 5 vitesh kete vit mendojme te rinovojme kete plan me te Sherbime mjaft te rendesishme prane sektorit te sherbimit social ne bashki jane edhe ato te ofruara nga Njesia e mbrojtjes se femijeve ku specialistja e zyres ne zbatim te ligjit 10347 date 4.11.2010 evidenton raste te femijeve qe paraqesin shkalle te larte rreziku dhe koordinon veprimet me grupin teknik per trajtimin e ketyre rasteve. Ne zbatim te Ligjit nr 9669 per evidentimin dhe mbrojtjen e rasteve te dhunes ne familje sherbimini i ofruar nga specialistja e zyres perqendrohet si ne sherbimin me linje telefonike ashtu edhe me evidentimin mbrojtjen e rasteve te paraqitura dhe kryesisht koordinimin e veprimeve me te gjithë aktoret per zgjidhjen ose lehtesimin e situates se viktimave te dhunes ne familje, por krahas sherbimeve direkte mjaft e rendesishme eshte edhe bashkepunimi dhe koordinimi per rritjen e shkalles se informimit dhe sensibilizimit per fenomenin me te gjithë komunitetin.

Per vazhdimesine e sherbimit ne Qendrat Polivalente te ngritura ne Lagjen Mar Lulaj dhe Kiras nga bashkefinancime te Bashkise Shkoder, COSPE , kjo edhe ne baze te marreveshjes me paleve Bashkia Shkoder merr persiper shpenzimet e mirembajtjes per ecurine e punes ne keto qendra :

Duke u nisur nga vleresimi i nevojave ne komunitet si dhe ne mbeshtetje te prioriteteve te PSZ edhe per kategorite e tjera te trajtuara ne kete plan duhet te mbeshteten edhe sherbimet per qendren komunitare per te moshuar si sherbim alternativ mjaft i nevojshem per te moshuarit sipas standarteve te sherbimit social

Po keshtu edhe sherbimi komunitare per familjet, dhe vecanarisht gra dhe femije me probleme sociale eshte mjaft i nevojshem ne terroror dhe i pergjigjet nevojave te shumta qe familjet kane si ne mbeshtetje psiko-sociale ashtu edhe me sherhime te ndryshme alternative qe lehtesojne situatat e veshtira qe keto familje kane.

Gjate vitit 2013, ne zbatim te aneksit 5 i ligjit te buxhetit 2013, do te mbeshteten edhe sherbimet e tipit shtepi-familje te ofruara nga projekti "Shpresa" me nje fond prej 8.000.000 leke, i cili do te specifikohet me vendim te keshillit bashkiak.

Tabela permbledhese e ketyre shpenzimeve:

000/lek

Nr	Lloji i sherbimit	Plani 2013	Llog 604	Llog 602
1.	Sherbime komunitare M.Lulaj	372	240	132
a	Energji elektrike			30
b	Uje			24
c	Ngrohje			18
d	Telefon			60
2.	Sherbime komunitare Kiras	372	240	132
a	Energji elektrike			30
b	Uje			24
c	Ngrohje			18
d	Telefon			60
3.	Sherb. Komunitare familje/gra femije	384	384	
4.	Sherbime komunitare per te moshuar	360	360	
5.	Sherbimi Anti-dhune	42	12	30
6.	Sherbimi i CPU	130	70	60
7	Plani social	100		100
	Totali	1760	1306	454

CERDHET

Totali	Paga	Sig. Shoqerore	Shpenz. Operative	Transferime individuale	Investime
27.003	16.583	2.642	6.610	78	1.090

1. Ne zerin e pagave dhe sigurime shoqerore jane planifikuar 19225 mije leke.
2. Ne zerin "Mallra e sherbime te tjera" jane planifikuar 6610 mije leke qe do te shpenzohen konkretisht si me poshte:

- Ne zerin materiale dhe sherbime speciale jane planifikur 4.150 mije leke nga te cilat 3.800 mije leke do te shpenzohen per ushqime, vlere e cila eshte e lidhur me rritjen e numrit te femijeve (145 femije) dhe permiresimit te cilesise te ushqimit, ndersa vlere prej 350 mije leke do te perdoret per blerje "Materjale te tjera" si ene guzhine, çarçafe, peshqire, mushama tavoline, lojra femijesh etj.

Ne zerin "*Sherbime*" jane llogaritur shpenzime me vlere **1730 mije leke** ne te cilat perfshihen 605 mije leke per likujdimin e faturave te c.elektrike dhe 825mije leke Faturat e konsumit te ujit. Vlera prej 300 mije leke eshte planifikuar per lende djegese per ngrohje (dru zjarri).

Ne zerin "*Qera objekti*" eshte perfshire çerdhja " 10 Korriku" me vleren **240 mije leke**.

Ne zerin "*Mirembajtje te zakonshme*" nga vlera totale **490 mije leke**, vlera prej 400 mije leke.eshte planifikuar per lyerjen e 4 Çerdheve . Shuma prej 60 mije leke do te perdoret per mirembajtjen e paisjeve dhe te aparateve teknike, ndersa pjesa tjeter prej 30 mije leke do te perdoret per mirembajtjen e paisjeve te zyres.

3. Ne zerin"Transferta Buxhetore familjare dhe individ. Jane planifikuar **78 mije leke** per pagesat e kompensimeve te punonjesve .

4. Ne zerin "*Investime*" jane planifikuar **1.090 mije leke**, nga te cilat **800 mije leke** do te perdoren per rikonstruksion te 2 çerdheve: Manush Alimani **400 mije leke** per suvatime jashte te nderteses dhe shtrim pllake ne ambjente brenda dhe **400 mije leke** per rikonsruksion Çerdhes "1 Qershori" rrethim me kangjella per arsye te ndertimit pallatit afer. Sipas detyres se lene nga "Inspektoriati i higjenes se ushqimeve" duhet qe magazina e ushqimeve te jete ne vete, per kete arsye duhet te investohet nje vlere prej **150 mije leke** per vendosjen e nje vetrate per ndarjen e ambjentit te magazines. Tek blerjet e paisjeve operacionale eshte planifikuar vlera prej **140 mije leke** e cila do te perdoret per blerjen e 2 sobave gazi per ngrohje me vlere 50 mije leke, 2 boljere me vlere 40 mije leke dhe nje lavatrice me vlere 50 mije leke.

**DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT**

Synimet e programit të Drejtorisë së Promovimit Zhvillimit për vitin 2013 janë :

Promovimi i territorit të bashkisë nepermjet zhvillimit të aktiviteteve dhe prodhimit të materialeve promovuese .

Projekti Adria Muse

Gjatë vitit 2013 do të realizohet përfshirja e muzeve Shqiptare në rrjetin e euromuse.net, një rrjet i muzeve më të mirë të Europës online. Muzeu Historik i Shkodrës ka përfunduar procesin e regjistrimit, janë përgatitur materialet e duhura dhe pritet aprovimi i Euromuse për përfshirjen e tij në rrjet. Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta pilot me Rajonin e Venetos, që parashikojnë zhvillimin e aktiviteteve të ekspozimit të vlerave të trashigimisë kulturore sipas konceptit përtej mureve të muzeumeve. Zhvillimi i festës së liqenit të Shkodrës në javën e tretë të muajit qershor e cila do të përmbajë një larmi aktiviteteesh promovuese për liqenin e Shkodrës. Është parashikuar disenjimi dhe publikimi i hartës së qytetit të Shkodrës e cila do të përmbajë informacione shërbimi për vizitorët .

- Koordinim dhe zbatim projektesh zhvillimi

Zyra me një Ndalese

Më ndërtimin e infrastrukurës së Zyres me një ndalese është parashikuar trainimi i stafit të bashkisë dhe venia në funksion të plotë të sistemit IT të zyres.

Projekti Legend - Ky projekt do të zbatohet në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatik, masa 2.3 Ruajtja e energjisë dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Në kuadër të energjiave të reja dhe politikave mjedisore të EU, objektivi i këtij projekti është të evidentojë praktikën më të mirë në nivelin lokal, rajonal dhe Europian në fushën e energjisë gjeotermale me entalpi të ulët , me qëllim promovimin e përdorimit të teknologjive që lidhen me këtë tip burimi energjie dhe aplikimin e saj për ndërtesat publike. Vlera totale e projektit është 3.085.540, Euro. 7.14 % të vlerës totale është parashikuar për Bashkinë Shkodër me vlerë prej 220.400 Euro nga i cili 85 % financim nga Programi IPA dhe 15 % bashkefinancim. Kohezigjatja e projektit është 24 muaj.

Krijimi i zonës së përmirësimit të Biznesit rruga “28 Nentori”.

Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Fondacionit Shqiptaro Amerikan për Zhvillim (AADF), nr. Prot. 729 ,datë 27 Shkurt 2012, në kuadër të zhvillimit të projektit “Zona për Zhvillimin e Biznesit”, paragrafi IV , do të transferojë të gjitha tarifat e mbledhura nga bizneset e rrugëve 13 Dhjetori dhe 28 Nentori , tek Shoqata “Rruga 28 Nentori” si vijon : 1. Shuma prej 397,413 leke , e arketuar gjatë vitit 2012 nga tarifat e bizneseve të rrugës 13 Dhjetori dhe 28 Nentori do të transferohen për llogari të shoqatës Zona e Përmirësimit të Bisnesit rruga 28 Nentori në muajin janar 2013 . Shuma prej 732230 leke , e parashikuar për t’u arketuar gjatë vitit 2013 , nga tarifat e bizneseve të rrugës 13 Dhjetori dhe 28 Nentori do të transferohen për llogari të shoqatës Zona e Përmirësimit të Bisnesit rruga 28 Nentori në muajin shtator 2013.

Rikonstruktimi i fasadave te ndertesave te rrugeve , i parashikuar ne projekt, do te realizohet gjate vitit 2013.

• **Projekte te pritshme per vitin 2013**

Projektet IPA- Shqiperi - Mali I Zi

Ne kuader te programit nderkufitar IPA Shqiperi Mali i Zi ,me reference EuropeAid/133455/M/ACT/Multi, ne thirrjen e saj te trete per aplikim projektesh, stafi i Bashkise Shkoder ne bashkepunim me partnere shqiptare dhe malazes ka aplikuar ne nje sere projektesh sipas akseve prioritare te ketij program:

Projekti : Promovimi i zhvillimit te qendrueshem ne Shqiperi /Mal te Zi nepermjet zbatimit te qeverisjes se mire ne planifikim masa 1.2 Promovimi dhe mbrojtja e mjedisit. Bashkia Shkoder eshte partnere ne kete projekt. Kohezgjatja e projektit eshte 24 muaj. Vlera totale e projektit eshte **158289,92 euro**.

Projekti : Permiresimi i rritjes ekonomike te qendrueshme e komunitetit te peshkatoreve ne liqenin e Shkodres – nje inisiativë per ta sjelle liqenin me afer te perfitimi i komunitetit. Masa 1.1 Zhvillimi ekonomik me theks ne promovimin e turizmit. Bashkia Shkoder eshte partnere ne kete projekt. Kohezgjatja e projektit eshte 18 muaj. Vlera e projektit per palen Shqiptare eshte **138.840**.

Projekti: Perfshirje pa kufi . Masa 1.3 Permiresimi i kohezionit social nepermjet veprimeve njeres me njeres .**Objektivi kryesor i projektit** eshte arritja e nje niveli me te larte socializimi dhe integrimi ne shoqeri te personave me paaftesi intelektuale. Bashkia Shkoder eshte lider i projektit. Kohezgjatja e projektit eshte 12 muaj . Vlera totale e projektit per palen shqiptare eshte **178,880 Euro**.

Projekti: Plani i Lëvizjes Urbane të Qëndrueshme (SUMP) në Shkodër dhe Bar. Masa 1.2 . Mbrojtja e mjedisit dhe nxitja. **Objektivi kryesor i projektit** është përfshirja e Shkodrës dhe Barit në planifikimin e lëvizjes urbane të qëndrueshme (SUMP) që ka të bëjë me ruajtjen dhe nxitjen e stilit të mënyrës së udhëtimit të pastër, aktiv dhe eficient në energji (ecje, pedalim dhe transport publik), zvogëlimin e ndotjes së ajrit në qytet, përmirësimin e sigurisë rrugore dhe kontributin e atraktivitetit të mjedisit urban dhe hapësirës publike. Lider i projektit është Bashkia e Shkodrës. **Kohëzgjatja e projektit** është 24 muaj. **Vlera e projektit** për palën shqiptare është **299,970 Euro**.

Projekti : Perfshirja sociale e rinise nga pjesa e familjeve te disavantazuara nepermjet rritjes se punisimit te tyre, pjesmarrjes active dhe vullnetarizmit. Masa 1.3 Permiresimi i kohezionit social nepermjet veprimeve njeres me njeres .**Objektivi kryesor i projektit** eshte permiresimi i aksesit te te rinjve nga mosha 16 vjeç deri ne 18 vjeç ne lidhje me mundesite per shkollim, punesim, pjesmarrje qytetare dhe ne zhvillimin e komunitetit. Bashkia Shkoder eshte partnere ne kete projekt.**Kohëzgjatja e projektit** është 18 muaj.**Vlera e projektit** për palën shqiptare është **185,795 Euro**

Projekti : COOP.TOUR: Nje model cooperative per turizmin e qendrueshem ne Shqiperi dhe Malin e Zi. **Masa 1.1** Zhvillimi ekonomik me theks ne promovimin e turizmit.**Objektivi kryesor:** Zhvillimi i ekonomise lokale nepermjet promovimit te turizmit dhe potencialeve kulturore ne zonen nderkufitare Shqiperi Mali i Zi. Lider partner eshte Bashkia Shkoder.

Kohëzgjatja e projektit është 24 muaj. Vlera e projektit për palën shqiptare është 292,138 Euro.

Tabela projekteve

Lista e projekteve per 2013	Buxheti total i projekteve	Shuma e destinuar per Bashkine Shkoder sipas projekteve per vitet 2013		Hashkefinancimi i kerkuar nga ana e Bashkise			
				Viti 2013		Viti 2014	
	Euro	Euro	Leke	Euro	Leke	Euro	Leke
Projekte ne vazhdim							
Projekti Zyra me nje Ndalese			3,568,000		2,353,806		
Projekti Adria Muze	120,600	30,000	4,200,000	18,090	2,478,330		
Projekti Marubi	229,429	59,000	8,260,000				
Projekte te reja							
Legend	220,400	50,000	7,000,000			33,060	4,628,400
Nen shuma 1	570,429	139,000	23,028,000	18,090	4,832,136	33,060	4,628,400
Organizimi i dites se I qenit					400,000		
Ilarta e qytetit					250,000		
Nen shuma 2	0	0	0	0	650000	0	0
Totali	570,429	139,000	23,028,000	18,090	5,482,136	33,060	4,628,400



DREJTORIA JURIDIKE

Planifikime ne buxhetin 2013

Nr	Vendimi gjyqesor	Shuma	Shpenzime gjyqesore
1	Vendimi nr. 409 date 10.10.2012 i Gjykates se Apelit. (ka marre forme te prere)	6.360.040 leke + interesa bankare nga data 24.11.2008 – 10.10.2012	-
2	Vendimi nr. 696 date 13.03.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder . nuk ka marre forme te prere.	1.352.700 leke	37.581 leke
3	Vendimi i Gjykates Apelit nr. 341 date 21.02.2011, vendim i formes se prere.	1.989.088 leke	49.890 leke
4	Lajmerim per ekzekutim vullnetar(vendimi Gj.RR.Gjyq 2873 dt.19.6.12 Kreditor CEZ. (fatura te pashlyera 2011-12 Ndricimi rrugor stadiumi	311.294,4 leke	14.400 leke

II-Planifikim , rregjistrimi zyra e aseteve :

Rregjistrimi I pronave në ZVRPP – Shkodër (pagesë për tarifë për akte administrative).

Regjistrimi I pronave të miratuara me VKM Nr. 421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë shkodër, të Qarkut të Shkodrës” gati për regjistrim 200 pasuri.

Tarifa për akte administrative për regjistrimin e një pasurie sipas të dhënave nga ZRPP – Shkodër është 300 lekë.

200 pasuri X 300 lekë/pasuri = **60 000 lekë.**

Për pasuritë rrugë e lulishta që pritët miratimi

Gjithsej 516 pasuri nga të cilat

- 438 rruge
- 47 lulishta
- 31 bulevarde

516 x 300 = **154 800 lekë**

Totali 100000 + 60 000 +154 800 = **314 800 leke**

Projektet e Zyres se Aseteve

1. Aplikim i punimeve silvikulturale ne pyjet artificial

Vlera 3 482 800 leke



ADMINISTRATA

Plani 2013

Tabela 1. Permbledhese

000 leke

	Emertimi	Plani 2013
I	Paga	104 698
II	Sigurime Shoqerore	16 895
III	Transferime	678
IV	Shpenzime Operative	53 566
V	Investime	1 580
	Totali	177 417

III - Shpenzime operative

Politika e këtij plani konsiston në menaxhimin dhe në përdorimin me më efektivitet të burimeve financiare dhe garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore të Bashkisë Shkoder. Ky plan ka si qëllim të mbulojë nevojat për shpenzimet operative për administratën e Bashkisë dhe për një pjesë të shpenzimeve si kanceleri, leter, boje, gaz, karburant dhe materiale pastrimi për institucionet e varesise ku përfshihen: Teatri, Dega Ekonomike e Kultures (Muzeu, Biblioteka, Galeria, Muzeu, Qendra Kulturore) Klubi shumesportesh "Vllaznia", Zyra e Arsimit (sistemi parauniversitar dhe kopshtet) si dhe Drejtoria e Çerdheve.

000 /leke

Shpenzimet operative	Plani 2013
Mat.dhe sherb.zyre dhe te pergjith	6 930
Materiale dhe sherbime speciale	480
Sherbime nga te trete	13 454
Shpenzime transporti	6 330
Shpenzime udhetimi	700
Mirembajtje e zakonshme	900
Qeradheniet	450
Detyrime dhe kompensime legale	11 000
Shpenzime per huamarrjen	
Shpenzime te tjera operative	13 322
Shuma	53 566

Ne zerin 602 « *Shpenzime operative* » eshte planifikuar shuma **53 566 mije leke** e ndare si me poshte :

❖ Zeri (6020) "*Materiale e sherbime zyre te pergjithshme*" jane planifikuar **ne vleren 6930 mije leke** te ndare si me poshte:

- Zeri "*Kancelari, leter, boje*" parashikohet te jete ne vleren **3100 mije leke** .Keto shpenzime do te mbulojne kerkesat e drejtorive te administrates se Bashkise,Teatrit, Deges Ekonomike te Kulture, Klubit shumesportesh dhe shkollave te mesme te arsimit te pergjithshem, te mesme profesionale, 9 vjecare ,arsimi parashkollor, konvikteve te shkollave te mesme te detajuara keto nga Zyra e Arsimit .
- Zeri "*Materiale per pastrim, dizinfektim, ngrohje dhe ndricim*" parashikohet ne vleren **2 200 mije leke** nga keto **2000 mije leke** per blereje materiale pastrimi,shpenzime te cilat planifikohen sipas kerkesave te institucioneve te varesise dhe **200 mije leke** per shpenzime materiale elektrike etj.
- Zeri "*Materiale per funksionimin e paisjeve te zyrave*" parashikohet ne vleren **350 mije leke**.
- Zeri "*Materiale per funksionimin e paisjeve speciale*" parashikohet ne vleren **300 mije leke** ku perfshihen shpenzimet per paisje kompjuterike si tastiera, mausa, karta Ram, motherboard ,karta grafike,karta rrjeti ,bateri,aparate telefoni etj.
- Zeri "*Blerje dokumentacioni*" parashikohet te jete ne vleren **680 mije leke**, ku **480 mije leke** parashikohen per shpenzime shtypshkrime te ndryshme per nevoja te administrates se Bashkise dhe institucioneve te varesise dhe **200 mije leke** shpenzime per blerje gazeta, broshura informative, formatime, printime A0, harta etj.
- Zeri "*Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme*" parashikohet te jete ne vleren prej **300 mije leke** .

❖ Zeri (6021) "*Uniforma*" parashikohet te jete ne vleren prej **480 mije lekesh**, ku perfshihen shpenzimet per blerje te uniformave te policise bashkiake, bazuar ne VKM nr. 333 date 02.06.1998 per "Miratimin e normes se veshmbathjes per policine" per kostume, pantallona verore, xhakovento, kemisha, kepuce, pulovra, stema, doreza pune etj .

❖ Zeri (6022) "*Sherbime* " eshte planifikuar ne vleren prej **13 454 mije leke** e detajuar si me poshte:

- Zeri "*Energji elektrike*" parashikohet ne vleren prej **3 000 mije lekesh** .
- Zeri "*Uje*" parashikohet ne vleren prej **600 mije lekesh** per shpenzime uji.
- Zeri "*Sherbime Telefonike*" parashikohet ne vleren prej **720 mije leke**.

Ketu perfshihen: Shpenzimet per telefonine celulare per titullaret, shpenzime keto te parashikuar ne baze te VKM nr. 864, dt 23.07.2010 ne vleren **240 mije leke** si dhe telefonine fikse per titullaret, drejtorite dhe njesite administrative ne vleren **480 mije leke**.

		Telefon fiks (leke) ne vit	Celular (leke) ne muaj
1	Kryetari	90000	10000
2	Zv.Kryetari	40000	5000
3	Zv.Kryetari	40000	5000
4	Sek.Kryetarit	30000	
5	Sek. Keshillit Bashkiak	40000	
6	Drejt. Ekonomike	40000	
7	Drej. Kultures	30000	
8	Linja antihune 24 ore	30000	
9	Drejtoria e Personelit	30000	
10	Drejtoria e te Ardhurave	20000	
11	Njesia administrative nr.1	20000	
12	Njesia administrative nr.2	20000	
13	Njesia administrative nr.3	20000	
14	Njesia administrative nr.4	20000	
15	Njesia administrative nr.5	20000	

- Zeri **“Posta dhe sherbimi korrier”** parashikohet ne vleren prej **200 mije leke** per shpenzime sherbime telegrafike e postare.
- Zeri **Lende djegese** parashikohet te jete ne vleren prej **7 500 mije lekesh** .Ne kete ze perfshihen shpenzimet per gaz sipas kerkesave te paraqitura nga drejtorite dhe institucionet e varesise.
- Zeri **“Sherbime te printimit dhe publikimit ”** parashikohet te jete ne vleren prej **400 mije lekesh**,
ku perfshihen shpenzimet per njoftime ne media, botime ne gazeta lokale e kombetare, spote publicitare, reklama etj.
- Zeri **“Sherbime te tjera”** parashikohet te jete ne vleren prej **1 034 mije leke**, ku perfshihen shpenzimet per sherbim interneti ,per faqen e internetit, shpenzime per pagese sherbim AKEP ,sherbim larje tapeta, kolltuke, automjete etj.
- ❖ Zeri (6023) **“Shpenzime transporti”** per vitin 2013 eshte planifikuar shuma **6 330 mije leke** e detajuar si me poshte:
- Zeri **“Shpenzime karburant”** parashikohet ne vleren prej **5 000 mije leke**.Ketu perfshihen shpenzimet per blerje karburant per kaladaja dhe automjete , vaj makinash ,keto sipas nevojave te institucioneve te varesise dhe administrates. Planifikimi behet per automjetet e

administrates, drejtorine e sherbimeve publike (sektori i ndriçimit dhe vizimit), drejtorine e te ardhurave, policine bashkiake, inspektoriatin ndertimor, motogjeneratorin etj.

Ne drejtorine Arsimore parashikohet ngrohja me kaldaje e konvikteve per 5 ore/pune ne dite (periudha 15 Nentor-15 Mars (llogaritjet bazohen mbi bazen e te dhenave qe kane patentat perkatese te kaldajave). Ne Teatrin " Migjeni parashikohet sasia e karburantit mbi bazen e perlllogaritjes se numrit te shfaqjeve qe do zhvillohen gjate vitit. Per Klubin Shumesportesh " Vllaznia " parashikohet karburant ne baze te kerkesave te bera nga Klubi ,per aktivitetet e ciklizmit per te mritur ,ciklizmit per te rinj , per atletike,per gjeneratorin etj.

- Zeri "**Pjese kembimi**" parashikohet ne vleren prej **480 mije leke** ku perfshihen shpenzimet per pjese kembimi goma,bateri automjeteve etj.
- Zeri "**Siguracion**" parashikohet ne vleren prej **450 mije leke**,ku perfshihen shpenzimet per siguracionet e automjeteve te administrates ,policise bashkiake e inspektoriatit ndertimor,drejtorise se te ardhurave etj
- Zeri "**Shpenzime te tjera**" parashikohet ne vleren prej **400 mije leke**,ku perfshihen shpenzimet per riparimet e avarive te makinave te administrates, policise bashkiake,inspektoriatit ndertimor, drejtorise se te ardhurave ,motor gjeneratorit, autoshkalles,elektrovinçit, makines se vizimit dhe prerases.

- ❖ Zeri (6024) "**Shpenzime udhetimi**" per vitin 2013 parashikohet ne vleren prej **700 mije lekesh**.

Udhetime e dieta te brendshme me vlere 500 mije leke

Udhetime e dieta me jashte me vlere 200 mije leke

- ❖ Zeri (6025) "**Mirembajtje e zakonshme**" per vitin 2013 parashikimi do te jete ne vleren prej **900 mije leke**, kjo e detajuar si me poshte:

- Zeri "**Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore**" parashikohet te jete ne vleren prej **430 mije leke** shpenzime per lyerje ndertesa ,mcremtime, riparime te ndryshme objekti etj.
- Zeri "**Shpenzime per mirembajtje per ngrohje, rrjete elektrike, telefonike, ujore**" parashikohet te jete ne vleren prej **150 mije lekesh** per sherbime dhe instalime rrjete elektrike, pjese hidraulike , kablo clektrike etj.
- Zeri "**Mirembajtje per aparate paisje teknike**" parashikohet te jete ne vleren prej **150 mije lekesh**,ku perfshihen shpenzimet per mirembajtje per aparatet teknike, mirembajtje paisje fonie,riparime skancra/pc/fotokopje,printera etj etj
- Zeri "**Shpenzime per mirembajtje paisje zyre te pergjithshme**" parashikohet te jete ne vleren prej **170 mije lekesh** ku perfshihen shpenzimet per mirembajtjen e paisjeve te zyrave.

- ❖ Zeri (6026) "**Qera objekte**" per vitin 2013 parashikohet ne vleren prej **450 mije lekesh** ku perfshihen shpenzimet e qerase per ambientet e njesise administrative nr. 4 dhe shoqates se te persekutuarve dhe shpenzimet per marrje me qera mjete transporti per sherbime te ndryshme te administrates se bashkise

- ❖ Zeri (6027) *“Detyrime kompensime legale”* per vitin 2013 parashikohet te jete ne vleren prej **11 000 mije leke**, ku perfshihen shpenzimet per detyrimet gjyqesore te planifikuara nga Drejtoria Juridike.
- ❖ Zeri (6029) *“Te tjera materiale dhe shpenzime operative”* parashikohet ne vleren prej **13 322 mije leke**, ku perfshihen shpenzimet e detajuara si me poshte :
 - Zeri *“Pritje percjellje”* parashikohet ne vlere **450 mije leke** ku perfshihen shpenzimet qe do te behen gjate vitit 2013 per pritje percjellje te delegacioneve te huaja dhe kombetare .
 - Zeri *“Shpenzime per aktivitete”* parashikohet ne vleren prej **800 mije leke** ku perfshihen aktiviteti i 2 Prillit, dreka per Iftar dhe festa e liqenit
 - Zeri *“Siguracion ndertese”* parashikohet ne vleren prej **470 mije leke**, ku perfshihen shpenzimet per siguracionin e nderteses se Bashkise.
 - Zeri *“Shpenzime per honorare”* parashikohet ne vleren prej **9 402 leke**, ku perfshihen shpenzimet per honorare K.Bashkiak **7 658 mije leke** kujdestare **1 624 mije leke**, topografe **120 mije leke**.
 - Zeri *“Shpenzime per te tjera materiale dhe shpenzime operative”* parashikohet ne vleren prej **2 200 mije leke** ku perfshihen blerje dhurata, blerje korniza per tituj nderi, prodhim postera, hanera ,blerje albume, shpenzime per sete flamuj NATO, kombetare, stema bashkie ,blerje fishekzjarre ,saksi dekorative etj
- ❖ Zeri (231) *“Investime”* per vitin 2013 parashikohet ne vleren prej **1 580 mije leke** ku **480 mije leke** per rikonstrukcion magazina e bashkise dhe **1 100 mije leke** per shpenzime paisje zyrtare .